



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 2594 prot.

Tiranë, më 22.05 2025

RAPORT

PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT: "MBI KOHËZGJATJEN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE, ME PALË KUNDËRSHTARE, TË PËRFUNDUARA GJATË PËRIUDHËS KOHORE 01.03.2023-31.05.2023, NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, DHOMA CIVILE"

Në zbatim të vendimit nr.18, datë 15.04.2024, "*Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt "Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore, me palë kundërshtare, të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023-31.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile"* të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Tiranë, Shtator 2025

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit tematik me objekt "Mbi kohëzgjatjen e gjyimit të çështjeve gjyqësore, me palë kundërshtare, të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023-31.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile".

Data e përgatitjes:

22.05.2025

Përgatitur nga:

Znj. Daniela Sulaj

Z. Eugen Nasufi

Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

z. Artur Metani

Mirato ☒ Ndryshoi ☐ Ktheu ☐

Data 22.05.2025



1. Hyrje

- 1.1. Arsyet e inicimit të inspektimit
- 1.2. Qëllimi i inspektimit
- 1.3. Burimet relevante të së drejtës
- 1.4. Periudha e mbulimit të inspektimit
- 1.5. Objekti i inspektimit
- 1.6. Metodologjia e inspektimit
- 1.7. Periudha e kryerjes së inspektimit
- 1.8. Fazat e zhvillimit të inspektimit
- 1.9. Problematikat e hasura gjatë kryerjes së inspektimit

2. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi i të dhënave të administruara

- 2.1. Objekti i kontrollit
- 2.2. Drejtimit e inspektimit
- 2.3. Komunikimi administrativ në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit

3. Fakte të konstatuara në lidhje me veprimtarinë e gjykatës në raport me parashikimet ligjore/nënligjore përsa i përket rregullave standarde për eficiencën

4. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative

- 4.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës subjekt inspektimi
- 4.2. Sistemi për menaxhimin e çështjeve
- 4.3. Fakte të konstatuar në lidhje me saktësinë e të dhënave të hedhur në regjistrin fizik si dhe në sistemin elektronik
 - 4.3.1. Regjistrat civil
 - 4.3.2. Kuadri rregullator në lidhje me të dhënat statistikore
 - 4.3.3. Saktësia e të dhënave

5. Analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës objekt inspektimi

- 5.1. Numri i vendimeve të shpallura gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023
- 5.2. Fakte të konstatuara në lidhje me kohëzgjatjen e çështjeve / kohëzgjatjen mesatare si dhe me mënyrën e përfundimit për çështjet civile me palë kundërshtarë të përfunduara gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023
- 5.3. Fakte të konstatuara në lidhje me objektin e padisë dhe kohëzgjatjen mesatare në varësi të llojit të objektit të padisë.

- 5.4. Fakte të konstatuara në lidhje me shkaqet e zgjatjes së proceseve duke ju referuar llojit të objektit të padisë
- 5.5. Fakte të konstatuara në lidhje me çështjet me objekt padie "Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore" dhe "Lëshimi i urdhrit të mbrojtjes"
- 6. Gjetjet e inspektimit në lidhje me proceset gjyqësore që janë zgjatur përtej afatit dy vjeçar si dhe kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit.**
- 7. Konkluzione**
- 8. Rekomandime**

1.Pjesa hyrëse

1.1.Arsyet e inicimit të inspektimit

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorëve dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenet 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja "dh", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2024 "*Planin e inspektimeve për vitin 2024*".

Në këtë kuadër në ushtrim të kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së gjykatave bazuar në vendimin e sipërcituar, është planifikuar zhvillimi i inspektimit tematik me objekt "Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore, me palë kundërshtare, të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023-31.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile".

Ky inspektim është iniciuar duke pasur parasysh disa rrethana:

- Së pari, numrin e lartë të ankesave të paraqitura nga qytetarët me objekt "Tej zgjatjen në kohë të çështjeve civile ku ata kanë cilësinë e palës ndërgjyqëse".
- Së dyti, nevojën për të njohur gjendjen faktike të veprimtarisë gjyqësore të Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhoma civile), në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimeve civile duke pasur parasysh faktin se kjo gjykatë është ndër ato gjykata që ka pasur ngarkesën më të madhe të çështjeve në raport me gjykatat e tjera të RSH¹. Por gjithashtu duke pasur parasysh edhe faktin që kjo gjykatë është prekur më shumë nga procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Aktualisht sistemi i drejtësisë është në procesin e plotësimit me magjistratë të rinj të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe po plotësojnë vendet vakante të krijuara në organikën e munguar të Gjykatave, si pasojë e shkarkimeve dhe pezullimeve të magjistratëve të ndodhura për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve në R.SH.

- Së treti, referuar praktikës në vijimësi të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut e cila e ka dënuar Shqipërinë për shkak të shkeljeve të afateve të arsyeshme

¹ Referuar raporteve vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

të gjykimit ku përmendim çështjen Manushaqe Puto etj. kundër Shqipërisë, Vriioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë etj.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Bara & Kola kundër Shqipërisë (2021), me vendimin përfundimtar datë 28.02.2022 ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave duke arsyetuar në mënyrë të përsëritur (shih § 70 dhe § 94 të vendimit) se: *"Duke e marrë në konsideratë vonesën e kuptueshme të shkaktuar nga reformat e thella në sistemin e drejtësisë dhe nga procesi i vetting-ut, Gjykata vëren se shtetet kanë detyrim të përgjithshëm që t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore për të garantuar respektim të kushteve të parashikuara në nenin 6, duke përfshirë edhe një seancë të drejtë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm (shih Krastanov kundër Bullgarisë 30 shtator 2004)".*

1.2. Qëllimi i inspektimit:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë nëpërmjet këtij inspektimi synon të tërheqi vëmendjen e gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë Gjykatës objekt inspektimi por edhe pranë të gjitha gjykatave të tjera, se gjykimi brenda një afati të arsyeshëm është një e drejtë kushtetuese e individëve dhe pavarësisht nga situata ku ndodhet sistemi i drejtësisë, gjyqtarët duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që gjykimet të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

1.3. Burimet relevante të së drejtës

Burimet e të drejtës së brendshme, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë².
- Ligji nr. 115/2016 datë 03.11.2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"³, me ndryshimet përkatëse.
- Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH"⁴, me ndryshimet përkatëse.
- Kodi i Procedurës civile të R.SH⁵, me ndryshimet përkatëse.

² Neni 42, pika 2 "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirisë dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

³ Neni 2 "Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit".

⁴ Neni 74 "Afesia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në frekuencën për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje.

⁵ Neni 4 "Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme".

- Kodi Civil i R.SH, me ndryshimet përkatëse.
- Ligji nr.98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në R.SH⁶, me ndryshimet përkatëse.
- Ligji nr.9969 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", me ndryshimet përkatëse.
- Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.47 datë 11.02.2021 "Për miratimin e "Udhëzuesit" për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efijencës së gjykatave"
- Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.148 datë 29.03.2023 "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisve të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, më zyrë shërbimi".
- Raportet vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor.
- Raporti vjetor për vitin 2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Rregullore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë miratuar me Urdhrin nr.209 datë 27.10.2017 të Kryetarit të Gjykatës.

Burimet e të drejtës ndërkombëtare:

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe praktika e Gjykatës përsa i përket "Shkeljes së afatit të arsyeshëm" në kuptim të nenit 6 të kësaj konvente.
- Opinionet e Këshillit Konsultativ për Gjyqtarët Evropianë.
- Opinionet dhe Raportet e Komisionit Evropian për Efijencën në Drejtësi (CEPEJ)

1.4. Periudha e mbulimit të inspektimit

Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile për periudhën 01.03.2023-31.05.2023.

1.5. Objekti i Inspektimit

Çështjet gjyqësore objekt i këtij inspektimi do të jenë ato çështje gjyqësore të cilat përkufizohen si "çështje gjyqësore civile me palë kundërshtare" në referim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 47 datë 11.02.2021 "Për miratimin e "Udhëzuesit" për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efijencës së gjykatave".

Neni 145 "Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji dhe kur ky e lejon edhe nga gjykata".

Neni 399/1-399/12 "Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërbëimin e dëmit".

⁶ Neni 5, pika 4 "Gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase".

1.6 Metodologjia e inspektimit

Duke ju referuar volumnit të madh të të dhënave të administruara, kemi përzgjedhur një metodologji të përshtatshme inspektimi me qëllim analizimin e të gjitha elementëve të rëndësishëm që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e gjykimeve civile me palë kundërshtare, analizuar kjo kohëzgjatje në raport me afatin ligjor dhe afatin e arsyeshëm të gjykimit, me kompleksitetin e çështjes në varësi të llojit të objektit të padis, por dhe në raport me gjendjen e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile, përsa i përket organikës dhe ngarkesës gjatë kohës së gjykimit.

Në kuadër të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e procesit por edhe në kohëzgjatjen e tij në varësi të llojit të objektit të padisë janë përzgjedhur si “çështje kampion” 2 (dy) çështje gjyqësore përkatësisht një çështje për të cilën procesi ka zgjatur më pak dhe një çështje për të cilën procesi ka zgjatur më shumë në raport me çështjet e tjera të të njëjtit lloj.

Çështjet për të cilat gjykimi ka përfunduar brenda një afati të shkurtër janë analizuar me qëllim nxjerrjen në dukje të praktikave më të mira në drejtim të gjykimit efikas si dhe identifikimin dhe promovimin e metodologjive që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit të procesit gjyqësor.

Kjo lloj metodologjie vjen në harmoni dhe me “Metodologjinë e inspektimit” të miratuar me Urdhrin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.121 datë 30.12.2022 përsa i përket qëllimit në tërësi të inspektimeve tematike dhe vlerave që duhet të përcjellin këto inspektime.

1.7. Periudha e zhvillimit të inspektimit

Ky inspektim është kryer gjatë periudhës kohore 15.04.2024 – 30.09.2025⁷, dhe realizimi tij është zhvilluar në disa faza.

1.8. Fazat e zhvillimit të inspektimit

1)Faza e parë “Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimi i verifikimeve apo vizitave pranë gjykatës”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:

⁷ Sipas vendimit ILD-së nr. 18, datë 15.04.2024, fillimisht afati për hartimin e raportit përfundimtar ishte data 02.12.2024. Ky afat u shty deri në datë 30.09.2025 (vendimi i ILD nr. 18/1, datë 27.12.2024 dhe akti nr. 998/27, datë 28.02.2025) në kushtet kur për shkak të pasaktësive të konstatuara në të dhënat e administruara, rezultoi i nevojshëm verifikimi i këtyre të dhënave me të dhënat e sistemit të menaxhimit të çështjeve të gjykatës objekt inspektimi, tek të cilat ILD-ja siguroi akses në zbatim të Vendimit nr.03 datë 28.02.2025 të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për aksesin në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë”.

- i) Përgatitja e planit të punës.
- ii) Përgatitja e shkresave drejtuar institucionit objekt inspektimi.
- iii) Administrimi i dokumentacionit ardhur në përgjigje të kërkesave të ILD-së.
- iv) Kryerja e verifikimeve dhe vizitave në terren ku grupi i inspektorëve ka kryer intervista gjysëm të strukturuar me Kryetarin e Gjykatës, me Kancelarin, Kryesekretarin si dhe ka parë nga afër se si funksionon sistemi i menaxhimit të çështjeve. Gjithashtu gjatë takimit me kryesekretaren e gjykatës jemi njohur me gjendjen fizike të regjistrit Themeltar civil si dhe me numërtorin e vendimeve civile.

2) Faza e dytë *“Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”*. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:

- i) Përpunimi i dokumentacionit administrativ dhe studimi i materialit.
- ii) Kryerja e vizitave në ambientin e Gjykatës dhe marrja me procesverbal e dokumenteve dhe e të dhënave që kanë rezultuar të nevojshme nga studimi i materialit të vënë në dispozicion me shkresë nga Gjykata.

3) Faza e tretë *“Hartimi i raportit të inspektimit”*

- i) Hedhja e të dhënave si dhe hartimi i pjesëve të veçanta të raportit.
- ii) Hartimi i raportit, i cili dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe miratimit të Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

4) Faza e katërt: *“Ndjekja e rekomandimeve”*

- i) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të inspektimit.

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr.18 datë 15.04.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u angazhuan inspektorët znj. Daniela Sulaj dhe z. Eugen Nasufi. Gjithashtu me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektore znj. Daniela Sulaj.

1.9. Problematikat e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave dhe përpunimit të tyre në funksion të procesit të inspektimit

Gjatë periudhës së zhvillimit të inspektimit janë konstatuar në mënyrë të përmblodhur problematikat si më poshtë:

- Mungesa e aksesit të drejtpërdrejtë nga zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistemin e menaxhimit të çështjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit

të Përgjithshëm Tiranë⁸, gjatë vitit 2024, ka ndikuar në efikasitetin e procesit të inspektimit.

Duke mos patur akses në sistemin e menaxhimit të çështjeve të gjykatës, grupi i inspektimit ka qenë i detyruar fizikisht të paraqitet në ambientin e gjykatës për të mundësuar printimin e të dhënave të hedhura në sistem, duke përfshirë edhe printimin e procesverbaleve të seancave gjyqësore.

- Volumi i madh i të dhënave përsa i përket numrit dhe kohëzgjatjes së çështjeve objekt inspektimi të përfunduara për periudhën 01.03.2023-31.05.2023 nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile.
- Mënyra e paraqitjes së të dhënave në sistemin e menaxhimit të çështjeve të sistemit ARK-IT që përdor gjykata. Ky sistem nuk gjeneron një raport të integruar informativ (RIV) të historikut të një çështje civile nga momenti i regjistrimit të kërkesë padisë deri në shpalljen e vendimit. Pamundësia e sistemit për të gjeneruar historikun e një çështje civile nëpërmjet printimit të RIV⁹ dhe mënyra e hedhjes së të dhënave në këtë sistem ka vështirësuar mbledhjen e të dhënave në lidhje me numrin total të seancave gjyqësore për secilën çështje dhe identifikimin e shkaqeve të kohëzgjatjes të gjykimit të një çështjeje.
- Administrimi i kopjes së numërorit të vendimeve civile është realizuar me vonesë si pasojë e njoftimit nga gjykata se regjistri përkatës, për shkak të përmasave të mëdha fizike, paraqiste vështirësi teknike në procesin e fotokopjimit¹⁰.
- Të dhënat dhe mënyra e pasqyrit të tyre në regjistrin fizik dhe në sistemin e menaxhimit të çështjeve nuk e bëjnë të mundur identifikimin e qartë nëse një çështje civile është e ri shortuar, apo nëse çështja ka qenë objekt pezullimi gjatë shqyrtimit gjyqësor.

2. Objekti i kontrollit dhe përshkrimi të dhënave të administruara

2.1. Objekti i kontrollit

Objekti i kontrollit është inspektimi i veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma civile (më poshtë referohet edhe shkurt: "gjykata"), përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimit të çështjeve gjyqësore, me palë kundërshtare, të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023-31.05.2023.

⁸ Kredencialet për aksesimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, janë përcjellë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor përmes shkresës nr. 1462/22 prot., datë 28.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 700/8 prot., datë 29.04.2025.

⁹ Në ndryshim nga sistemi ICMIS i cili gjeneron RIV (regjistrimin e veprimeve) në të cilin pasqyrohet historiku i çështjes nga regjistrimi i kërkesëpadisë deri në shpalljen e vendimit.

¹⁰ Shkresa nr.2792/2 datë 17.05.2024 e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Kategorizimi i "çështjeve gjyqësore" për qëllim të udhëzimit të sipërcituar i referohet kategorive universale të çështjeve CIVILE / PENALE / ADMINISTRATIVE. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma civile është kompetente për gjykimin e çështjeve civile, të cilat për qëllime organizative dhe statistikore klasifikohen në dy kategori kryesore: **"Çështje civile me palë kundërshtare"** dhe **"Çështje civile pa palë kundërshtare"**.

Duke qenë se objekti i inspektimit janë **"çështjet civile me palë kundërshtare"**, më poshtë po pasqyrojmë mënyrën se si janë nën kategorizuar këto çështje për efekt të të dhënave statistikore referuar vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.47 datë 11.02.2021 *"Për miratimin e "Udhëzuesit" për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave"*.

Kategoria **"A"** e **"çështjeve gjyqësore me palë kundërshtare"** ndahet në disa nënkategori si më poshtë:

A. Çështje civile me palë kundërshtare

A.1. "Civile të përgjithshme me palë kundërshtare" përfshin çështje të cilat inicohen me kërkesë padi duke përjashtuar çështjet që përfshihen në kategoritë e mëposhtme:

A.2. "Familjare me palë kundërshtare" përfshin por pa u kufizuar në to çështjet si më poshtë:

-Padi për pavlefshmërinë e martesës (neni 43 i K. Familjes); Padi për zgjidhjen e martesës (neni 129 e vijues); Padi për njohjen dhe kundërshtimin e amësisë ose atësisë (nenet 177,178,179,181,183-188 të Kodit të Familjes); Padi për kërkimin e detyrimit për ushqim (neni 199); Padi për përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim ndaj fëmijës; Padi për heqjen ose kthimin e përgjegjësisë prindërore, përcaktimin e përgjegjësisë prindërore të fëmijës së lindur jashtë martese (neni 227, 228 i K. Familjes); Padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrit të mbrojtjes; çështje të tjera.

A.2.1. Ndërsa të dhënat për paditë me objekt **"Zgjidhje martese"** raportohen më vete, ku futen çështjet e parashikuara nga Kodi i Familjes por pa u kufizuar si më poshtë:

Zgjidhja e martesës në bazë të neneve 129-131 të Kodit të Familjes; Zgjidhja e martesës me kërkesën e njëres prej palëve, nenet 132-140 të Kodit të Familjes; Çështje të tjera.

A.3. "Tregtare me palë kundërshtare" përfshin por pa u kufizuar në to sa më poshtë:

-Kërkesë padit të referuara në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 **"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"**; në ligjin **"Për falimentimin"** 110/2016; Zhvlerësimi i çeqeve/letra me vlerë etj. sipas neneve 337-346 i K.Pr.C.

A.4. "Marrëdhënie pune" përfshin të dhënat për konflikte gjyqësore që burojnë nga marrëdhëniet e punës të tilla si:

-Padit për shpërblimin e dëmit që vjen nga zgjidhja e marrëdhënies së punës; Për pavlefshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës; Padi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar gjatë marrëdhënies së punës; Çështje të tjera.

2.2. Drejtimet e inspektimit

Fokusi i inspektimit tematik u përqendrua kryesisht në gjashtë drejtime kryesore:

- Numrin e përgjithshëm të vendimeve të shpallura në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023.
- Numrin e përgjithshëm të gjykimeve me palë kundërshtare të cilat janë gjykuar përtej afatit të arsyeshëm.
- Numrin e përgjithshëm të çështjeve për të cilat është konstatuar shkelje e afatit të arsyeshëm.
- Identifikimin e shkaqeve të zgjatjes së gjykimeve.
- Analiza e ecures dhe dinamikës së kohëzgjatjes së çështjeve sipas llojit të objektit të gjykimet për çështjet objekt inspektimi.
- Analiza e ecures dhe kohëzgjatjes së çështjeve për çështjet që kanë zgjatur më tepër se dy vjet.

Inspektimi tematik filloi me fazën e parë, hartimin dhe dërgimin e kërkesave për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile.

2.3. Komunikimi administrativ me Gjykatën subjekt inspektimi në kuadër të marrjes së të dhënave të nevojshme për kryerjen e inspektimit.

Në kuadër të kryerjes së inspektimit është kërkuar¹¹ nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile informacioni dhe dokumentacioni si më poshtë:

- Kopje të njësuar të numërorit të vendimeve në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare, të shpallura në harkun kohor 01.03.2023 – 31.05.2023.
- Informacion statistikor për secilin gjyqtar në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023 – 31.05.2023, duke përcaktuar kohën e regjistrimit të çështjes, kohën e shortimit, ecurin në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimet dhe arsyet e shtyrjes së seancave, si dhe kohën e shpalljes së vendimit;
- Informacion statistikor për periudhën 01.03.2023-31.05.2023, për trendin e përfundimit të këtyre gjykimeve me palë kundërshtare, në varësi të llojit të çështjes objekt gjykimi;

¹¹ Shkresa e ILD-së nr.998/3 prot., datë 22.04.2024

- Informacion statistikor i dhënë për secilin gjyqtar për të gjithë çështjet me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023, për trendin e përfundimit të gjykimit jashtë afatit të arsyeshëm 2 vjeçar në referim të nenit 399/2 i K.Proç.Civile;
- Informacion statistikor i dhënë për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përfunduara në këtë gjykatë gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023, për trendin e përfundimit të gjykimit jashtë afatit të arsyeshëm 2 vjeçar në referim të nenit 399/2 i K.Proc.Civile;
- Të dhëna në lidhje me kërkesat me objekt "Konstatim shkelje dhe përshpejtim procedurash" në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023 – 31.05.2023 (në referim të nenit 399/6 pika 1 i K.Pr.C) dhe vendimet e Gjykatës së Apelit në lidhje me këto kërkesa.
- Të dhëna në lidhje me kërkesat me objekt "Shpërblim demi" të paraqitura pranë kësaj gjykate në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023 – 31.05.2023 (në referim të nenit 399/6 pika 2 KPC) dhe vendimet e Gjykatës së lidhje me këto kërkesa.
- Kopje të akteve nënligjore që rregullojnë mënyrën e menaxhimit të çështjeve dhe veprimtarinë e magistratëve dhe administratës përsa i përket identifikimit të kohëzgjatjes së një çështjeje dhe arsyeve të shtyrjes së seancave gjyqësore.
- Çdo informacion/dokumentacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm gjatë veprimtarisë së inspektimit, në përputhje me nenin 214, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhoma civile)¹² në përgjigje të kërkesës së sipërcituar, ndër të tjera na ka informuar se :

"Duke qenë se regjistri (bëhet fjalë për numërorin e vendimeve civile) është në përmasa të mëdha ka vështirësi në fotokopje (gjë që më parë ka sjellë edhe dëmtimin e tyre), kërkojmë të shmangim fotokopjen e tij duke ju siguruar se këtë regjistrë do ta keni në dispozicion në momentin e parë të paraqitjes tuaj në ambjentin e gjykatës. Në vijim jemi duke punuar për nxjerrjen e të dhënave të tjera".

Në referim të shkresës së sipërcituar, grupi i punës ka shkuar në ambjentin e Gjykatës me qëllim kqyrjen e regjistrave dhe mundësinë e marrjes së të dhënave që ai përmban, si dhe kryerjen e intervistave gjysëm të strukturuar me Kryetarin, Kancelarin, Kryesekretaren dhe punonjësin specialist të statistikave. Grupi i inspektorëve kqyri në ambjentin e sekretarisë në praninë e kryesekretares regjistrin themeltar civil dhe numërorin e vendimeve për vendimet e shpallura nga data 01.01.2023-31.05.2023 si dhe mori me fotokopje fletën e parë të regjistrit civil dhe numërorit ku ndodhet i regjistruar vendimi i parë i shpallur në datë 01.03.2023 si dhe kërkesa padia përkatëse si dhe fletën e fundit ku ndodhet e regjistruar vendimi i fundit i shpallur në datë 31.05.2023 si dhe kërkesë padia përkatëse.

¹² Shkresa nr.2792/2 prot., datë 17.05.2024

Gjykata¹³ ka vënë në dispozicion:

- Formatet e raportimit tremujor pranë KLGJ për vitin 2023;
- Udhezuesin e përdorimit për të gjithë përdoruesit e aplikimit të sistemit të qeverisjes të Gjykatës (21 faqe);
- Analizën vjetore të Gjykatës për vitin 2023 dhe me CD;
- Fotokopje të fletës të numërorëve të vendimeve civile dhe të regjistrave themeltarë të përzgjedhur nga inspektorët në momentin e inspektimit.

Gjykata nëpërmjet emailit elektronik¹⁴ ka dërguar në format Excel të dhënat në formë tabelore në lidhje me "Kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023-31.05.2023". Në tabelën Excel janë të pasqyruara gjithsej si të regjistruara 1754 vendime civile.

Gjithashtu, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹⁵, është përsëritur kërkesa drejtuar Gjykatës, për të mundësuar marrjen e kopjeve të njehsuar të numërorit të vendimeve lidhur me gjykimet civile me palë kundërshtare të shpallura për periudhën 01.03.2023-31.05.2023.

Të ndodhur në kushtet kur të dhënat e numërorit të vendimeve civile ishin të rëndësishme për të evidentuar saktë çështjet civile me palë kundërshtare dhe kohëzgjatjen e tyre, u mundësua fotokopjimi i fletëve të "Numërorit të vendimeve" për vendimet e shpallura gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023. Pasi është kryer fotokopjimi, fletët e njësuar me origjinalin na janë dërguar në rrugë postare¹⁶.

Në vijim, në përgjigje të kërkesës sonë për informacion¹⁷, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹⁸ ka dërguar në CD informacionin si më poshtë:

- Tabelën me informacionin statistikor për secilin gjyqtar, si dhe numrin e vendimeve të përfunduara për çështjet që kanë zgjatur mbi 2 vjet.
- Tabelat me informacion statistikor për secilin objekt mosmarrëveshje, numrin e vendimeve të përfunduara për çështjet që kanë zgjatur mbi dy vjet sipas objektit etj.
- Një kërkesë me objekt "Konstatim shkelje dhe përshpejtim procedurash" të paraqitur në gjykatë.
- Në lidhje me "kërkesat për shpërblim dëmi" gjykata na ka informuar se sistemi i menaxhimit të çështjeve nuk bën një ndarje të natyrave të ndryshme përsa kërkohej shpërblimi i dëmit duke e bërë të pamundur identifikimin nëpërmjet sistemit të kërkesave të shpërblimit të dëmit që lidhen me shkeljen e afatit të

¹³ Shkresa nr 2792/6 datë 05.06.2024

¹⁴ Regjistruar në Zyren e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 998/6 prot., datë 13.06.2024

¹⁵ Shkresa nr. 998/7 prot., datë 14.06.2024 e ILD-se

¹⁶ Me shkresën e regjistruar në ILD me nr. 998/8 prot., datë 21.06.2024.

¹⁷ Shkresa me nr.998/3 prot., datë 22.04.2024

¹⁸ Me shkresën nr.2792/10 datë 11.07.2024, të regjistruar pranë Zyrës së ILD-së me nr.998/9 data 11.07.2024.

arsyeshëm, identifikim që mund të bëhet vetëm duke parë dosjet fizikisht një e nga një.

Duke qenë se sistemi i menaxhimit të çështjeve me të cilën operon Gjykata e Tiranës nuk gjeneron RIV (Regjistri i veprimeve) për të kuptuar historikun e një çështje civile nga regjistrimi i kërkes padisë deri në shpalljen e vendimit, grupi i inspektimit në prani të nëpunësit civil gjyqësor (specialistit përkatës) pranë gjykatës ka shkuar në ambientin e kësaj të fundit dhe ka printuar nga sistemi elektronik i gjykatës të dhënat që janë hedhur në këtë sistem në lidhje me procesverbalet e seancave për çështjet të cilat kanë pasur një kohëzgjatje më të madhe se dy vjet. Për marrjen e akteve janë mbajtur procesverbalet përkatëse:

- Procesverbal datë 25.07.2024, regjistruar në ILD me nr. 998/10 prot., datë 25.07.2024, për marrjen e 256 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) fletë të printuara nga sistemi.
- Procesverbal datë 26.07.2024, regjistruar në ILD me nr.998/11 prot., datë 26.07.2024 për marrjen e 383 (treqind e tetëdhjetë e tre) fletë të printuara nga sistemi.
- Procesverbal datë 29.07.2024, regjistruar në ILD me nr.998/12 prot., datë 29.07.2024, për marrjen e 446 (katërqind e dyzet e gjashtë) fletë të printuara nga sistemi.
- Procesverbal datë 30.07.2024, regjistruar në ILD me nr. 998/13 prot., datë 30.07.2024, për marrjen e 500 (pesëqind) fletë të printuara nga sistemi.
- Procesverbal datë 31.07.2024, regjistruar në ILD me nr.998/14 prot., datë 31.07.2024, për marrjen e 460 (katërqind e gjashtëdhjetë e një) fletë të printuara nga sistemi.
- Procesverbal datë 01.08.2024, regjistruar në ILD me nr.998/15 prot., datë 01.08.2024, për marrjen e 530 (pesëqind e tridhjetë) fletë të printuara nga sistemi.
- Procesverbal datë 02.08.2024, regjistruar në ILD me nr. 998/16 prot., datë 02.08.2024 për marrjen e 109 (njëqind e nëntë) fletë të printuara nga sistemi.
- Procesverbal datë 02.08.2024, regjistruar në ILD me nr.998/17 prot., datë 02.08.2024, për marrjen e 263 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre) fletë të printuara nga sistemi, përkatësisht procesverbalet e seancave, për çështjet civile me objekt "Kundërshtim i veprimeve përmbarimore", të përfunduara përgjatë periudhës objekt inspektimi.

Në mënyrë që analizimi i të dhënave të ishte sa më gjithëpërfshirës, objektiv dhe shterues, përveç të dhënave të sjella nga gjykata si dhe të dhënave të marra pranë kësaj gjykate, nga grupi i inspektimit u morën dhe të dhëna të përgjithshme të sistemit të drejtësisë në vend dhe konkretisht raporti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022 dhe 2023.

3. Fakte të konstatuara në lidhje me veprimtarinë e gjykatës në raport me parashikimet ligjore/nënligjore përsa i përket rregullave standarde për efikasitetin

Kodi i Procedurës Civile në R.SH përcakton rregulla të detyrueshme për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile. Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë Kod që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor dhe ka për detyrë të zhvillojë një proces të rregullt ligjor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, gjykata vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme¹⁹. Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji, dhe kur ky e lejon edhe nga gjykata²⁰. Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim²¹.

Ndonëse Kodi i Procedurës Civile i miratuar me ligjin nr. 8116 datë 29.03.1996 ka pësuar ndryshime ndër vite, vlerësojmë të ndalemi tek ndryshimet që ka pësuar ky kod në vitin 2017, duke pasur parasysh se këto ndryshime u iniciuan si rezultat i gjetjeve në Dokumentin e Analizës për Sistemin e Drejtësisë në R.SH që kishin të bënin në mënyrë të posaçme me zvarritjen e proceseve gjyqësore civile. Disa nga këto gjetje të pasqyruara në këtë dokument ishin: mosrespektimi i duhur i rregullave për njoftimin e palëve i cili është evidentuar si një nga shkaqet kryesore të dëmtimit të efikasitetit; adresat jo të sakta; mungesa e aksesit të gjykatave në të dhënat e adresave në nivel qendror dhe vendor; mungesa e një sistemi të efektshëm për ndjekjen e historikut të një çështjeje ka pasqyruar procese gjyqësore civile paralele bazuar në të njëjtin subjekt; evidentim i mangësive të dispozitave ligjore procedurale civile në lidhje me njoftimin e vlefshëm të akteve; tendenca e gjyqtarëve për të shtyrë seancat veçanërisht për shkak të mungesës së një pale dhe mungesa e legjislacionit për të rregulluar këtë problem; mungesa e parashikimit ligjor për gjykimin e padive me vlerë të vogël; evidentimi i diskrecionit të gjyqtarit për shtyrjen e seancave gjyqësore si dhe mungesa e përcaktimit të qartë në kod e gjykimit në mungesë. Përsa më sipër referuar, ndryshimet dhe shtesat që pësoi Kodi i Procedurës Civile me hyrjen në fuqi të ligjit nr.38/2017, kishin për qëllim të evitonin problematikat e konstatuara dhe të nxisnin efikasitetin dhe efektshmërinë e sistemit të drejtësisë²². Në këtë kontekst, u parashikuan në Kodin e Procedurës Civile rregullime të detajuara që kanë të bëjnë me: Zgjidhjen e çështjes jo vetëm me pajtim por edhe me ndërmjetësim (neni 25 dhe neni 158/ç i K.Pr.C); me abuzimin me të drejtat në proces (neni 34 i K.Pr.C); bashkimi i çështjeve/padive (neni 57); u parashikuan rregulla më të detajuara në lidhje me "thirrjen në gjykatë" dhe njoftimin shkresor të akteve (neni 129,130,131); u shtuan rregulla në lidhje me mënyrën e njoftimit me shpallje publike (neni 133/a); rregulla në lidhje me

¹⁹ Neni 4 i K.Pr.Civile

²⁰ Neni 171/a i K.Pr.C: "Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprime të tjera të kërkuara prej saj".

²¹ Neni 153 i K.Pr.Civile.

²² Shiko raportin për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116 datë 29.03.2016 "Kodi i procedurës civile i R.SH", i ndryshuar.

përcaktimin e personit të autorizuar për marrjen e njoftimeve (neni 133). Gjithashtu u parashikuan në mënyrë kronologjike veprimet e nevojshme për tu kryer nga gjyqtari përsa i përket vlerësimit të kushteve të kërkesë padisë dhe në vijim veprimet e nevojshme paraprake para caktimit të seancës përgatitore ndër të cilat përmenden këto veprime: gjyqtari përjashton paditësin nga tarifa gjyqësore sipas rastit; cakton provat që do të merren në shqyrtim në seancë gjyqësore; cakton ekspertin të cilën ua njofton palëve; vendos për marrjen e provave dhe informacioneve tek të tretët sipas rastit; vendos marrjen e masave për sigurimin e padisë, sigurimin e provës, pezullimin e gjykimit, vendos për pushimin e gjykimit, bashkimin e padive në një gjykim të vetëm, vendos në lidhje me thirrjen e personit të tretë në gjykim, gjithmonë sipas rastit, në përputhje me parashikimet e Kodit.

Gjithashtu Kodi i Procedurës Civile pësoi ndryshime edhe përsa i përket dispozitave në lidhje me seancën përgatitore dhe seancën gjyqësore.

Konkretisht përsa i përket seancës përgatitore në Kod janë parashikuar rregulla më të detajuara që përcaktojnë detyrimin (neni 158/b, pika 1 K.Pr.C) por edhe diskrecionin e gjyqtarit sipas rastit për të caktuar seancë përgatitore (neni 158/b, pika 2 K.Pr.C).

Ndërsa përsa i përket "Urdhrit për caktimin e seancës gjyqësore" janë përcaktuar elementët që duhet të përmbajë urdhri si dhe fakti se njoftimi drejtuar dëshmitarëve, përkthyesit, ekspertit, duhet të përmbajë edhe paralajmërimin për sanksione, sipas ligjit, për mosparaqitje në seancë pa shkak të ligjshëm. Gjithashtu nxjerrja e "urdhrit për caktimin e seancës gjyqësore" është parashikuar si rregull, si një afat limit për kryerjen e një serë veprimesh procedurale sikurse mund të përmendim veprimet e parashikuara nga neni 57 të K.Pr.C²³, neni 61 të K.Pr.C²⁴, neni 160 të K.Pr.C²⁵; neni 186 i K.Pr.C (pretendime për prova/fakte, të reja) si dhe nenet 190,191,192,193 të K.Pr.C²⁶ në lidhje me pjesëmarrjen e personave të tretë në gjykim thirrja e të cilëve mund të kryhet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

Përveç parashikimeve ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij raporti (shih burimet relevante të së drejtës) si dhe normave procedurale civile, ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" në nenin 89, shkronja b), në lidhje me funksionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor përsa i përket administrimit të gjykatave, përcakton ndër të tjera se: "*Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:...**b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave,*

²³ Bashkimi i çështjeve mund të bëhet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

²⁴ Në rastet e tjera, mungesa e kompetencës tokësore mund të merret parasysh vetëm me kërkesë të palëve, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

²⁵ Kundërpadia mund të paraqitet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

²⁶ Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave dhe uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë”.

Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor gëzon autoritetin në bazë të ligjit²⁷ për të miratuar rregulla standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave. Rregullat standarde të gjykatave përmbajnë norma në lidhje me **strukturën e gjykatave, eficientën dhe cilësinë e drejtësisë.**

Rregullat standarde për eficientën në sistemin e drejtësisë, në referim të nenit 94, pika 4, të ligjit nr.115/2016, përfshijnë ndër të tjera parashikimet për:

“a) afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, përfshirë, kur është e mundur, edhe afatet për fazat kryesore të procedurës, për ekzekutimin e vendimeve, duke mbajtur parasysh organizimin gjyqësor dhe normat procedurale;

b) rregullat standarde që do të përdoren nga gjykatat për përcaktimin e afateve kohore, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve, me qëllimin për të përmirësuar në vijimësi sistemin e menaxhimit të çështjeve”;

c) veprimet standarde që duhet të ndërmerren në rastet kur shqyrtimi i çështjes tejkalon afatet;

ç) rregullat standarde për monitorimin e kohëzgjatjes së pezullimeve që vijnë si rezultat i mosveprimit nga palët ose gjykatat;

d) rregulla standarde për monitorimin dhe shpërndarjen e të dhënave për personelin e gjykatave dhe të gjithë përdoruesit e gjykatave;

dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore;

e) udhëzues për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve;

ë) udhëzues për monitorimin e shtyrjeve të seancave gjyqësore;

f) modele për vendimet gjyqësore;

g) udhëzues për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor;

gj) udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe marrjen e provave në gjykatë;

h) krijimi i mekanizmave për zgjidhjen e problemeve funksionale dhe shpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës midis gjyqtarëve dhe gjykatave”.

Përsa i përket rregullave standarde kohore në referim të pikës 1 të nenit të sipërcituar, Këshilli i Lartë Gjyqësor edhe gjatë vitit 2023, për vlerësimin etiko-profesional të gjyqtarëve është bazuar në “Standardet minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve” të parashikuara në vendimin nr 261/2, datë 14.04.2010, e ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

²⁷ Ligji nr.115/2016“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 89 dhe neni 94 pika 2

Gjithashtu në raportet e vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve të përpiluara edhe gjatë vitit 2023 në lidhje me kriterin "Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore", Këshilli i Lartë Gjyqësor referon se në tabelat me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mungojnë të dhëna lidhur me numrin e seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh.

Sikurse parashtroam edhe më lart, Kodi i Procedurës Civile ka pësuar ndryshime të konsiderueshme që datojnë pas nxjerrjes së Vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Duke pasur parasysh këtë fakt por edhe kontekstin aktual në të cilin ndodhet gjykata përsa i përket organikës së paplotësuar dhe ngarkesës në rritje të së punës së gjykatës, vlerësojmë se standardet minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare të cilat shërbejnë edhe si standarde orientuese, në kuadër jo vetëm të përmbushjes së detyrimit ligjor të sipërcituar por edhe të qëllimit për të ndikuar në rritjen e efektivitetit të gjykatës kanë qenë të nevojshme të rishikohen në mënyrë që të përshtaten me rrethanat e reja nga të cilat karakterizohet gjendja e sistemit të drejtësisë në përgjithësi. Në mënyrë të veçantë, ka rezultuar i nevojshëm rivlerësimi i rregullave standarde përsa i përket gjykimit të çështjeve civile me palë kundërshtare, duke pasur parasysh ndryshimet e konsiderueshme të Kodit të Procedurës Civile të kryera në vitin 2017, por edhe faktin se në Kodin e Procedurës Civile përsa i përket procesit të gjykimit në shkallë të parë janë parashikuara me pak afate ligjore krahasuar me afatet ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar edhe në nenin 89 të ligjit 115/2016 ka miratuar vendimin nr.25 datë 07.02.2019 i ndryshuar me vendimin nr. 115 datë 09.07.2019 **"Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore"**. Referuar nenit 1, pika a) dhe e) të këtij vendimi kryetari i gjykatës duhet të informoj periodikisht Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me: a) *"Ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe çdo gjyqtar të saj, evidentimin e numrit të çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse si dhe numrin e çështjeve të zvarritura tej afateve të arsyeshme të përcaktuara në nenin 399/2 të K.Pr.Civile"*, e) *Gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi"*.

Në lidhje me sa më sipër, është konstatuar se për vitin 2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i ka dërguar raportimet përkatëse tre muajore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor²⁸ me vendimin nr.47 datë 11.02.2021 ka vendosur miratimin e udhëzuesit **"Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efencës së gjykatave"** Ky udhëzim ofron një tërësi rregullash për mbajtjen, plotësimin dhe

²⁸ Në kuadër të përmbushjes së detyrimit të parashikuar në nenin 94, pika 4, shkronja dh) e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar.

raportimin e të dhënave statistikore nëpërmjet tabelave standarde të unifikuara për të gjitha gjykatat.

4. Faktet e konstatuara dhe analiza e të dhënave në lidhje me veprimtarinë administrative

4.1. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile²⁹ e ushtron veprimtarinë në adresën fizike: Bulevardi "Gergj Fishta"; Adresa elektronike: Email: info.civile@gjykata.gov.al.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është gjykatë e kategorisë së parë (e lartë) e përcaktuar si e tillë me vendimin e KLGJ-së me nr.147 datë 29.03.2023³⁰.

Periodha objekt inspektimi 01.03.2023 - 31.05.2023 përkon me kohën e implementimit të hartës së re gjyqësore, që ka prekur edhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 137 datë 28.03.2023 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë"³¹ ka vendosur ndër të tjera që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kjo Gjykatë ka filluar funksionimin (me këtë emërtim) në datë 01.05.2023.

Si rrjedhojë e riorganizimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka ndërprerë veprimtarinë në datë 30.04.2023. Gjyqtarët e emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në këtë gjykatë, të cilëve ju suprimohej pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, janë transferuar në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Përsa i përket transferimit të çështjeve gjyqësore, çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Krujë deri në datën 30.04.2023 por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit janë transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sipas vendimit të sipërcituar të KLGJ-së këto çështje duhet të regjistrohen në regjistrat manual dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve Ark-IT.

²⁹ Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e ushtron veprimtarinë në dy dhoma përkatësisht Dhoma Penale dhe Dhoma Civile.

³⁰ Ky vendim, i cili hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare, është publikuar në fletoren zyrtare në datë 29.03.2023.

³¹ Ky vendim, i cili hyn në fuqi me botimin në fletoren zyrtare, është publikuar në fletoren zyrtare në datë 29.03.2023.

Përsa i përket menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sipas vendimit të KLGJ-së çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

Gjatë periudhës së inspektimit ka hyrë në fuqi³² "Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.148 datë 29.03.2023 "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë me zyrë shërbimi". Në nenin 15 të këtij vendimi parashikohet ndër të tjera se "Këshilli i gjykatës pritëse, brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, miraton strukturën, organikën, si dhe përshkrimet e hollësishme të punës, duke i përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës"

Ndonëse në analizën vjetore 2023 të gjykatës (në fq.4) është parashtruar se Këshilli i Gjykatës ka miratuar vendimin nr.107 datë 04.04.2023 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe përshkrimet e punës të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", kjo gjykatë ka vënë në dispozicion të ILD-së vetëm "Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë" e cila është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës nr. 209 datë 27.10.2017.

Referuar raportit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitin 2023, rezulton e plotësuar në masën 54% sa i takon trupës gjyqësore dhe në masën 93% sa i takon administratës gjyqësore.

Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e çështjeve objekt inspektimi, më poshtë po paraqesim shifrat e detajuara të burimeve njerëzore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën 2020, 2021, 2022, 2023 si më poshtë:

Viti	Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti t në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbësht. për gjyqtar sipas organikës	Staf mbësht. për gjyqtar në fakt
2020	76	61.8	80%	156	150.8	97	2.1	2.5
2021	76	51.16	67%	174	162.67	93%	2.25	2.54
2022	76	39.5	52%	178	174.9	98%	2.3	4.4
2023	80	43.5	54%	192	178.9	93%	2.4	4.1

³²Ky vendim, i cili hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është postuar në këtë faqe në datë 29.03.2023.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se është gjykata e cila ka mbartur më shumë çështje për vitin 2022 në numrin total 19374 çështje, gjithashtu rezulton si gjykata që ka regjistruar më shumë çështje të reja gjatë vitit 2022 gjithsej 34382 çështje që përbëjnë 36% të totalit të çështjeve të regjistruara në nivel kombëtar pranë gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se është gjykata e cila ka mbartur më shumë çështje për vitin 2023 në numrin total 19275 çështje (48% e stokut total për këtë grup gjykatash), gjithashtu rezulton si gjykata që ka regjistruar më shumë çështje të reja gjatë vitit 2023 gjithsej 31883 çështje që përbëjnë 38% të totalit të çështjeve të regjistruara në nivel kombëtar pranë gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm për vitin 2022 ka qenë 776 çështje për gjyqtar, ndërkohë që 1 gjyqtar pranë gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka pasur në ngarkim mesatarisht 1361 çështje për gjyqtar.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm për vitin 2023 ka qenë 841.7 çështje për gjyqtar, ndërkohë që 1 gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka pasur në ngarkim mesatarisht 1176 çështje.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në vitin 2022, për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, është 563 çështje për gjyqtar, ndërkohë që 1 gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka gjykuar mesatarisht 872 çështje.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në vitin 2023, për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, është 547 çështje për gjyqtar, ndërkohë që 1 gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka gjykuar mesatarisht 718 çështje. Ky numër përbën numrin më të lartë të çështjeve të gjykuara për gjyqtar krahasuar me gjykatat e tjera të të njëjtit nivel gjatë vitit 2023.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e ushtron veprimtarinë në dy dhoma përkatësisht Dhoma Penale dhe Dhoma Civile. Dhoma Civile është e organizuar në dy seksione, në seksionin civil-tregtar dhe seksionin familjar.

Referuar analizës vjetore të gjykatës për vitin 2023 numri i gjyqtarëve të cilët kanë ushtruar funksionin në dhomën civile gjatë vitit 2023 është 31 gjyqtarë përkatësisht 25 gjyqtar në seksionin civil-tregtar dhe 6 gjyqtarë në seksionin familjar.

Në këtë analizë parashtrohet gjithashtu se kryesekretaria, dhoma civile e ka filluar vitin e ri të punës 2023 me 16577 çështje të mbartura nga viti 2022 nga të cilat 9532 janë çështje themeli me palë kundërshtare.

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar gjithsej 34.500 çështje të reja ku përfshihen civile themeli, kërkesa civile, urdhra ekzekutimi dhe OJF.

Gjatë vitit 2023 kanë përfunduar gjithsej 18225 çështje ku përfshihen civile themeli, kërkesa civile, urdhra ekzekutimi dhe OJF.

Gjatë periudhës 01 mars 2023- 31 Maj 2023, në dhomën civile kanë ushtruar funksionin 26 gjyqtarë³³, sipas seksioneve të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Nr.	Gjyqtarët	Seksioni	Shënime
1.	A. B	Familjar	
2.	A. Zh	Civil/Tregtar	
3.	A. Kod	Civil/Tregtar	
4.	A. Sh	Civil/Tregtar	
5.	A. Gj	Familjar	Ardhur në Mars 2023
6.	A. Kr	Civil/Tregtar	
7.	A. Ka	Civil/Tregtar	
8.	A. Kos	Civil/Tregtar	Larguar më 15 mars 2023
9.	A. P	Civil/Tregtar	
10.	B. M	Civil/Tregtar	
11.	D. G	Civil/Tregtar	Ardhur në Prill 2023
12.	D. C	Civil/Tregtar	
13.	E. B	Civil/Tregtar	
14.	E. L.	Civil/Tregtar	Ardhur në Mars 2023
15.	E. Gj	Civil/Tregtar	Ardhur në Maj 2023
16.	E. Xh	Civil/Tregtar	Ardhur në Mars 2023
17.	E. P.	Civil/Tregtar	
18.	F. D	Civil/Tregtar	
19.	F. K	Civil/Tregtar	
20.	F. S	Familjar	
21.	J. H	Civil/Tregtar	

³³ Referuar informacionit të marrë me procesverbalin datë 04.11.2024. Me emailin e datës 11.11.2025 gjykata na ka informuar se referuar tabelës statistikore numri i gjyqtarëve që kanë dhënë vendime është: "27", për shkakun se gjyqtarja A.K (e cila ushtronte detyrën në dhomën penale për periudhën në fjalë) ka shpallur vetëm një vendim për një çështje të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe si pasojë është mbartur nga gjykata pas bashkimit të dy gjykatave në një të vetme.

22.	M. D	Familjar	
23.	M. Xh	Civil/Tregtar	
24.	N. R	Civil/Tregtar	
25.	V. Z	Familjar	
26.	B. K	Civil/Tregtar	

Gjykata shqyrton të gjitha llojet e çështjeve civile, familjare, tregtare që parashikohen përkatësisht në Kodin Civil, Kodin e Familjes, Kodin e Punës, në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, “Ligjin për falimentin”, Ligjin për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” dhe ligje të tjera të veçanta ku përfshihen shprehimisht çështje që hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e kësaj gjykate³⁴.

4.2. Sistemi për menaxhimin e çështjeve gjyqësore

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë aplikon sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ARK IT ndërkohë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë e cila është suprimuar ka aplikuar sistemin ICMIS.

Në kuadër të riorganizimit gjyqësor dhe në referim të vendimit të KLGj-së nr. 137 datë 28.03.2023, periudha e inspektimit përkon gjithashtu edhe me migrimin e të dhënave nga sistemi ICMIS i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë në sistemin e menaxhimit të çështjeve ARK IT.

Referuar analizës vjetore të vitit 2023 të kësaj gjykate rezulton se në këtë gjykatë në dhomën civile ka 19 salla gjykimi me sistem audio dhe se për shkak të mungesës së numrit të sallave të gjykimit në raport me numrin e gjyqtarëve, seancat gjyqësore zhvillohen nga gjyqtarët në sallat e gjykimit në bazë të një kalendari të miratuar paraprakisht nga Këshilli i Gjykatës. Referuar raportimit për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio vihet re se një numër i konsiderueshëm i proceseve gjyqësore është zhvilluar pa regjistrim audio.

4.3. Fakte të konstatuara dhe analiza e të dhënave të hedhura në “regjistrat fizik civilë” dhe të dhënat statistikore

4.3.1. “Regjistrat civilë”

“Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” e cila është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës nr.209 datë 27.10.2017 në nenin 38 të saj përcakton llojet e “regjistrave civilë” dhe përmbajtjen e

³⁴ Neni 36 i K.Proc.Civile “Juridiksioni” – Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod dhe në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera.

Neni 41 i K.Proc.Civile “Kompetenca në lëndë”- Në kompetencën të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera.

tyre. Sipas kësaj rregulloreje përcaktohet se sekretaria gjyqësore mban dhe administron regjistrat civilë ndër të cilët përmenden:

- **"Regjistri themeltar civil"** në të cilin regjistrohen të gjitha kërkesë paditë civile të paraqitura para gjykatës. Çështjet regjistrohen menjëherë pas depozitimit të kërkesëpadive në gjykatë. Në regjistrë pasqyrohet data e ardhjes, data e regjistrimit, palët dhe objekti. Shorti për shpërndarjen e çështjeve tek gjyqtarët bëhet menjëherë pas regjistrimit të kërkesëpadive. Në rastet kur çështja priset nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë dhe kthehet për rigjykim, duhet të shënohet në krye të regjistrit, përbi numrit, fjala "rigjykim" si dhe të pasqyrohet se nga cila gjykatë vjen dosja".
- **"Regjistri i vendimeve civile"**. Në regjistrin e vendimeve civile shënohen të gjitha vendimet civile me numër vendor, data e dhënies së vendimit, numri i aktit, data e paraqitjes, **emri i gjyqtarit**, emrat e palëve, objekti dhe numri i secancave".
- **"Regjistri i numërimit të vendimeve civile"** mbahet dhe plotësohet për vendimet civile në mënyrën e shpjeguar për regjistrin e numërimit të vendimeve penale.

Si burim informacioni për të konkluduar në lidhje me numrin e përgjithshëm të vendimeve të shpallura në lidhje me gjykimet me palë kundërshtare gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023 kanë shërhyer të dhënat që përmban regjistri fizik i shënuar "Numërori i vendimeve civile" i cili është administruar me shkresën e regjistruar në ILD me nr. 998/8 prot., datë 21.06.2024³⁵.

Nga këqyrja e të dhënave që përmban regjistri vihet re se në rubrikën "vendime" është regjistruar numri dhe data e shpalljes. Vendimet janë renditur në mënyrë kronologjike sipas datës së shpalljes duke filluar nga vendimi me nr. 879 datë 01.03.2023 si më poshtë:

Nga vendimi me nr.879 datë 01.03.2023 deri në vendimin me nr.900 datë 01.03.2023;

Nga vendimi me nr. 911 datë 01.03.2023 deri në vendimin me nr. 960 datë 06.03.2023;

Nga vendimi me nr. 971 datë 06.03.2023 deri në vendimin me nr. 2500 datë 26.05.2023;

Nga vendimi me nr. 2511 datë 26.05.2023 deri në vendimin me nr. 2631 datë 31.05.2023.

Nga analiza e numrave të vendimit duke qenë se vendimet janë renditur në rend kronologjik konstatohet se mungojnë tre fletë të regjistrit. Konkretisht nuk ndodhen të pasqyruar vendimet me numër 901-910 (përkatësisht 10 vendime), vendimet me numër 961-970 (përkatësisht 10 vendime), vendimet me numër 2501-2510 (përkatësisht 10 vendime).

³⁵ Me shkresën e gjykatës me nr. 2792/8 datë 20.06.2024. Në datë 04.11.2024 në ambientin e gjykatës është marrë me procesverbal një fletë e cila bën fjalë për regjistrimin e dy vendimeve të shpallura në datë 01.03.2023 përkatësisht vendimi me nr. 879 datë 01.03.2023 dhe vendimi nr. 880 datë 01.03.2023, fletë e cila nuk i ishte bashkëngjitur praktikës dokumentare të ardhur me shkresën 2792/8 datë 20.06.2024.

Numri total i vendimeve që pasqyrohet në regjistrin "Numërori i vendimeve civile", fotokopje të vënë në dispozicion nga gjykata **është 1723 vendime.**

Në këtë regjistër përveç numrit dhe datës së shpalljes së vendimit pasqyrohen edhe rubrika të tjera me qëllim për t'u plotësuar sikurse janë data e paraqitjes së kërkesë padisë në gjykatë, numri i protokollimit dhe data e regjistrimit të kërkesë padisë, palët ndërgjyqëse, objekti i padisë, dispozitivi, trupi gjykues, anëtarët, numri i seancave, afati i dorëzimit të vendimit, vendimi i Apelit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë.

Nga këqyrja e të dhënave vihet re se jo të gjitha rubrikat e regjistrit janë të plotësuara. Konkretisht rubrika "anëtarët", "Apeli" nuk rezultojnë të jenë të plotësuara ndërsa rubrika "gjykata e lartë" në pjesën më të madhe të vendimeve nuk rezulton të jetë e plotësuar. Nga analiza e të dhënave, referuar rubrikës "Data e paraqitjes" konstatohet se data më e hershme e kërkesë padisë është data 10.04.2017 (përfunduar me vendimin nr.944³⁶ datë 03.03.2023) ndërsa data më e vonshme është data 29.05.2023 (përfunduar me vendimin nr. 2619 datë 31.05.2023 dhe nr.2620 datë 31.05.2023).

Përsa i përket të dhënave të hedhura në rubrikën "Regjistri" vihet re se data e regjistrimit të kërkesë padisë në pjesën më të madhe përputhet me datën e paraqitjes së kërkesë padisë. Nga këqyrja e të dhënave në lidhje me datën e paraqitjes dhe datën e regjistrimit konstatohet se në disa raste ka hedhje gabim të të dhënave sepse data e paraqitjes është më e vonshme se data e regjistrimit³⁷ dhe në disa raste të tjera ka diferencë me një vit³⁸. Gjithashtu konstatohet se për çështjen me nr. regj. 620 sipas numërorit fizik rezultojnë këto të dhëna " data e paraqitjes 22.11.2018; data e regjistrimit 13.04.2023"³⁹.

Referuar të dhënave të hedhura në rubrikën "Objekti" vihet re se objektet e padive me të zakonshme për të cilat janë shpallur vendimet gjatë periudhës tremujore objekt inspektimi janë: Përmbushje detyrimi kontraktor; Kundërshtim i veprimeve përmbartimore; Pavlefshmëri titulli ekzekutiv; Pavlefshmëri testamenti; Shpërblim dëmi, Dëmshpërblim page; Lirim dhe dorëzim sendi; Pjesëtim pasurie; Zgjidhje martesë; Ushtrim përgjegjësie prindërore, Lëshim urdhër mbrojtje etj.

Gjithashtu në këtë regjistër në rubrikën "dispozitiv" gjejmë të dhëna përsa i përket mënyrës se si gjykata ka disponuar për çdo çështje, konkretisht me vendim për : "Kthim aktesh; Pushim, Pranim, Pranim pjesërisht, Refuzim, Rrëzim, Mos kompetencë lëndore/ tokësore".

³⁶ Referuar procesverbaleve të printuara nga sistemi elektronik rezultojnë se çështja ka qenë e pezulluar (kjo çështje është përfshirë në rastet studimore në vijim të raportit)

³⁷ Çështja me nr. regj.8596, 9006, 4148, 2793, 4615, 11585,11745.

³⁸ Çështja me nr. regj.5786, 9882, 8587, 6085, 8593 rezultojnë të paraqitura në vitin 2022 dhe regjistruara në vitin 2023 ndërkohë që viti i regjistrimit sipas tabelës me të dhëna statistikore është viti 2022.

³⁹ Sipas të dhënave statistikore rezultojnë këto të dhëna: "data e paraqitjes 22.11.2018; data e regjistrimit 22.11.2018; data e shortit 26.07.2022"

Në rubrikën "Trupi gjykues" është shënuar vetëm emri i një gjyqtari ndërsa në rubrikën "Anëtarët" nuk është hedhur asnjë e dhënë.

Në rubrikën "numri i seancave" është hedhur numri i seancave dhe në vijim janë plotësuar rubrikat në lidhje me datën e dorëzimit të vendimit.

Nga analiza e të dhënave që përmban regjistri fizik i shënuar "Numërori i vendimeve civile", duke ju referuar vetëm të dhënave që pasqyrojnë kohëzgjatjen e një procesi, konstatohet se këto të dhëna nuk janë të plota; konstatohen të dhëna të caktuara nuk përputhen me të dhënat statistikore; dhe evidentohen se në hedhjen e të dhënave ka gabime të konsiderueshme.

4.3.2. Kuadri rregullator në lidhje me të dhënat statistikore

Në lidhje me "Sistemin elektronik të teknologjisë së informacionit" në referim të nenit 92 pika 1 të ligjit nr. 115/2016 "Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë" parashikohet ndër të tjera se: "Këshilli i Ministrave miraton rregulla për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, që ndër të tjera parashikojnë:... b) sigurimin e aksesit të plotë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të dhënat që përmbajnë të gjithë sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Gjykatat, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe zyrat e prokurorisë".

Në pikën 2 të Nenit 92 të ligjit të sipërcituar parashikohet se: "Në përputhje me politikën e përgjithshme në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë është përgjegjës për: a) zhvillimin ose plesëmarrjen në zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në gjykata;... e) përmirësimin periodik të sistemit, për të siguruar zbatimin e kërkesave funksionale të gjykatave, të vet Këshillit dhe të organeve të tjera brenda sistemit të drejtësisë, si dhe për të reflektuar ndryshimet në ligjet procedurale; ë) sigurimin e saktësisë dhe sigurisë së të dhënave;... f) garantimin që sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit të të dhënave gjeneron informacione statistikore, të cilat janë të nevojshme për punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të organeve të tjera dhe që përputhen me standardet evropiane për treguesit e punës së gjyqësorit, të tilla si norma e evadimit të çështjeve, numri i çështjeve për gjyqtar, kohëzgjatja mesatare e çështjeve dhe kohëzgjatja e çështjeve në proces në raport me kohëzgjatjen mesatare etj., g) përcaktimin e rregullave për përdorimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, njësimit e futjes së të dhënave dhe për saktësinë e të dhënave".

Këshilli i Ministrave në mbështetje edhe të dispozitës së sipërcituar, ka nxjerr vendimin nr. 971 datë 02.12.2020 "Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë" si dhe vendimin nr. 972 datë 02.12.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e

kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë". Në referim të pikës 10 të vendimit nr.972/2020, përcaktohet se Bordi drejtues i QTI-së ushtron ndër të tjera kompetencat: "...e) përcakton rregulla dhe procedura përmes të cilave Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i garantohet akses i plotë, pa të drejtë modifikimi/ndërhyrjeje në sistemet e të dhënave dhe të teknologjisë së informacionit, siç parashikohet në ligj; gj) miraton masa që sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit të gjenerojnë informacionin statistikor që nevojitet për punën e të gjitha institucioneve në sistemin e drejtësisë, në konsultim të ngushtë me institucionet përkatëse;..."

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në referim të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", dhe konkretisht të nenit 89 shkronja "b"⁴⁰ dhe nenit 94 pika 4, shkronja "dh"⁴¹, me vendimin nr.47 datë 11.02.2021, ka miratuar "Udhëzuesin për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efijencës së gjykatave". Ky udhëzues ofron një tërësi rregullash për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore nëpërmjet tabelave standarde të unifikuara për të gjitha gjykatat.

Në seksionin 1 të këtij udhëzimi janë miratuar tabelat standarde për Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të cilat përmbajnë të dhëna statistikore në lidhje me: Ngarkesën e punës në secilën gjykatë; gjendjen e backlog-ut; prurjet e çështjeve të reja; ngarkesën mesatare të gjyqtarëve; normën e efijencës; raportin e qarkullimit të çështjeve; kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes; normën e zgjidhjes së çështjes; vjetërsinë e çështjes etj.

Në seksionin "udhëzime të përgjithshme" parashikohet si më poshtë:

"Sekretaritet gjyqësor në çdo gjykatë ndihmojnë me mirëmbajtjen e regjistrave dhe regjistrimeve të sakta në regjistra si dhe në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Udhëzim, përfshirë saktësinë e të dhënave (neni 44 i Ligjit nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R. Sh;

Kancelari, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës, mban përgjegjësi, mes të tjerave, edhe për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve (CMS) në gjykatë. Kancelari mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e saktë të të dhënave si dhe orienton dhe mbikëqyr punën e nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës që përfshihen në regjistrimin e të dhënave dhe në përpilimin e statistikave. Kancelari dërgon raporte periodike në Këshillin e Lartë

⁴⁰ Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:... b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë;

⁴¹ Rregullat standarde për efijencën e drejtësisë përfshijnë parashikime për: dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore;

Gjyqësor për përdorimin dhe funksionimin e CMS, si dhe raportin pa vonesë mbi nevojat dhe përditësimet e nevojshme të funksionimit të CMS (neni 39 i ligjit nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R.SH").

Deri në prodhimin në mënyrë elektronike të të gjitha statistikave të nevojshme... rekomandohet që të dhënat për çdo çështje të regjistruar të përmbajnë të paktën këto informacione: i) numrin e çështjes; ii) datën e regjistrimit; iii) objektin; iv) numrin e vendimit; v) datën e vendimit; vi) datën e zhvendësimit të vendimit të arsyetuar; vii) mënyrën e disponimit të gjykatës".

Në respektim të këtij udhëzimi, duke u kufizuar tek të dhënat që kanë lidhje me "Kohëzgjatjen e çështjes gjyqësore", referuar tabelës I "statistikat për çështjet civile sipas llojit të çështjes" të dhënat përse i përket çështjeve civile me palë kundërshtare si dhe çështjet civile në përgjithësi duhet të përmbajnë ndër të tjera tregues në lidhje me administrimin e çështjeve dhe tregues në lidhje me kohëzgjatjen e çështjeve të gjykuara si dhe me efikasitetin.

Gjithashtu ky udhëzim ka përcaktuar se: "Për qëllime të statistikave për performancën dhe efikasitetin e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit".

Përse i përket treguesve statistikorë në lidhje me kohëzgjatjen e çështjeve të gjykuara, në këto tregues përfshihen ndër të tjera: Numri dhe përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes; Kohëzgjatja mesatare e çështjes.

Përse i përket treguesve statistikore në lidhje me efikasitetin, në këtë tregues përfshihen ndër të tjera: Norma e likuidimit të çështjeve; numri dhe përqindja e çështjeve në pritje të gjyqimit mbi dy vjet.

Përse i përket treguesve statistikorë në lidhje me seancat gjyqësore, në këtë tregues përfshihen numri i seancave gjyqësore të mbajtura në prani të palëve, duke përfshirë seancat përgatitore dhe të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë si dhe numrin mesatar të seancave të mbajtura për çështje sipas kategorisë së çështjes.

4.3.3. Saktësia e të dhënave

Duke qenë se inspektimi do të mbështetet kryesisht tek të dhënat përse i përket kohëzgjatjes së çështjeve gjyqësore civile me palë kundërshtare të cilat janë përfunduar për periudhën 01.03.2023-31.05.2023, është vlerësuar fillimisht të verifikohet saktësia e të dhënave të hedhura në "Numërorin e vendimeve civile" dhe i të dhënave statistikore të ardhura në mënyrë elektronike nga gjykata.

- Verifikimi i të dhënave statistikore dhe të dhënave të regjistrit fizik “numërori i vendimeve civile” përse i përket datës së regjistrimit të kërkesë padisë.

Referuar të dhënave statistikore të hedhura në tabelën “Excel” rezulton se shumica e kërkesë padive janë paraqitur dhe janë regjistruar brenda ditës ose në ditën e nesërme. Konkretisht numri i çështjeve të cilat janë regjistruar brenda ditës është 1716 çështje, ndërsa 3 çështje janë regjistruar në ditën e nesërme të paraqitjes në gjykatë. Ndërkohë që 29 çështje janë regjistruar pas më shumë se 1 ditë.

Nga 29 çështjet e sipërcituara, u përzgjedhën për verifikim pesë prej tyre të cilat figuronin se kishin diferencat më të mëdha kohore midis datës së paraqitjes në gjykatë dhe datës së regjistrimit, konkretisht kishin diferenca nga 27 deri në 33 ditë. Nga verifikimi i të dhënave në numërorin fizik u konstatua se kishte mospërputhje të datës së regjistrimit të këtyre çështjeve midis të dhënave statistikore të hedhura në tabelën Excel dhe në numërorin e vendimeve. Referuar numërorit fizik rezulton se këto 5 çështje rezultojnë të jenë regjistruar brenda ditës. Mospërputhjet janë pasqyruar në tabelën më poshtë:

5 Çështjet me periudhën më të gjatë nga data e paraqitjes së kërkesë padisë deri në datën e regjistrimit		
Nr. Regjistri	Periudha që është kryer regjistrimi sipas tabelës “Excel” (ditë)	Periudha që është kryer regjistrimi sipas regjistrat fizik (ditë)
Nr. 10334 Regj., datë 25.01.2023	33	Brenda ditës
Nr. 10348 Regj., datë 25.01.2023	29	Brenda ditës
Nr. 10347 Regj., datë 25.01.2023	29	Brenda ditës
Nr. 10353 Regj., datë 25.01.2023	28	Brenda ditës
Nr. 10376 Regj., datë 25.01.2023	27	Brenda ditës

- Verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi elektronik si dhe të dhënave të pasqyruara në regjistrin “numërori i vendimeve civile” në raport me të dhënat e fashikujve gjyqësor fizikë.

Saktësia e të dhënave statistikore është shumë e rëndësishme jo vetëm në drejtim të matjes së performancës dhe efikasitetit të gjykatës por edhe në drejtim të transparencës, llogaridhënies, evidentimit të problematikave si dhe identifikimit të nevojave për

përmirësim të vazhdueshme të veprimtarisë gjyqësore. Statistikat jo të plota apo me gabime shtrembërojnë panoramën reale të gjendjes së gjyqësorit dhe sjellin si pasojë vlerësime jo të sakta dhe strategji jo efektive të cilat nuk përmbushin qëllimin për rritjen e cilësisë, efektivitetit edhe efikasitetit të gjykatës.

Në kuadër të verifikimit nëse janë të hedhura saktë të dhënat në sistemin elektronik dhe në regjistrin fizik "Numërori i vendimeve civile", nga ana jonë janë përzgjedhur 10 fashikuj gjyqësor fizik, të cilat ndodheshin në ambientin e gjykatës, si më poshtë:

1. Çështja nr. 5979 regj. datë 01.03.2022, me objekt "Njohje bashkëpronar"

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet data e shortit si dhe emri i gjyqtarit të çështjes. Regjistri "Numërori i vendimeve civile" pasqyron 6 (gjashtë) seanca të zhvilluara për këtë çështje ndërsa sistemi elektronik pasqyron 7 (shtatë) seanca për këtë çështje si dhe shkaqet e shtyrjes së tyre. Në dosjen fizike disponohen 5 procesverbale për "mbajtjen e seancave përgatitore"⁴².

Gjetje: Nga këqyrja e të dhënave të pasqyruara në numërorin e vendimeve civile, sistemin elektronik si dhe dosjen fizike rezulton se ka një mospërputhje në numrin e seancave të pasqyruara midis tyre për këtë gjykim.

Gjithashtu evidentohet se regjistri "numërori i vendimeve civile" në rubrikën "seanca" përmban të dhëna mbi numrin në total të seancave të zhvilluara pa specifikuar llojin e seancave (përgatitore apo gjyqësore).

Nga ana tjetër, sistemi elektronik përfshin në rubrikën "Seanca" edhe vendimet e gjyqtarit për veprimet paraprake duke pasqyruar kështu një numër seancash më të madh se sa janë zhvilluar në të vërtetë.

2. Çështja nr. 11642 regj., datë 07.03.2023, me objekt "Pagim shume"

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes. Nga këqyrja e dosjes fizike konstatohet se kjo çështje për shkak të llojit të padisë objekt shqyrtimi, i është nënshtruar procedurës së shqyrtimit të padive për shumën të vogla sikundër përcaktohet në nenin 162/a të K.Pr.C.

Numërori i vendimeve civile dhe sistemi elektronik pasqyron 1 (një) seancë për këtë çështje. Në dosjen fizike disponohet 1 procesverbal seance (datë 16.05.2023) për marrjen në shqyrtim të çështjes pa prani të palëve⁴³.

Gjetje: Numri i seancave të zhvilluara për këtë gjykim sipas dosjes fizike përputhet me numrin e seancave të evidentuara në numërorin e vendimeve civile dhe në sistemin elektronik. Gjithashtu rezulton se numërori i vendimeve civile përmban të dhëna mbi

⁴² Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezultojnë 5 seanca.

⁴³ Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezultojnë 1 seancë.

numrin në total të seancave të zhvilluara pa specifikuar llojin e seancës (përgatitore, dhomë këshillimi apo gjyqësore).

3. Çështja nr. 12131 regj., datë 04.04.2023, me objekt "Zgjidhje martesë".

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes. Numërori i vendimeve civile dhe sistemi elektronik pasqyron 2 (dy) seanca për këtë çështje. Gjithashtu sistemi elektronik pasqyron ndër të tjerash dhe shkaqet e shtyrjes së seancave (në rastin konkret ka vetëm një rast shtyrje seance pajtimi). Në dosjen fizike disponohen 2 procesverbale seancash për këtë gjykim⁴⁴.

Gjetje: Numri i seancave të zhvilluara për këtë gjykim sipas dosjes fizike përputhet me numrin e seancave të evidentuara në numërorin e vendimeve civile dhe në sistemin elektronik. Gjithashtu evidentohet se numërori i vendimeve civile përmban të dhëna mbi numrin në total të seancave të zhvilluara pa specifikuar llojin e seancës (përgatitore, pajtimi apo gjyqësore).

4. Çështja nr. 12346 regj., datë 12.04.2023, me objekt "Urdhër mbrojtje i menjëhershëm".

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes.

Numërori i vendimeve civile dhe sistemi elektronik pasqyron 1 (një) seancë të zhvilluara për këtë çështje. Në dosjen fizike disponohet një procesverbal seance i zhvilluar për këtë gjykim.

Gjetje: Numri i seancave të zhvilluara për këtë gjykim sipas dosjes fizike përputhet me numrin e seancave të evidentuara në numërorin e vendimeve civile dhe në sistemin elektronik.

5. Çështja nr. 9975 regj., datë 13.12.2022, me objekt "Përmbushje detyrimi kontraktor".

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes. Nga këqyrja e dosjes fizike konstatohet se kjo çështje për shkak të llojit të padisë objekt shqyrtimi, i është nënshtruar procedurës së shqyrtimit të padive për shuma të vogla sikundër përcaktohet në nenin 162/a të K.Pr.C.

Numërori i vendimeve civile pasqyron 1 (një) seancë të zhvilluar për këtë çështje ndërsa sistemi elektronik pasqyron 2 (seanca) për këtë dosje. Në dosjen fizike disponohet 1 procesverbal seance (datë 10.03.2023) për marrjen në shqyrtim të çështjes në dhomë këshillimi (pa prani të palëve)⁴⁵.

⁴⁴ Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezulton 1 seancë.

⁴⁵ Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezulton 1 seancë.

Gjetje: Nga këqyrja e të dhënave të pasqyruara në numërorin e vendimeve civile, sistemin elektronik si dhe dosjen fizike rezulton se ka një mospërputhje në numrin e seancave të pasqyruara midis tyre për këtë gjykim. Sistemi elektronik rezulton të ketë përfshirë në rubrikën "seanca" edhe vendimin e gjyqtarit për veprimet paraprake (datë 19.12.2022) duke pasqyruar kështu një numër seancash më shumë se sa janë zhvilluar në të vërtetë. Gjithashtu evidentohet se numërori i vendimeve civile përmban të dhëna mbi numrin në total të seancave të zhvilluara pa specifikuar llojin e seancës (përgatitore, në dhomë këshillimi apo gjyqësore).

6. Çështja nr. 8726 regj., datë 27.09.2022, me objekt "Kundërshtim atësie".

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes.

Numërori i vendimeve civile dhe sistemi elektronik pasqyron 6 (gjashtë) seanca për këtë çështje. Gjithashtu sistemi elektronik pasqyron ndër të tjerash dhe shkaqet e shtyrjes së seancave. Në dosjen fizike disponohen 5 procesverbale seancash për këtë gjykim dhe një shënim për mos zhvillimin e seancës së paracaktuar më datë 31.03.2023⁴⁶.

Gjetje: Numri i seancave të evidentuara në numërorin e vendimeve civile përputhet me numrin e seancave të evidentuara në sistemin elektronik por jo me numrin e seancave të zhvilluara de fakto sipas dosjes fizike. Gjithashtu evidentohet se numërori i vendimeve civile përmban të dhëna mbi numrin në total të seancave të zhvilluara pa specifikuar llojin e seancës (përgatitore apo gjyqësore).

7. Çështja nr. 6357 regj., datë 30.03.2022, me objekt "Përmbyshje detyrimi kontraktor".

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes.

Numërori i vendimeve civile pasqyron 3 (tre) seanca të zhvilluara për këtë çështje. Ndërsa sistemi elektronik pasqyron 6 (gjashtë) seanca për këtë çështje ku përfshihen 3 seanca që i përkasin veprimeve paraprake, 1 seancë përgatitore dhe dy seanca gjyqësore nga të cilat seanca e parë gjyqësore nuk është zhvilluar për shkak të shkaqeve shëndetësore ndërsa seanca e dytë gjyqësore është zhvilluar duke përfunduar me shpalljen e vendimit⁴⁷.

Në dosjen fizike disponohen 2 procesverbale për veprimet paraprake të gjyqtarit të çështjes që i përket datave 12.04.2022 dhe 06.02.2023, një procesverbal për seancën përgatitore datë 13.03.2023 si dhe një procesverbal për seancën gjyqësore 13.04.2023r. Gjithashtu në dosje ndodhet një shënim që pasqyron faktin se seanca e datës 23.03.2023 nuk është zhvilluar për shkaqe shëndetësore.

⁴⁶ Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezultojnë 6 seanca.

⁴⁷ Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezultojnë 3 seanca

Gjetje: Nga këqyrja e të dhënave të pasqyruara në numërorin e vendimeve civile, sistemin elektronik si dhe dosjen fizike rezulton se ka një mospërputhje në numrin e seancave të pasqyruara midis tyre për këtë gjykim. Sistemi elektronik rezulton të ketë përfshirë në rubrikën "seanca" edhe veprimet paraprake si dhe seancën përgatitore dhe gjyqësore.

8. Çështja nr.11878 regj., datë 20.03.2023, me objekt "Miratim projekt marrëveshje për zgjidhje martesë me pajtim".

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes.

Numërori i vendimeve civile dhe sistemi elektronik pasqyron 3 (tre) seanca për këtë çështje. Gjithashtu sistemi elektronik pasqyron ndër të tjerash dhe shkaqet e shtyrjes së seancave (në rastin konkret ka vetëm një rast shtyrje seance gjyqësore). Në dosjen fizike disponohen 2 procesverbale seancash për këtë gjykim. Procesverbalet e disponuar në këtë dosje fizike nuk specifikojnë në titull llojin e seancës për të cilin mbahet secili prej tyre. Lloji i seancës dhe të gjitha elementët e tjerë evidentohen në përmbajtje të procesverbalit. Nga këqyrja e procesverbalit të datës 11.04.2023, rezulton se ky i fundit të jetë mbajtur për dy seanca të njëpasnjëshme të zhvilluara brenda kësaj date, seancën e pajtimit dhe atë gjyqësore⁴⁸.

Gjetje: Numri i seancave të zhvilluara për këtë gjykim sipas dosjes fizike përputhet me numrin e seancave të evidentuara në numërorin e vendimeve civile dhe në sistemin elektronik. Gjithashtu evidentohet se numërori i vendimeve civile përmban të dhëna mbi numrin në total të seancave të zhvilluara pa specifikuar llojin e seancës (përgatitore apo gjyqësore).

9. Çështja nr.10613 regj., datë 27.01.2023, me objekt "Kundërshtim i veprimeve përmbartimore".

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes.

Numërori i vendimeve civile dhe sistemi elektronik pasqyron 3 (tre) seanca për këtë çështje. Nga këqyrja e sistemit elektronik, rezultojnë 3 (tre) seanca përkatësisht datë 13.03.2023, **24.04.2023** dhe 25.04.2023. Referuar shënimit në procesverbalin e seancës datë 13.03.2023 rezulton se seanca shtyhet për shpalljen e vendimit në datë 25.04.2023.

Në procesverbalin e datës 24.04.2023 nuk ka shënime të hedhura. Ndërsa në procesverbalin e datës 25.04.2023 gjykata ka vijuar gjykimin me shpalljen e vendimit.

⁴⁸ Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezultojnë 3 seanca.

Ndërkohë në dosjen fizike disponohen 3 (tre) procesverbale seancash të zhvilluara më datë 13.03.2023, **06.04.2023** dhe 25.04.2023⁴⁹.

Konkretisht seancat e zhvilluara më datë 13.03.2023 dhe 06.04.2023 referohen në procesverbalet respektive si seanca gjyqësore ndërsa seanca e datës 25.04.2023 ka vijuar me shpalljen e vendimit.

Gjetje: Numri i seancave të zhvilluara për këtë gjykim sipas dosjes fizike përputhet me numrin e seancave të evidentuara në numërorin e vendimeve civile dhe në sistemin elektronik. Ndërkaq nga këqyrja e procesverbaleve, rezulton se të dhënat e procesverbaleve të seancave të hedhura në sistem elektronik nuk përputhen me ato të dhënat e procesverbaleve të disponuara në dosjen fizike (vetëm përse i përket një seance).

10. Çështja nr. 12674 regj., datë 30.04.2023, me objekt "Lëshim urdhër mbrojtje".

Konstatime: Në numërorin e vendimeve civile dhe sistemin elektronik pasqyrohet emri i gjyqtarit të çështjes. Numërori i vendimeve civile dhe sistemi elektronik pasqyron 1 (një) seancë për këtë çështje. Në dosjen fizike disponohet 1 (një) procesverbal seance gjyqësore, zhvilluar për këtë gjykim⁵⁰.

Gjetje: Numri i seancave të zhvilluara për këtë gjykim sipas dosjes fizike përputhet me numrin e seancave të evidentuara në numërorin e vendimeve civile dhe në sistemin elektronik.

Përmbledhje e gjetjeve në tërësi : Nga këqyrja në tërësi e të dhënave të regjistrit fizik "Numërori i vendimeve civile" evidentohet emri i gjyqtarit relator ose emri i gjyqtarit kur vendimi është dhënë nga një gjyqtar i vetëm. Në rast se është caktuar trup gjykues, nuk evidentohen dy gjyqtarët e tjerë pjesë e trupit gjykues.

Në të dhënat statistikore të dërguara nga Gjykata konstatohet se për një numër të konsiderueshme çështjesh, rubrika "data e shortit" nuk rezulton e plotësuar⁵¹.

Gjithashtu konstatohet se numri i seancave të pasqyruara në të dhënat statistikore nuk përkon "vetëm" me numrin e seancave të zhvilluara në prani të palëve sipas treguesit "numri i seancave" në referim të udhëzimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.47 datë 11.02.2021, tabela 1 (statistikat për çështjet civile sipas llojit të çështjes), kolona 25.

Referuar të dhënave që përmban regjistri fizik por edhe të dhënave të siguruara nga sistemi elektronik është e pamundur të identifikohet se kur gjyqtari ka vendosur në lëvizë çështjen në kuptimin që nuk mund të identifikohet perioda kohore e veprimtarisë së gjyqtarit përse i përket veprimeve të gjyqtarit në lidhje me vlerësimin e kushteve të padisë apo në lidhje me veprimet paraprake në referim të nenit 158, 158/a të K.Pr.C.

⁴⁹ Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezultojnë 3 seanca.

⁵⁰ Ndërsa referuar tabelës "Excel" me të dhëna statistikore rezulton 1 seancë.

⁵¹ Çështja me nr. 9878 regj. Datë 07.12.2022; 10868 datë 31.03.2023; 5441 regj., datë 26.01.2022 etj.

Gjithashtu duke ju referuar ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Civile përsa i përket llojit të seancave të zhvilluara, në regjistrin fizik dhe atë elektronik jepet informacion vetëm për “numrin e seancave” ku tek këto seanca përfshihen ndonjëherë edhe seancat përgatitore, dhe si rrjedhim është i pamundur të identifikohet lloji i seancës nëse është përgatitore apo gjyqësore.

4.4. Transparenca

Neni 91, pika 1, shkronja “f” i ligjit nr. 115 i vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”⁵², me ndryshimet përkatëse, parashikon ndër të tjera se: “*Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen detyrat e mëposhtme: “hën të mundur që secila gjykatë të ketë hapësin e saj të veçantë në portalin në internet dhe të lejohet të publikoj në të, të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore; merr masa që publiku të informohet mbi veprimtarin e gjykatave si dhe për çështje të veçanta gjyqësore.*

Në Vendimin nr. 47 datë 11.02.2021 për miratimin e Udhëzuesit “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave” parashikohet ndër të tjera në rubrikën “udhëzime të përgjithshme” se “*për gjykatat e çdo niveli dhe juridiksioni, tabelat standarde duhet të plotësohen çdo vit dhe të publikohen në faqen zyrtare të gjykatës brenda dy javësh pas përfundimit të çdo periudhe raportuese ...*”.

Nga vëzhgimi dhe monitorimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se tabelat standarde sipas vendimit nr. 47 datë 11.02.2021 të KLGJ-së nuk janë të publikuara. Në mungesë të publikimit, është e pamundur të verifikohet në mënyrë publike efikasiteti dhe performanca e gjykatës për periudha të caktuara. Ndërsa rezulton se analizat vjetore për vitet 2012 – 2024 janë të publikuara.

5. Analiza e të dhënave dhe gjetjet e inspektimit në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjykatës

5.1. Numri i vendimeve të shpallura nga gjykata në lidhje me çështjet civile me palë kundërshtare gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023

Të dhënat në lidhje me “Vendimet civile me palë kundërshtare të shpallura për periudhën 01.03.2023-31.05.2023” të dërguar nga gjykata në formë elektronike⁵³ në tabelë “Excel”, fillojnë me vendimin nr. 879, të shpallur në datë 01.03.2023, për çështjen me nr. regjistri 8835, datë 03.10.2022 dhe përfundojnë me vendimin nr. 2631, të shpallur në datë 31.05.2023, për çështjen me nr. regjistri 7800, datë 15.07.2022.

⁵² Neni 2 “Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit”.

⁵³ Protokoluar në ILD me nr.998/6 datë 13.06.2024

Nga studimi dhe përpunimi i të dhënave të ardhura nga gjykata si më sipër, konstatohet se:

- Numri total i vendimeve është 1754 vendime.
- Konstatohet se gjashtë vendime janë të hedhura dy herë, përkatësisht vendimet: nr. 960; nr. 1726; nr. 2085; nr. 2119; nr. 2270; nr. 2531.
- Nga rendi kronologjik i vendimeve nr. 879-2631, në tabelën "Excel" nuk janë pasqyruar pesë vendime, përkatësisht vendimet nr. 1207; nr. 1238; nr. 2199; nr. 2479; nr. 2538, të cilat rezultojnë të regjistruara në regjistrin fizik.
- Numri total i vendimeve të pasqyruara në tabelën "Excel" duhet të ishte 1753 vendime (duke hequr 6 vendimet e hedhura dy herë dhe duke shtuar pesë vendimet që nuk janë pasqyruar në tabelën Excel).
- Numri real i vendimeve (duke hequr gjashtë vendimet e hedhura dy herë) referuar të dhënave të ardhura në mënyrë elektronike nga gjykata është 1748 vendime.

Referuar të dhënave statistikore rezulton se në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të përgjithshëm Tiranë (dhoma civile) për periudhën 01.03.2023-31.05.2023 në lidhje me çështjet civile me palë kundërshtare janë shpallur 1748 vendime nga 27 gjyqtarë.

Numri i vendimeve të shpallura për secilin gjyqtar është pasqyruar sipas tabelës në vijim:

1. TABELA E GJYQTARËVE MBI NUMRIN E VENDIMEVE TË SHPALLURA PËR PERIUDHËN TRE MUJORE 01.03.2023 - 31.05.2023

Nr.	Gjyqtarët	Vendimet për periudhën 01.03.2023-31.05.2023
1	A. B	219
2	A. Zh	90
3	A. Kod	64
4	A. Sh	78
5	A. Gj ⁵⁴	60
6	A. Kr	45
7	A. Ka	40
8	A. Kos ⁵⁵	10
9	A. P	52
10	B. M	56
11	D. G ⁵⁶	2

⁵⁴ A. Gj ardhur në mars të vitit 2023.

⁵⁵ Larguar në 15 mars 2023

⁵⁶ Ardhur në prill 2023

12	D. C	66
13	E. B	66
14	E. L ⁵⁷	12
15	E. Gj ⁵⁸	2
16	E. Xh ⁵⁹	28
17	E. P	101
18	F. D	38
19	F. K	31
20	F. S	177
21	J. H	58
22	M. D	182
23	M. Xh	73
24	N. R	33
25	V. Z	128
26	B. K	36
27	A. K	1
Totali		1748

Gjyqtare A. K nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtareve në dhomën civile referuar listës së përcjellë nga zyra e burimeve njerëzore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë por nga të dhënat e vendimeve civile në formë tabelore vihet re se kjo gjyqtare gjatë periudhës objekt inspektimi ka përfunduar një gjykim me objekt “lëshim urdhër mbrojtje”.

5.2. Fakte të konstatuara në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve si dhe kohëzgjatjen mesatare për çështjet civile me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës 01.03.2025 – 31.05.2025

5.2.1. Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore

Referuar analizës së të dhënave në lidhje me periudhën kohore brenda së cilës çështjet kanë përfunduar, konstatohet se nga 1748 çështjet civile me palë kundërshtare të përfunduara, 346 çështje janë përfunduar brenda 30 ditëve, ndërsa 1 483 çështje janë përfunduar brenda një periudhe dyvjeçare. Gjithashtu konstatohet se 264 çështje ose 15% kanë zgjatur me tepër se dy vjet.

Në tabelën dhe grafikun e sipërcituar, paraqiten të dhëna më të detajuara në lidhje me numrin dhe përqindjen e çështjeve civile të përfunduara, në fasha të caktuara kohore, në

⁵⁷ Ardhur në mars 2023

⁵⁸ Ardhur në maj 2023

⁵⁹ Ardhur në mars 2023

raport me numrin total të çështjeve të përfunduara në periudhën tre mujore objekt inspektimi.

Kohëzgjatja e çështjeve	Numri i Çështjeve
0-30 ditë	346
1 muaj - 6 muaj	253
6 muaj - 1 vit e 6 muaj	645
1 vit e 6 muaj - 2 vite	239
2 vite - 2 vite e 6 muaj	109
Mbi 2 vite e 6 muaj	155
Totali	1,747*



*Sipas të dhënave statistikore të paraqitura nga gjykata në formatin elektronik "Excel" rezultojnë që për një vendim, kërkesëpadia rezultojnë të jetë paraqitur një ditë më vonë se data e paraqitjes dhe afati i gjykimit të kësaj çështjeje rezultojnë (-1) ditë. Duke qenë se është evidentuar pasaktësi të dhënash, kjo çështje është përjashtuar nga përllogaritja në këtë indikator.

5.2.2. Kohëzgjatja mesatare

Referuar raportit vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023, koha mesatare për likuidimin e një çështjeje civile gjatë vitit 2023 për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm është 272 ditë, ndërsa koha mesatare për gjykimin e një çështjeje civile gjatë vitit 2023 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është 332 ditë.

Koha mesatare e kohëzgjatjes së gjykimit për 1748 çështjet civile me palë kundërshtare të përfunduara për periudhën 01.03.2023-31.05.2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm, Dhoma civile, është 398 ditë.

Në tabelën më poshtë pasqyrohet koha mesatare e kohëzgjatjes së gjykimeve të përfunduara për periudhën tre mujore 01.03.2023-31.05.2023 për secilin gjyqtar. Kemi parasysh këtë faktin se gjyqtaret kanë shqyrtuar mosmarrëveshje të ndryshme në varësi të seksionit ku ata kanë qenë.

Koha mesatare e gjykimit për secilin gjyqtar		
Nr.	Gjyqtari	Koha mesatare në ditë
1	A. Gj ⁶⁰	17
2	A. B	224
3	A. Zh	552
4	A. Kod	549
5	A. Sh	461
6	A. G	358
7	A. Ka	669
8	A. P	458
9	A. Kos	332
10	A. Kë	18
11	B. M	637
12	B. K	325
13	D. G ⁶¹	11
14	D. C	626
15	E. L ⁶²	85
16	E. Gj ⁶³	163
17	E. B	505
18	E. P	470
19	E. Xh ⁶⁴	262
20	F. S	331
21	F. D	672
22	F. K	665
23	J. H	508
24	M. D	331
25	M. Xh	574
26	N. R	268
27	V. Z	250

5.2.3. Mënyra e përfundimit të çështjeve

Mënyra e përfundimit të 1748 çështjeve civile me palë kundërshtare përgjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023 është pasqyruar si më poshtë:

⁶⁰ Ardhur në mars 2023.

⁶¹ Ardhur në prill 2023.

⁶² Ardhur në mars 2023.

⁶³ Ardhur në maj 2023.

⁶⁴ Ardhur në mars 2023.

Mënyra e përfundimit të çështjeve	Numri i çështjeve
Pranuar	702
Pushuar	503
Rrëzuar	176
Pranuar pjesërisht	137
Kthim aktesh	119
Refuzuar	53
Mos kompetenca	44
Mospranim	8
Të tjera	5
Pajtuar	1
Totali	1748

5.3. Fakte të konstatuara në lidhje me objektin e padisë dhe kohëzgjatjen mesatare në varësi të llojit të objektit të padisë

Nga analiza e të dhënave në lidhje me objektin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes rezulton se numrin më të madh të vendimeve të shpallura e zënë çështjet që kanë për objekt “Zgjidhjen e martesës” dhe në vijim çështjet me objekt “Lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes” dhe “Pëmbushje e detyrimit civile”.

5.3.1. Lloji i objektit të padisë

Lëmi i mosmarrëveshjeve⁶⁵ sipas objektit për të cilat janë shpallur vendimet në periudhën tremujore objekt inspektimi është si më poshtë:

Objekti i Padisë	Numri i çështjeve
Padi për zgjidhje Martese	341
Lëshim urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes	225
Pëmbushje detyrimi Civil	159
Pëmbushje Detyrimi Tregtar	138
Padi civile me masë sigurimi	103
Padi për marrëdhënie pune	99
Padi Shkaktim Dëmi	82
Padi pronësie	64
Kërkesë për vërtetimin e faktit juridik të marrëdhënies së punës	53
Padi të Tjera (Civile në përgjithësi)	52
Zgjidhje Martese me marrëveshje	42
Lëshim urdhër mbrojtje	41

⁶⁵ Referuar kategorizimit të çështjeve sipas tabelës me të dhënat statistikore të vëna në dispozicion nga gjykata.

Lëshim autorizimi	30
Padi kundërshtim veprimi përmbarimor	25
Pavlefshmëri titulli ekzekutiv	23
Vërtetim fakti	21
Padi të Tjera (Çështje Tregtare)	18
Padi të Tjera (Çështje familjare)	15
Padi Kontrate Sipërmarrje	13
Padi të tjera Kontraktuale	12
Padi të kontratave të shitjes	12
Caktim kujdestarie	11
Kërkese për Caktim Përfaqësuesi Ligjor	11
Ushtrim i përgjegjësisë prindërore	10
Ndryshim Vendimi Familjar	10
Padi çnjohje atësie	9
Padi Pjesëtimi Pasurie Bashkëshortore	9
Vërtetim i vjetërsisë në punë	9
Padi Kontratë Huaje	8
Pagim Shume Civile	8
Padi për shfuqizim/ndryshim akti administrativ	7
Padi Kontratë Qiraje	6
Padi pjesëtim sendi	6
Padi Trashëgimie	6
Heqje e zotësisë për të vepruar	6
Vendosje në Përkujdesje Alternative	6
Padi për njohje atësie	5
Padi Kërkim Sendi	5
Padi për kthim shume	5
Padi për mbrojtjen e pronësisë intelektuale	4
Pavlefshmëri/ Kundërshtim Vendimi AKKP	3
Padi për Kthim Sendi	3
Padi familjare me masë sigurimi	3
Korrigjim në aktet e gj. Civile	3
Kërkesë për birësim	3
Padi Kontrate Dhurimi	2
Padi Servituti	2
Padi Posedimore	2
Anulim i Veprimeve Përmbarimore	2
Padi Kontrate Furnizimi	1
Padi Kontrate Huapërdorje	1
Padi për kalim pasurie	1
Padi Kontrate Bankare	1
Padi Kontrate Franchising	1

Padi Pension Ushqimor	1
Kërkese për deklarim falimentimi	1
Padi gjerimi i punëve të tjetrit	1
Konstatim Shkelje Afati të Arsyeshëm	1
Rivendosje ne Afat e të Drejtës	1
Kërkese për Likuidim Shoqërie (Tregtare)	1
Kthim Shume (Tregtare)	1
Padi Begatim Pa Shkak	1
Veçim pjese takuese	1
Pagim Shume Tregtare	1
Korrigjimi i të dhënave personale Padi	1
Totali	1748

5.3.2. Kohëzgjatja mesatare e proceseve gjyqësore në varësi të objektit të padisë

Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023-31.05.2023, në varësi të llojit të objektit të padisë paraqitet si më poshtë:

- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore" është 265 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi pronësie" është 369 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Lëshim urdhër mbrojtje" është 10 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi kontrate huaje" është 571 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi të tjera kontraktuale" është 929 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi kontrate qiraje" është 610 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi kontrate sipërmarrje" është 640 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi për zgjidhje martesë" është 411 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Shkaktim dëmi" është 667 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Kontratë shitje" është 692 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi për marrëdhënie pune" është 610 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi për përmbushje detyrimi civil" është 432 ditë.

- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Pagim shume civile" është 920 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Përmbushje detyrimi tregtar" është 510 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Padi të tjera çështje tregtare" është 1145 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Pavlefshmëri titulli ekzekutiv" është 520 ditë.
- Koha mesatare e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me objekt "Civile të tjera dhe ekstra" (padi të tjera kontraktuale/padi për mbrojtjen e pronës intelektuale/padi poseidimore/pasi pjesëtim sendi/vërtetim fakti/ padi të tjera civile/ padi civile me masë sigurimi) është 387 ditë.

6. Fakte të konstatuara në lidhje me shkaqet e zgjatjes së proceseve në varësi të llojit të objektit të padisë

Në kuadër të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e procesit gjyqësor por edhe kohëzgjatjen e tij në varësi të llojit të objektit të padisë, janë përzgjedhur si raste studimore 2 çështje gjyqësore për secilin objekt padie, përkatësisht një çështje për të cilën procesi gjyqësor ka zgjatur më pak dhe një çështje për të cilën procesi ka zgjatur më shumë në raport me çështjet e tjera të të njëjtit lloj. Në vijim janë pasqyruar faktet e konstatuara referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore të administruara në fashikujt gjyqësore fizik si dhe procesverbaleve të seancave që rezultojnë nga sistemi ARK- IT⁶⁶.

Rastet studimore:

- **Dy çështje me objekt "padi pronësie":**

I. Çështja nr.1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Kërkesëpadia është regjistruar në gjykatë në datë 01.03.2022 dhe është shortuar në datë 03.03.2022. Nga ana e gjyqtarit të çështjes janë kryer këto veprime paraprake përkatësisht :

- Me vendimin "**Për veprimet paraprake**" datë **16.03.2022**, gjykata ka vendosur që bazuar në nenin 158 të Kodit të Procedurës Civile t'i komunikojë palës së paditur kërkesë padinë së bashku me provat përkatëse, caktimin e afatit 30 ditor për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes nga ana e saj. Gjithashtu në pikën 5 të këtij vendimi është vendosur t'i njoftohet deklarata e mbrojtjes dhe provat e palës së paditur, palës paditëse dhe t'i caktohet një afat 30 ditor nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes dhe provave për të paraqitur prova të tjera që lidhen me prapësimet e parashtruar prej palës së paditur në deklaratën e mbrojtjes. Bashkëngjitur ndodhen dëftesat e komunikimit datë 17.03.2022.

⁶⁶ Administruar me procesverbalin e datës 28.10.2024 dhe datë 04.11.2024.

- Në datë 06.05.2022⁶⁷ gjykata ka vendosur t'i komunikoj paditësit deklaratën e mbrojtjes dhe provat duke i caktuar një afat 30 ditor nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes për të paraqitur prapësimet.

Gjyqtari në datë 01.07.2022 ka marr vendim për caktimin e seancës përgatitore në datë 19.09.2022.

1. **Seanca përgatitore e datës 19.09.2022⁶⁸**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës duke i lënë detyrë palës paditëse që të marrë praktikën dhe mënyrën e kalimit të pronësisë nga pala shitëse tek blerësi e më pas të bëjë kërkesë për kalim procedural. Seanca është shtyrë për në datë 25.10.2022.
2. **Seanca përgatitore e datës 25.10.2022.** Gjatë kësaj seance është verifikuar vetëm prezenca e palëve. Përfaqësuesja e palës paditëse ka paraqitur një kërkesë për shtyrje për shkak se pala paditëse nuk ka mundur të jetë prezent për shkaqe shëndetësore bashkëngjitur raporti mjekësor. Palët e tjera kanë qenë dakort për shtyrjen e seancës. Gjykata ka pranuar kërkesën e përfaqësueses së palës paditëse për të shtyrë seancën në datë 24.11.2022.
3. **Seanca përgatitore e datës 24.11.2022.** Edhe gjatë kësaj seance është verifikuar vetëm prezenca e palëve. Në seancë është paraqitur pala paditëse e cila ka kërkuar shtyrjen e seancës për shkakun se avokatja e saj e kishte të pamundur të ishte prezent për shkaqe shëndetësore familjare. Palët e tjera kanë qenë dakord për shtyrjen e seancës. Gjykata ka shtyrë seancë për në datë 20.02.2023 për t'i dhënë mundësi avokates së palës paditëse që të jetë prezent.
4. **Seanca përgatitore e datës 20.02.2023.** Në seancë ka qenë prezent pala paditëse, nuk është paraqitur përfaqësuesja e saj si dhe ka qenë prezent pala e paditur e përfaqësuar me autorizim nga avokati. Gjykata relatton se seanca është shtyrë për të paraqitur pala paditëse dokumentacionin përkatës. Pala paditëse ka parashtruar se megjithëse kërkesën me shkrim drejtuar institucionit për t'ju vënë në dispozicion dokumentacioni, nuk ka mundur të siguroj dokumentacionin përkatës. Në këto kushte pala paditëse ka paraqitur kërkesën drejtuar gjykatës për marrjen e provave. Njëra nga palët e paditura ka qenë dakord me këtë kërkesë ndërsa pala tjetër e ka lënë në çmim të gjykatës. Në lidhje me këtë kërkesë gjykata ka relatuar ndër të tjera se *"gjykata nuk bën aplikim dhe nuk ka të drejtë t'i drejtohet institucionit,...., në referim të nenit 223/2 të K.Pr.C. pala që ka kërkuar marrjen e dokumentit është e detyruar të sqaroj me hollësi të gjitha rrethanat...."*. Menjëherë pas këtij relatiimi të gjykatës, pala paditëse ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues duke parashtruar se kërkesën do t'a depozitoj në sekretari. Pas parashtrimit të kësaj kërkesë, Gjykata ka vendosur: *"të ndërpresë seancën, për të paraqitur pala paditëse kërkesën për*

⁶⁷ Referuar procesverbaleve të gjeneruara nga sistemi tek rubrika "vendimi i seancës" është bërë shënimi "Veprime paraprake".

⁶⁸ Referuar procesverbaleve të seancave të gjeneruara nga sistemi nuk identifikohet lloji i seancës nëse këto seanca janë përgatitore apo seanca gjyqësore.

përjashtimin e gjyqtarit dhe deri në shqyrtimin e kësaj të fundit nga një trup tjetër gjykues, dosja do të qëndrojë pa veprime”.

5. Procesi gjyqësor në lidhje me gjykimin e kërkesës për përjashtim gjyqtari.

- Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit është depozituar në gjykatë në datë 23.02.2023, është regjistruar dhe është shortuar brenda datës 23.02.2023.
- Gjyqtarja e caktuar për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim, në datë 13.03.2023 ka marrë vendim për shqyrtimin e kërkesës në dhomë këshillimi në datë **12.04.2023** si dhe me shkresën datë 13.03.2023 ka kërkuar nga gjyqtari fashikullin e gjykimit.
- Gjykata ka disponuar me vendim në datë 12.04.2023 duke vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit; shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit; kundër këtij vendimi lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar”.*

5.1 Shënim i gjyqtarit: *“Dosja me nr. 5979 akti është lënë pa veprim deri në momentin e shqyrtimit të kërkesës për përjashtim gjyqtari. Me dhënien e vendimit lidhur me kërkesën për përjashtim të trupit gjykues, kërkesë e cila u shqyrtua nga gjyqtarja X, më datë 12.04.2023, kërkesë e cila është refuzuar. Në këto kushte gjykata cakton seancën e radhës për në datë 24.05.2023 ora 13:00”.*

6. Seanca përgatitore e datës 24.05.2023. Pasi është verifikuar prezenca e palëve, pala paditëse ka parashtruar se ata e kanë zgjidhur çështjen me marrëveshje, duke kërkuar heqjen dorë nga e drejta e padisë. Palë e paditur ka qenë dakord. Gjykata e ndodhur në këto kushte me **vendimin datë 24.05.2023**, në referim të nenit 127, 201/a të K.Pr. C, ka vendosur *“Rrëzimin e kërkesë padinë e paditëses, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e padisë”.*

Nga përmbajtja e seancave përgatitore rezulton se janë zhvilluar pesë seanca përgatitore. Katër seanca janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga kërkesat e palës paditëse si kërkesa për kalim procedural, shtyrje seance për shkaqe shëndetsore, për t'u prezantuar me avokat, për përjashtimin e gjyqtarit etj. Përsa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se tre seanca janë caktuar afërsisht në një distancë 1 muaj, ndërsa dy seancat e tjera janë caktuar në një distancë afërsisht 3 muaj. Në këtë distancë ka ndikuar periudha e mbarjes së dosjesve në vitin 2023 si dhe shqyrtimi i kërkesës për përjashtim të gjyqtarit.

Procesi për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim nga momenti i regjistrimit deri në shpalljen e vendimit ka zgjatur 1 muaj e 12 ditë.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 06.07.2018, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 06.07.2018 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatesisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 25.09.2018**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 18.10.2018, me qëllim njoftimin e dy të paditurve në mungesë me shpallje publike dhe njoftimin e të paditurit tjetër, përsëri me fletëthirrje.
2. **Seanca e datës 18.10.2018**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 01.11.2018 për t'i dhënë mundësi përfaqësuesit ligjor të palës së paditur B.R. që të paraqesë prokurën e posaçme për përfaqësimin e shtetasit në fjalë.
3. **Seanca e datës 01.11.2018**, në të cilën gjykata ka pranuar kërkesën e palës paditëse për thirrjen në cilësinë e personit të tretë, të Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në këto kushte, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 22.11.2018, me qëllim njoftimin e tyre.
4. **Seanca e datës 22.11.2018**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 12.12.2018, për t'i dhënë kohë personit të tretë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për t'u njohur me kërkesëpadinë dhe provat shkresore.
5. **Seanca përgatitore e datës 12.12.2018**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtari D.C ndodhet në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me porosi të gjyqtarit, seanca e ardhshme përgatitore do të zhvillohet në datë 23.01.2019.
6. **Seanca përgatitore e datës 23.01.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 12.02.2019, për t'i dhënë kohë personit të tretë Bashkia Tiranë, për t'u njohur me kërkesëpadinë dhe provat shkresore.
7. **Seanca e datës 12.02.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 05.03.2019, për t'u dhënë mundësi personave të tretë, që të paraqesin provat e pretenduara prej tyre.
8. **Seanca e datës 05.03.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës me kërkesë të palëve ndërgjyqëse për t'u dhënë mundësi që të njihen me provat shkresore të paraqitura nga personi i tretë Bashkia Tiranë. Seanca e ardhshme është caktuar për në datë 03.04.2019.
9. **Seanca e datës 03.04.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (e cila do të zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë), duke e caktuar këtë të fundit në datë 07.05.2019.
10. **Seanca e datës 07.05.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e saj për në datë 22.05.2019 për shkak të mosformimit të trupit gjykues (gjyqtarja E.H. ndodhet në një seminar Frankfurt, Gjermani).
11. **Seanca e datës 22.05.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 14.06.2019, me qëllim njoftimin e personit të tretë, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Jug.
12. **Seanca e datës 14.06.2019**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar në sistemin e elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Në kushtet kur gjyqtari F.K nuk ka patur dijeni për këtë proces gjyqësor, vlerëson të shtyjë seancën për formim të trupit gjykues, pra për t'i komunikuar gjyqtarit datën e seancës së ardhshme. Seanca e ardhshme caktohet në datë 26.06.2019*".

13. **Seanca e datës 26.06.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 04.07.2019, për t'i dhënë mundësi anëtarit të ri të trupit gjykues gjyqtarit F.K., që të njihet me çështjen.
14. **Seanca e datës 04.07.2019**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar në sistemin elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Vendim: Me qëllim njoftimin e ekspertës E.L për betimin dhe dhënien e detyrave nga gjykata, shtyn seancën përgatitore për në datë 22.07.2019 ora 11.00*". (permbajtja e procesverbalit të kësaj seance e referon si seancë përgatitore)
15. **Seanca gjyqësore⁶⁹ e datës 22.07.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 02.10.2019, me qëllim dhënien kohë ekspertës që të përgatisë aktin e ekspertimit dhe ta dorëzojë atë në datë 15.09.2019. Gjykata e ka arsyetuar caktimin e seancës së ardhshme më datë 02.10.2019, me faktin se në muajin gusht 2019 veprimtaria gjyqësore pezullohet për shkak të pushimeve vjetore të gjyqtarëve.
16. **Seanca gjyqësore e datës 02.10.2019**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Vendim: Gjykata, e çmon të drejtë kërkesën e ekspertës E.L për ta pajisur atë me një autorizim me qëllim që të paraqitet pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Jug dhe të bëjë verifikimet përkatëse lidhur me gjëndjen juridike aktuale të pronës objekt shqyrtimi. Për këtë arsye, seanca e ardhshme gjyqësore do të zhvillohet në datë 07.11.2019 ora 13.30*". (nga kjo permbajtje nuk deduktohet nese ka patur kerkese per shtyrje nga ekspertja per kete shkak (autorizimi) apo kërkesë nga ekspertja për tu pajisur me këtë autorizim , pas vleresimit të se cilit gjykata ka vendosur shtyrjen)
17. **Seanca gjyqësore e datës 07.11.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.12.2019, me qëllim dhënien e mundësisë ekspertës E.L, për t'u paraqitur në gjykim dhe për të depozituar aktin e ekspertimit.
18. **Seanca gjyqësore e datës 19.12.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.01.2020, për shkak të mosformimit të trupit gjykues (gjyqtari F.K ndodhej në një seminar të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës). Gjykata relacionon si shkak për caktimin e seancës së ardhshme në datë 23.01.2020, planifikimin e seancave për çështje gjyqësore të tjera në muajin dhjetor 2019, si dhe procesin e mbartjes së dosjeve civile në dy javët e para të muajit janar 2020.
19. **Seanca gjyqësore e datës 23.01.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur, me kërkesë të palëve ndërgjyqëse shtyrjen e seancës për në datë 09.03.2020, për t'iu dhënë kohë palëve që të njihen me aktin e ekspertimit.
20. **Seanca gjyqësore e datës 09.03.2020**. Në bazë të aktit normativ nr.9, datë 25.03.2020 "*Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19*" dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.127 datë 10.03.2020 "*Për pezullimin e veprimtarisë gjyqësore në të gjithë gjykatat e Republikës së Shqipërisë*", kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore. Seanca e ardhshme u caktua në datë

⁶⁹ Referuar procesverbalit të kësaj seance kjo seance relacionohet si gjyqësore.

29.09.2020. Gjykata relacion si shkak për caktimin e seancës së ardhshme në datë 29.09.2020, planifikimin e seancave për çështje të tjera në muajin korrik 2020, si dhe lejen vjetore të gjyqtarëve në muajin gusht 2020. (Referuar përmbajtjes së procesverbalit të gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës për këtë seancë rezultoi si datë e caktimit të saj dt.18.06.2020, ndërkohë që duhet të jetë lapsus duke patur parasysh seancën përpara kësaj të fundit ku konfirmohet si datë ajo e datës 09.03.2020).

21. **Seanca gjyqësore e datës 29.09.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.11.2020, për t'i dhënë mundësi palës paditëse që të paguajë shpenzimet për aktin e ekspertimit, si dhe ekspertës që t'u përgjigjet me shkrim pyetjeve të parashtruara nga pala paditëse.
22. **Seanca gjyqësore e datës 19.11.2020**, Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se me vendimin nr.47/10, datë 11.11.2020 e Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë "Për marrjen e masave në lidhje me COVID-19", është vendosur pezullimi i veprimtarisë gjyqësore, me qëllim mbrojtjen e shëndetit nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si dhe reduktimin e përhapjes së tij. Seanca e ardhshme gjyqësore u caktua në datë 18.01.2021. Gjykata relacion si shkak për caktimin e seancës së ardhshme në këtë datë, planifikimin e seancave për çështje gjyqësore të tjera në muajin dhjetor 2020, si dhe procesin e mbartjes së dosjeve civile në dy javët e para të muajit janar 2021.
23. **Seanca gjyqësore e datës 18.01.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e saj për në datë 15.02.2021, me qëllim dhënien kohë palës paditëse, për të paraqitur prova të reja.
24. **Seanca e datës 15.02.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur t'i caktojë detyrë palës paditëse që në kuadër të pretendimeve të saj, t'i drejtohet përsëri me shkresë Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit duke kërkuar që të konfirmojë në rrugë zyrtare nëse shkresat nr.39 prot., datë 12.03.1994 dhe nr.274 prot., datë 04.07.1994, janë nxjerrë nga arkiva bashkë me hartën shoqëruese të saj, si dhe të konfirmojë nëse informacioni që ato përmbajnë është i saktë. Për këtë shkak, gjykata ka shtyrë seancën për në datë 08.04.2021.
25. **Seanca e datës 08.04.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 16.06.2021, për t'i dhënë mundësi ekspertës që të përgatisë shtesën e aktit të ekspertimit.
26. **Seanca gjyqësore e datës 16.06.2021**. Kjo seancë nuk u zhvillua pasi gjyqtari D.C, për arsye familjare nuk është paraqitur në punë. Me porosi të gjyqtarit seanca e ardhshme është caktuar për në datë 07.10.2021. Gjykata relacion si shkak për caktimin e datës së seancës së ardhshme në këtë datë, ngarkesën në punë si dhe pezullimin e veprimtarisë gjyqësore për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve, në muajin gusht 2021.
27. **Seanca gjyqësore e datës 07.10.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 03.11.2021, me qëllim që ekspertja t'u përgjigjet pyetjeve dhe ndërhyrësi kryesor të paraqesë origjinën e pronësisë.
28. **Seanca gjyqësore e datës 03.11.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 15.12.2021, me qëllim vënien në dispozicion ekspertës të provave të paraqitura nga përfaqësuesi i ndërhyrësit kryesor O.R, për të konkluduar me shtesë akt-ekspertimin.

29. **Seanca gjyqësore e datës 15.12.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur me kërkesë të palëve ndërgjyqëse shtyrjen e seancës për në datë 03.02.2022, për t'u dhënë kohë që të njihen me shtesë akt – ekspertimin.
30. **Seanca gjyqësore e datës 03.02.2022**, në të cilën gjykata, ka vendosur, në kuadër të kalimit procedural, shtyrjen e seancës, me qëllim njoftimin edhe njëherë nëpërmjet fletëthirrjes të trashëgimtares ligjore S.G., të palës së paditur L.N, e cila ka qenë në mungesë në këtë proces. Seanca e ardhshme u caktua për në datë 23.02.2022.
31. **Seanca gjyqësore e datës 23.02.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Vendim: Gjykata vendos ti japë mundësi palës paditëse që të paraqesë dëshminë e trashëgimisë ligjore ose testamentare të së ndjerës Q.G, në datë 16.03.2022 ora 09:30, me qëllim që në këtë seancë të bëhet kalimi procedural sipas nenit 199 të K.Pr.C. dhe në vend të saj të thirren trashëgimtarët e saj ligjore për seancën e datës 11.04.2020 ora 09.30". (duket sikur ka caktuar paraprakisht dy seanca të ardhshme).*
32. **Seanca gjyqësore e datës 16.03.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 11.04.2022, me qëllim njoftimin edhe njëherë në kuadër të kalimit procedural, të trashëgimtarëve ligjorë të së ndjerës Q.G, të cilët kanë qenë në cilësinë e palës së paditur në mungesë në këtë proces gjyqësor.
33. **Seanca gjyqësore e datës 11.04.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 20.04.2022, për t'i komunikuar ekspertës kundërshtimet me shkrim të depozituara nga pala paditëse në lidhje me aktin e ekspertimit dhe shtesat e tij, përgjigjet e të cilave ekspertja duhet t'i depozitojë paraprakisht në sekretarinë gjyqësore në mënyrë që t'i komunikohen palëve.
34. **Seanca e datës 20.04.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 08.06.2022, për t'i dhënë mundësi ekspertës që të përgatisë plan vendosjen, të cilën duhet ta depozitojë paraprakisht në sekretarinë gjyqësore në mënyrë që t'i komunikohet palëve.
35. **Seanca e datës 08.06.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 14.09.2022, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse që të njihen me shtesë akt-ekspertimin dhe të paraqesin qëndrimin e tyre lidhur me të.
36. **Seanca e datës 14.09.2022**, Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimet e kësaj seance.
37. **Seanca përgatitore/gjyqësore e datës 08.11.2022**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtari D.C, (i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor) ndodhet në një vizitë studimore në Kroaci. (Referuar procesverbalit të kësaj seance kjo e fundit cilësohet literalisht si seancë përgatitore/gjyqësore).
38. **Seanca e datës 05.12.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimet e kësaj seance.
39. **Seanca gjyqësore e datës 23.01.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 21.02.2023, për të përsëritur njoftimin për personin e tretë Bashkia Tiranë, në kushtet kur nuk konfirmohet marrja dijeni nga ana e kësaj të fundit.

40. **Seanca gjyqësore e datës 21.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 06.03.2023, me qëllim dhënien kohë palëve që të paraqesin pretendimet përfundimtare me shkrim.
41. **Seanca gjyqësore e datës 06.03.2023**, në të cilën gjykata, ka vendosur bazuar në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile, shtyrjen e seancës për në datë 24.03.2023, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar. *(referuar procesverbalit të kësaj seance, raportohet se seanca është shtyre për në datë 06.03.2023 por që deduktohet që është lapsus për shkak të kronologjisë së seancave tashmë të zhvilluara dhe atyre që janë zhvilluar në vijim).*
42. **Seanca gjyqësore e datës 24.03.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për mos formim trupi gjykues pasi anëtarja e trupit gjykues A.K., nuk është paraqitur në punë duke qenë se është me leje vjetore. Në procesverbal raportohet fakti se data e seancës së ardhshme do t'iu komunikohet palëve me fletëthirrje, pasi trupi gjykues të mblidhet dhe të rakordojë me agjendën e tyre të çështjeve, për të caktuar datën e seancës së ardhshme.
43. **Seanca e datës 12.04.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimet e kësaj seance. *(Ndërkaq, referuar vendimit të shpallur për këtë çështje, i gjeneruar nga sistemi elektronik rezulton se gjykata në këtë seancë ka shpallur vendimin përfundimtar për rrëzimin e kërkesëpadisë).*

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 43 (dyzet e tre) seanca nga të cilat 5 (pesë) nuk rezultojnë të jenë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga kërkesat e palëve ndërgjyqëse, veprimet procedurale që lidhen me ekspertë ose akt ekspertimin, mos formim trupi gjykues si dhe gjendja e pandemisë së COVID-19, e cila solli për pasojë pezullimin e veprimtarisë gjyqësore. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 8 ditë (seanca 26.06.2019 – 04.07.2019) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 6 muaj e 20 ditë (seanca 09.03.2020 – 29.09.2020). Kjo e fundit përkon me periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të pandemisë së COVID-19.

- Dy çështje me objekt "kontratë qiraje":

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 27.05.2021, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 27.05.2021 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 08.06.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Në kuadër të veprimeve paraprake, gjykata në datë 08.06.2021 ka vendosur ti dërgojë palës së paditur "Njoftim për lëshimin e deklaratës së mbrojtjes", kopje të padisë si dhe provat shkresore të depozituara nga pala paditëse.*
2. **Seanca e datës 16.11.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.02.2022 për t'i dhënë kohë përfaqësueses së palës paditëse që të njihet me provat e vëna në dispozicion në seancën e kësaj date.
3. **Seanca përgatitore e datës 23.02.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 18.05.2022, për t'u dhënë kohë dhe mundësi palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen e çështjes me mirëkuptim. Në procesverbal relatohet fakti se gjykata i ka caktuar si detyrë palës paditëse, që në rast mos arritje të një marrëveshje mes tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes, pala paditëse duhet të paraqesë faturat e furnizimit me ujë dhe faturat e furnizimit me energji elektrike.
4. **Seanca e datës 18.05.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.09.2022, për t'i dhënë kohë palës paditëse që të paraqesë faturat e furnizimit me energji elektrike të gjeneruara nga sistemi i FSHU. Gjkata ka vendosur ti caktojë detyrë palës së paditur që të verifikojë nëse shoqëria e sigurimeve " " sh.a., disponon faturat e furnizimit me ujë dhe t'i paraqesë në seancën e radhës.
5. **Seanca e datës 23.09.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit për në datë 02.12.2022.
6. **Seanca gjyqësore e datës 02.12.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 15.03.2023, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse, për zgjidhjen e çështjes me mirëkuptim.
7. **Seanca gjyqësore e datës 15.03.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 27.03.2023, me qëllim dhënien sërish kohë palëve ndërgjyqëse, për zgjidhjen e çështjes me mirëkuptim.
8. **Seanca gjyqësore e datës 27.03.2023,** në të cilën gjykata, bazuar në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 18.04.2023 me qëllim shpalljen e arsyetuar të vendimit.
9. **Seanca e datës 18.04.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 8⁷⁰ (tetë) seanca nga të cilat nuk rezulton të ketë seanca të pazhvilluara. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët dhe/ose kërkesat e tyre sikundër është shprehja e vullnetit nga ana e tyre mbi mundësinë e zgjidhjes së çështjes me mirëkuptim. Për sa i përket distancës kohore⁷¹ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se, distanca më e shkurtër kohore nga seanca

⁷⁰ Në këtë numër nuk përfshihet seanca e parë përkatësisht ajo e datës 08.06.2021, e cila sipas sistemit elektronik rezulton me procesverbal seance por që në përmbajtje të tij deduktohet si veprim paraprak i gjyqtarit të çështjes.

⁷¹ Në përlogaritjen e distancës kohore më të shkurtër apo më të largët është përjashtuar seanca e parë e datës 08.06.2021, e cila në thelb është veprim paraprak i gjyqtarit të çështjes.

në seancë është prej 12 ditë (seanca 15.03.2023-27.03.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 5 ditë (seanca 18.05.2022 – 23.09.2022) .

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 17.11.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 17.11.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

- 1. Seanca e datës 23.11.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*veprim paraprak*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendosi: 1.Njoftimin e kërkesëpadisë dhe një kopje të provave të paraqitura nga pala paditëse, palës së paditur. 2. Palës së paditur, i caktohet një afat 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të kërkesë-padisë dhe akteve bashkëlidhur, për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes.*"
- 2. Seanca e datës 16.04.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*veprim paraprak*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendosi: 1.Njoftimin e deklaratës së mbrojtjes (prapësimeve) dhe një kopje të provave të paraqitura nga pala e paditur, palës paditëse. 2. Palës paditëse, i caktohet një afat 30 (tridhjetë) ditë nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes (prapësimeve) dhe akteve bashkëlidhur, për të paraqitur prova të tjera, përveç atyre të përcaktuara në kërkesë-padi, vetëm kur ato lidhen me pretendime të reja të të paditurit, të parashtruar në deklaratën e mbrojtjes. 3.Urdhërohet sekretaria gjyqësore për njoftimet sipas këtij vendimi*".
- 3. Seanca e datës 23.06.2021,** në të cilën gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar nga palët ndërgjyqëse për t'u dhënë kohë për zgjidhjen e çështjes me mirëkuptim, duke vendosur pranimin e saj dhe shtyrjen e seancës për në datë 24.09.2021.
- 4. Seanca e datës 24.09.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 04.11.2021 me qëllim kryerjen e pagesës së kundërpadisë nga pala e paditur kundërpaditëse si dhe thirrjen e ekspertës për të bërë betimin dhe marrë detyrat.
- 5. Seanca përgatitore⁷² e datës 04.11.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 21.12.2021 me qëllim dhënien kohë ekspertës që të paraqesë akt-ekspertimin.

⁷² Cilësohet e tillë sipas procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës.

6. **Seanca përgatitore⁷³ e datës 21.12.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 03.03.2022, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse që të njihen me akt-ekspertimin.
7. **Seanca e datës 03.03.2022**, Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak gjyqtari ndodhet në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve për analizën e punës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁴, për vitin 2021.
8. **Seanca e datës 16.05.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën për thirrje në cilësinë e personit të tretë të shtetasit z. K.D, shkak ky për të cilin gjykata shtyn seancën për në datë 08.07.2022.
9. **Seanca e datës 08.07.2022**, Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Vendim i Gjykatës së ndodhur në këto kushte, kur të dy palët mungojnë për shkak të vendimit të DHKA, për bojkot të seancave gjyqësore, e shtyn seancën për në dt.13.10.2022 ora 12:30. Të njoftohen palët ndërgjyqëse*". (nuk kuptohet qartë nëse ka patur kërkesë nga përfaqësuesit për shtyrje).
10. **Seanca e datës 13.10.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur, bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile, kalimin e çështjes në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit, në datë 16.01.2023.
11. **Seanca e datës 16.01.2023**, Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
12. **Seanca e datës 03.03.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 15.03.2023, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar, të arsyetuar.
13. **Seanca e datës 15.03.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për rrëzimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 11⁷⁵ (dymbëdhjetë) seanca nga të cilat për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion për zhvillimin e saj. Nga përmbajtja e seancave rezulton se këto të fundit janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme të passjella nga palët dhe/ose përfaqësuesit e tyre, veprime procedurale që lidhen me ekspertë ose akt-ekspertimin etj. Për sa i përket distancës kohore⁷⁶ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 12 ditë (seanca 03.03.2023 – 15.03.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 3 muaj e 5 ditë (seanca 08.07.2022 – 13.10.2022).

⁷³ Cilësohet e tillë sipas procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës.

⁷⁴ Sot, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

⁷⁵ Në këtë numër nuk përfshihen 2 seancat përkatësisht e datës 23.11.2020 dhe 16.04.2021 të cilat sipas sistemit elektronik rezultojnë me procesverbale seancash por që në përmbajtje të këtyre procesverbaleve, deduktohen si veprime paraprake të gjyqtarit të çështjes.

⁷⁶ Në përilogaritjen e distancës kohore më shkurtër apo më të largët janë përjashtuar dy seancat e para të cilat në thelb janë veprime paraprake.

- **Dy çështje me objekt "Kontratë sipërmarrje":**

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 23.12.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 23.12.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton :

- 1. Seanca e datës 30.12.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës", është bërë shënimi "*veprime paraprake të çështjes në dhomë këshillimi*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Gjykata bazuar në nenet 127, 202 e vijues të K.Pr.Civile vendosi: Mospranimin e kërkesës së paditësit për sigurimin e padisë. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim. Tiranë më datë 30.12.2020*".
- 2. Seanca e datës 22.01.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" është bërë shënimi "*veprime paraprake*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Njoftim për lëshimin e deklaratës së mbrojtjes, për njoftimin e kërkesëpadisë dhe provave të palës paditëse; Kopje të kërkesëpadisë palës paditëse; Kopje të provave shkresore të paraqitura nga pala paditëse; Vendimin për sigurim padie*", me nr.14479 akti, datë 30.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Formular për plotësimin e të dhënave; Gjykata bazuar në nenin 158 të K.Pr.C, vendosi: T'i komunikojë palës paditëse deklaratën e mbrojtjes dhe provat shkresore, protokolluar në gjykatë me nr.DM 1597 datë 25.02.2021, të paraqitur prej palës së paditur E.L. T'i komunikojë palës paditëse Deklaratën e mbrojtjes dhe provat shkresore, protokolluar në gjykatë me nr.DM 1596 datë 25.02.2021, të paraqitur prej palës së paditur A.L. T'i komunikojë palës paditëse deklaratën e mbrojtjes dhe provat shkresore, protokolluar në gjykatë me nr.DM 1595 datë 25.02.2021, të paraqitur prej palës së paditur shoqëria përmbarimore private "T.G sh.p.k. Pala paditëse mund të paraqesë prova të tjera që lidhen me prapësimet e parashtruara prej palës së paditur në deklaratën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi. Të urdhërojnë sekretarinë gjyqësore që të njoftojë palën paditëse për këtë vendim. Tiranë më datë 19.04.2021".
- 3. Seanca përgatitore e datës 22.07.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Vendim: gjykata vendos të pranojë kërkesën e palës paditëse për t'i dhënë kohë dhe mundësi të paraqesë provë shkresore lidhur me adresën zyrtare të të paditurit P.S, i cili nuk ka dijeni për këtë seancë dhe për këtë arsye shtyn seancën përgatitore për më datë 14.09.2021..*". (nuk kuptohet shkaku i shtyrjes).

4. **Seanca përgatitore e datës 14.09.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 27.10.2021 me qëllim njoftimin me shpallje publike të të paditurit P.S, duke qenë se nuk rezulton që të ketë marrë dijeni për zhvillimin e kësaj seance.
5. **Seanca përgatitore e datës 27.10.2021**, në të cilën gjykata bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit për në datë 21.12.2021.
6. **Seanca gjyqësore e datës 21.12.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 24.02.2022, me qëllim dhënien kohë ekspertes që të realizojë dhe depozitojë në datë 24.01.2022, akt-ekspertimin në gjykatë dhe që palët të mund ta tërheqin akt-ekspertimin, njihen me të dhe të paraqesin qëndrimin e tyre respektiv.
7. **Seanca gjyqësore e datës 24.02.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 03.05.2022, me qëllim dhënien sërish kohë ekspertes që të realizojë dhe depozitojë në datë 04.04.2022, akt-ekspertimin në gjykatë dhe që palët të mund ta tërheqin akt-ekspertimin, njihen me të dhe të paraqesin qëndrimin e tyre respektiv.
8. **Seanca përgatitore⁷⁷ e datës 03.05.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimimi "*Seanca përgatitore e datës 03.05.2022 ora 12:00, nuk u zhvillua pasi ditën e hënë datë 03.05.2022 ishte festë zyrtare "Fiter Bajram". Për këtë arsye, seanca e ardhshme përgatitore do të zhvillohet më datë 19.07.2022 ora 12:30. Të njoftohen palët ndërgjyqëse". (në gjithë përmbajtjen e këtij procesverbalit kjo seancë cilësohet si përgatitore ndërkohë që çështja ka kaluar në seancë gjyqësore që me datë 21.12.2021).*
9. **Seanca gjyqësore e datës 19.07.2022**, në të cilën gjykata, me kërkesë të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 20.10.2022, për shkak të vendimit nr.2 datë 29.06.2022 të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, për bojkotimin e seancave gjyqësore.
10. **Seanca gjyqësore e datës 20.10.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 07.02.2023, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse që të njihen me akt-ekspertimin e depozituar nga eksperte M.B si dhe komunikimin e këtij akti, palës së paditur në mungesë dhe personit të tretë.
11. **Seanca gjyqësore e datës 07.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 14.02.2023, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse që të paraqesin pretendimet përfundimtare me shkrim.
12. **Seanca gjyqësore e datës 14.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 06.03.2023 me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar të arsyetuar.
13. **Seanca gjyqësore e datës 06.03.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për rrëzimin e kërkesë padisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 11⁷⁸ (njëmbëdhjetë) seanca nga të cilat 1 (një) seancë nuk rezulton të jetë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave

⁷⁷ Cilësohet e tillë sipas procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës.

⁷⁸ Në këtë numër nuk përfshihen dy seancat e para të cilat në thelb janë veprime paraprake të gjyqtarit të çështjes pavarësisht se në sistemin elektronik referohen si seanca përmes procesverbaleve të tyre.

rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët dhe/ose kërkesat e tyre si dhe veprimet procedurale që lidhen me ekspertë dhe/ose akt ekspertimin. Për sa i përket distancës kohore⁷⁹ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 7 ditë (seanca 07.02.2023 – 14.02.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 3 muaj e 18 ditë (seanca 20.10.2022 – 07.02.2023).

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 15.09.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 15.09.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatesisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 09.03.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 10.05.2021, për t'i dhënë mundësi përfaqësuesit të palës së paditur shoqërisë "A." sh.p.k., që të paraqitet në gjykim me aktin e përfaqësimit.
2. **Seanca përgatitore e datës 10.05.2021**. Kjo seancë nuk u zhvillua për arsye shëndetësore familjare të gjyqtarit të cilit iu desh të largohej nga puna në mënyrë urgjente. Me porosi të gjyqtarit seanca e ardhshme do të zhvillohet për në datë 14.07.2021.
3. **Seanca përgatitore e datës 14.07.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 09.11.2021, për t'i dhënë mundësi përfaqësueses së palës paditëse që të paraqesë në cilësinë e provës shkresore praktikën e lejes së legalizimit të godinës ku ndodhet njësia objekt gjykimi si dhe pala e paditur të paraqesë në formën e kërkuar nga ligji aplikimin nr.491, datë 18.03.2009. Gjykata ka evidentuar gjithashtu faktin se, seanca është caktuar në këtë datë, për shkak të ngarkesës në punë si dhe për faktin që në muajin gusht 2021, gjykata e pezullon veprimtarinë e saj normale, për shkak të marrjes së lejes vjetore të gjyqtarëve.
4. **Seanca e datës 09.11.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 16.02.2022, për t'i dhënë mundësi përfaqësueses së palës paditëse që të paraqesë një vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës lidhur me pezullimin e regjistrimit të lejes së legalizimit si dhe t'i japë mundësi përfaqësuesit të palës së paditur për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, aplikimin për regjistrimin e lejes së legalizimit.
5. **Seanca e datës 16.02.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 11.05.2022, duke pranuar kërkesën e palës së paditur për shtyrje seance.

⁷⁹ Në përlllogaritjen e distancës kohore me të shkurtër apo më të largët janë përjashtuar dy seancat që në thelb janë veprime paraprake.

6. **Seanca përgatitore e datës 11.05.2022**, në të cilën gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit si të ligjshëm, të kërkesës së përfaqësuesit të palës së paditur për shtyrje seance, ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 13.07.2022.
7. **Seanca përgatitore e datës 13.07.2022**, në të cilën gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit si të ligjshëm të kërkesës së përfaqësueses së palës paditëse për shtyrje seance, ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 10.11.2022.
8. **Seanca përgatitore/gjyqësore⁹⁰ e datës 10.11.2022**, Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimin "*Seanca përgatitore/gjyqësore e datës së sotme 10.11.2022 ora 12:30 nuk do të zhvillohet për shkak se gjyqtari D.C. (i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor) ndodhet në një vizitë studimore në Kroaci. Përsa i përket datës së seancës së ardhshme (e planifikuar paraprakisht nga gjyqtari) do të zhvillohet në datë 23.12.2022 ora 11:15...*", (në këtë procesverbal referohet seanca si përgatitore/gjyqësore, shkak për të cilin vlerësojmë të qëndrojmë strikt përmbajtjes së tij).
9. **Seanca përgatitore e datës 23.12.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit, për në datë 12.04.2023.
10. **Seanca gjyqësore e datës 12.04.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.04.2023, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim.
11. **Seanca gjyqësore e datës 19.04.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 09.05.2023, me qëllim shpalljen e arsytuar të vendimit.
12. **Seanca e datës 09.05.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 12 (dymbëdhjetë) seanca nga të cilat 2 (dy) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët dhe/ose kërkesat e përfaqësuesve të tyre për shtyrje seance. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 7 ditë (seanca 12.04.2023 – 19.04.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 3 muaj e 28 ditë (seanca 13.07.2022 – 10.11.2022).

- Dy çështje me objekt "kontratë huaje":

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Kërkesëpadia është regjistruar në gjykatë në datë 30.03.2022.

⁹⁰ Cilësohet e tillë sipas procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës.

- Me vendimin e datës 02.03.2022 "Për kthim aktesh", gjykata ka vendosur kthimin e akteve duke konstatuar se kjo kërkesë ka të meta thelbësore në lidhje me aktet shoqëruese, pasi mënyra e ngritjes së kërimit nuk është në formën e kërkuar nga ligji. Kërkesa është paraqitur në formën e lëshimit të urdhër ekzekutimit por që ky konflikt duhet të zgjidhet me padi themeli.

Në këto kushte, pala paditëse ka paraqitur kërkesëpadi e cila rezulton të jetë regjistruar në gjykatë në datë 30.03.2022.

- Me vendimin e datës 12.04.2022 "Për komunikimin e padisë dhe akteve të paditurit", gjykata, pas konstatimit se kërkesë padia është pa të meta, bazuar në nenin 158 të K.Pr.Civile, ka vendosur njoftimin e kërkesë padisë dhe provat bashkëlidhur palës së paditur si dhe njoftimin palës së paditur për të drejtat dhe detyrimet ligjore të saj. **(Procesverbal për veprimet paraprake i datës 12.04.2022).**

- Me vendimin e datës 06.02.2023 "Për caktimin e seancës përgatitore", gjykata ka vendosur caktimin e seancës përgatitore për në datë 13.03.2023 **(Procesverbal për veprimet paraprake i datës 06.02.2023).**

1. **Seanca përgatitore e datës 13.03.2023**, në të cilën gjykata pas verifikimit të prezencës së palëve, ka vendosur vijimin e gjykimit në mungesë, për palën e paditur, caktimin e provave që do të merren në shqyrtim për këtë çështje dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Seanca gjyqësore u caktua për në datë 23.03.2023 (Procesverbali i seancës përgatitore datë 13.03.2023, vendimi i datës 13.03.2023 "Për marrje provash" dhe urdhri datë 13.03.2023 për caktimin e seancës gjyqësore)
2. **Për seancën e datës 23.03.2023**, rezulton të mos ketë procesverbal por vetëm një shënim nga ana e gjykatës se kjo seancë nuk u zhvillua për arsye shëndetësore. Referuar shënimit nr. 6357 Regj. Them., të disponuar në dosje rezulton se seanca gjyqësore është caktuar për t'u zhvilluar në datë 13.04.2023.
3. **Seanca e datës 13.04.2023**, në të cilën gjykata pasi ka shqyrtuar çështjen në themel, bazuar në nenin 302 të K.Pr.Civile i ka dhënë fund hetimit gjyqësor, ka dëgjuar pretendimet përfundimtare të palës paditëse (prezente në gjykim) dhe shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesë padisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 3 (tre) seanca nga të cilat 1 (një) seancë nuk rezulton të jetë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se 2 prej tyre janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga mungesa e gjyqtarit të çështjes si dhe/ose kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 10 ditë (seanca 13.03.2023 – 23.03.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 20 ditë (seanca 23.03.2023 – 13.04.2023).

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 11.02.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 11.02.2020 dhe është shortuar në datë 13.02.2020 (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 24.02.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Gjykata nisur nga momenti procedural, përgjigjet e pyetjeve si dhe mungesa e praktikës së plotë të akteve i kërkon palës së paditur që të plotësojë kuadrin e provave që lidhen me kontratën bazë të datës 03.07.2018, aktet shoqëruese të saj si dhe gjithë mënyrën e shlyerjes të të dyja kontratave të kredive dhe nga kush persona janë shlyer. Nisur nga ky fakt rezervon të drejtën që të shprehet për kërkimin e sigurimit të padisë në seancën e ardhshme. Për këtë shkak ndërpret seancën dhe e shtyn për në datë 02.03.2020 ora 12.30".*
2. **Seanca e datës 02.03.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës, tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*Vazhdimi i veprimeve paraprake*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Gjykata pasi u njoh me shpjegimet e palës paditëse, provat shoqëruese, qëndrimin e palës së paditur vendos të mos pranojë kërkesën për sigurimin e padisë në formën dhe mënyrën e kërimit të saj pasi e çmon atë të pabazuar në ligj dhe në prova. Për gjykatën kjo masë e kërkuar nuk është proporcionale dhe e mbështetur në argumenta ligjore apo prova konkrete bindëse deri në fazën që ndodhet çështja për të disponuar me pranimin e saj. Për gjykatën nuk krijohet bindja që ky vendim do të bëhet i pamundur për t'u ekzekutuar në eventualitet të pranimit të saj. Lidhur me vazhdimin e gjykimit gjykata i vendos në dispozicion palës së paditur provat duke i lënë 30 ditë kohë për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes".*
3. **Seanca e datës 15.06.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Vendosi: 1. Njoftimin e deklaratës së mbrojtjes (prapësimeve) dhe një kopje të provave të paraqitura nga pala e paditur, palës paditëse. 2. Palës paditëse, i caktohet një afat 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes (prapësimeve) dhe akteve bashkëlidhur, për të paraqitur prova të tjera, përveç atyre të përcaktuara në kërkesë-padi, vetëm kur ato lidhen me pretendime të reja të të paditurit, të parashtruara në deklaratën e mbrojtjes".*
4. **Seanca e datës 15.10.2020.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtari E.P nuk mund të paraqitej për arsye shëndetësore (vetëkarantinuar si pasojë e infektimit me COVID-19). Seanca e ardhshme është caktuar për në datë 23.11.2020.

5. **Seanca e datës 23.11.2020.** Në bazë të aktit normativ nr. 9 datë 25.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19" dhe vendimit të Këshillit të Gjykatës nr.47/10 datë 11.11.2020 "Për marrjen e masave në lidhje me COVID-19", kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 13.11.2020 deri në 27.11.2020. Seanca e ardhshme caktohet për në datë 21.01.2021.
6. **Seanca e datës 21.01.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimimi "Vendim: gjykata nisur nga ky moment procedural çmon të pranojë kërkesën e bërë nga palët për t'ju dhënë kohë me qëllim paraqitjen e kërkesës për pezullim, prova shoqëruese dhe pala paditëse të paraqesë prapësime dhe prova rreth kësaj kërkeje. Për këtë shkak ndërpret seancën dhe e shtyn për në datë 10.03.2021 ora 11.00".
7. **Seanca e datës 10.03.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 16.04.2021, për t'i dhënë kohë palëve që të plotësojnë kuadrin e provave që kanë të bëjnë me kërkesën e palës së paditur, për pezullimin e gjykimit.
8. **Seanca e datës 16.04.2021.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtari ndodhet në seminar online me temë "Standardet ndërkombëtare të punës për gjykatësit". Seanca e ardhshme do të zhvillohet në datë 25.05.2021.
9. **Seanca e datës 25.05.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 29.06.2021 duke pranuar kërkesën e palës paditëse për t'i dhënë kohë që të paraqesë prova në formën e kërkuar nga ligji si dhe kërkesën e palës së paditur për t'i dhënë kohë që të njihet me dosjen.
10. **Seanca e datës 29.06.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 12.07.2021, duke pranuar kërkesën e palëve ndërgjyqëse për të parashtruar me shkrim detyrat për ekspertin.
11. **Seanca e datës 12.07.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 04.10.2021 për t'i dhënë kohë ekspertit për të përgatitur akt ekspertimin.
12. **Seanca e datës 04.10.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 10.11.2021 me qëllim për t'i dhënë kohë palëve që të njihen me akt ekspertimin grafik.
13. **Seanca përgatitore e datës 10.11.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance e gjeneruar nga sistemi elektronik , tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimimi "Vendim: Gjykata pranon kërkesën e palës së paditur për t'i dhënë kohë për të sjellë provat si dhe për të qartësuar qëndrimin e tyre. Për këtë shkak, e ndërpret seancën e sotme përgatitore dhe e shtyn për në dt.18.01.2022 ora 10.00.....".
14. **Seanca e datës 18.01.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimimi "Vendim: Gjykata referuar kërkesës së paraqitur dhe qëndrimin të palës paditëse prezent, vendos ta pranojë kërkesën pasi e çmon objektivisht të justifikuar. Për këtë shkak, e ndërpret seancën dhe e shtyn për në datë 24.02.2022 ora 11.30.....". (nuk evidentohet qartësisht shkaku i shtyrjes) .

15. **Seanca e datës 24.02.2022**, në të cilën gjykata, bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur të kalojë çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit për në datë 06.05.2022.
16. **Seanca e datës 06.05.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Gjykata vendim: Nisur nga diskutimi në seancë, gjykata i kërkon palës së paditur ta qartësojë vërtetimin e detyrimit në mënyrë shteruese dhe të qartë për gjykatën dhe palës paditëse të bëjë kërkesën për saktësim objekti padie në bazë dhe të këtij vërtetimi. Për këtë shkak, e ndërpret seancën dhe e shtyn për në dt.04.07.2022 ora 12.30. Të njoftohet ekspertit V.H. Palët ndërgjyqëse morën dijeni*".
17. **Seanca e datës 04.07.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse për shtyrje seance për shkak të vendimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë për bojkotim të seancave gjyqësore pa afat, duke e caktuar seancën e radhës për në datë 08.09.2022.
18. **Seanca e datës 08.09.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datë 09.11.2022, duke pranuar kërkesën e palëve ndërgjyqëse për t'u dhënë kohë për ta zgjidhur çështjen me mirëkuptim.
19. **Seanca e datës 09.11.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
20. **Seanca e datës 07.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur që të shtyjen e seancës për në datë 03.04.2023, me qëllim për t'i dhënë kohë palës paditëse që të njihet me propozimin e palës së paditur për zgjidhjen e çështjes me mirëkuptim.
21. **Seanca e datës 03.04.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur që të shtyrjen e seancës për në datë 20.04.2023 me qëllim dhënien kohë palëve që të formalizojnë në një akt - marrëveshje propozimin për të cilin kanë rënë dakord.
22. **Seanca e datës 20.04.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance. *(Ndërkaq, referuar vendimit të shpallur për këtë çështje, të gjeneruar po nga sistemi elektronik rezulton se gjykata në këtë seancë ka shpallur vendimin për rrëzimin e kërkesëpadisë për shkak të heqjes dorë nga e drejta e padisë).*

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 19⁸¹ (nëntëmbëdhjetë) seanca nga të cilat 2 (dy) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar dhe për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të saj. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga kërkesat e palëve ndërgjyqëse, veprimet procedurale që lidhen me ekspertë ose akt ekspertimin, gjendja e pandemisë së COVID-19, e cila solli për pasojë pezullimin e veprimtarisë gjyqësore etj. Për sa i përket distancës kohore⁸² ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në

⁸¹ Në këtë numër nuk përfshihen 3 seancat e para përkatësisht e datës 24.02.2020, 02.03.2020 dhe 15.06.2020.

⁸² Në përlogaritjen e distancës kohore më të shkurtër apo më të largët janë përjashtuar 3 seancat e para.

seancë është prej 13 ditë (seanca 29.06.2021 – 12.07.2021) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 2 muaj e 29 ditë (seanca 09.11.2022-07.02.2023).

- **Dy çështje me objekt "Padi të tjera kontraktuale":**

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 07.02.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 07.02.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca përgatitore e datës 21.04.2020.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak pezullimit të veprimtarisë gjyqësore në bazë të aktit normativ nr.9, datë 25.03.2020 "*Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së glendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19*" dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Seanca e radhës u caktua për në datë 11.11.2020.
2. **Seanca përgatitore e datës 11.11.2020,** në të cilën gjykata ka vendosur të kalojë çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, më datë 10.03.2021.
3. **Seanca e datës 10.03.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.05.2021, me qëllim paraqitjen e provave në formën e duhur ligjore.
4. **Seanca gjyqësore e datës 19.05.2021.** Kjo seancë nuk u zhvillua pasi gjyqtarja është me raport mjekësor. Seanca e radhës u caktua më datë 04.10.2021.
5. **Seanca e datës 04.10.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 28.01.2022, me qëllim paraqitjen e provave në formën e duhur ligjore.
6. **Seanca e datës 28.01.2022.** Kjo seancë nuk u zhvillua pasi gjyqtarja mungon (është me leje të miratuar nga kryetari). Në procesverbal relatohet fakti se seanca e radhës do tu njoftohet palëve me fletëthirrje.
7. **Seanca e datës 09.05.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës më 17.10.2022, me qëllim paraqitjen e provave në formën e duhur ligjore.
8. **Seanca e datës 17.10.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 15.03.2023, për t'i dhënë kohë palës paditëse që të paraqesë në formën e duhur ligjore provat e kërkuara nga gjykata.
9. **Seanca e datës 15.03.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 04.04.2023, me qëllim shpalljen e arsyetuar të vendimit.
10. **Seanca e datës 04.04.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin për pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 10 (dhjetë) seanca nga të cilat 3 (tre) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se

pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët dhe/ose kërkesat e tyre. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 20 ditë (15.03.2023-04.04.2023), ndërsa distanca më e largët është prej 6 muaj e 21 ditë (seanca 21.04.2020 – 11.11.2020).

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 08.05.2019, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 08.05.2019 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 14.05.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" është bërë shënimi "veprime paraprake" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*lënien pa veprime të kërkesë padisë deri më datë 23.05.2019, me qëllim që pala paditëse brenda këtij afati të bëjë plotësimet si më poshtë: - Të paraqesë taksën gjyqësore, konform nenit 154 të K.Pr.Civile. Të njoftohet pala paditëse*".
2. **Seanca e datës 24.05.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" është bërë shënimi "veprime paraprake" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*1.Njoftimin e kërkesëpadisë dhe të një kopje e provave të paraqitura nga pala paditëse, palës së paditur.2.Bashkë me njoftimin të komunikohet dhe kërkesa sipas ligjit, mbi elementët përbërës së deklaratës së mbrojtjes, i vendosur në një format, i cili mund të shërbejë si shembull për t'u plotësuar nga i padituri.3.Palës së paditur i caktohet një afat 30 ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të kërkesëpadisë dhe akteve bashkëlidhur, për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes.4.Urdhërohet sekretaria gjyqësore për njoftimet sipas këtij vendimi*".
3. **Seanca përgatitore e datës 10.09.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 17.10.2019, për të paraqitur pala paditëse kontratën e punësimit.
4. **Seanca përgatitore e datës 17.10.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur të shtyjë seancën përgatitore, për të paraqitur pala paditëse kontratën e punësimit, si dhe të gjejë adresën e saktë të palës së paditur pasi po bëhet shkak për zvarritjen e gjykimit. Seanca e radhës u caktua për në datë 26.11.2019.
5. **Seanca e datës 26.11.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*Seanca e datës 26.11.2019 nuk u zhvillua për shkak të njoftimit datë 26/27.11.2019 të KLGJ-së (ku për shkak të situatës së krijuar si rrjedhojë e lëkundjeve sizmike njofton se nuk do të zhvillohen gjyqe në Gjykatat e Rrethit Tiranë, Kavajë, Krujë, Lezhë, Laç. Seanca e ardhshme do të zhvillohet në datën 05.02.2020...*".

6. **Seanca përgatitore e datës 05.02.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur të njoftojë edhe njëherë palën e paditur duke iu bashkëngjitur fletë thirrjes edhe bazën ligjore të zëvendësimit të emrit si person juridik. Seanca e radhës u caktua në datë 25.03.2020.
7. **Seanca e datës 25.03.2020**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*Seanca e datës 30.06.2020 nuk u zhvillua për shkak se me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 127, datë 10.03.2020, "Për pezullimin e veprimtarisë gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë", si dhe me aktin Normativ nr. 9, datë 25.03.2020 të Këshillit të Ministrave është vendosur pezullimi i veprimtarisë së gjykatës, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19. Në këto kushte, në zbatim edhe të kriterëve të përcaktuara nga akti normativ nr. 21, datë 27.05.2020 "Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 9, datë 25.03.2020", seanca e ardhshme caktohet për më datë 23.09.2020, ora 12.00. Të njoftohen palët. Tiranë datë 30.06.2020"*.
8. **Seanca përgatitore e datës 23.09.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 26.11.2020, me qëllim njoftimin edhe njëherë të palës së paditur si dhe dhënien kohë palës paditëse, që të gjejë adresën e saktë të palës së paditur.
9. **Seanca e datës 26.11.2020**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se me vendimin nr.47/10, datë 11.11.2020 e Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë "*Për marrjen e masave në lidhje me COVID-19*", është vendosur pezullimi i gjykimeve në dhomën civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për datat 13.11.2020 – 27.11.2020. Seanca e ardhshme u caktua në datë 08.03.2021.
10. **Seanca e datës 08.03.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 13.05.2021, për t'i dhënë mundësi palës së paditur të përfaqësohet nga një jurist.
11. **Seanca e datës 13.05.2021**. Kjo seancë nuk u zhvillua, për shkak se data 13.05.2021, është festë zyrtare. Seanca e radhës u caktua për në datë 30.06.2021.
12. **Seanca e datës 30.06.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*VENDIM Gjykata vendosi të ndërpres seancën e sotme për t'i dhënë kohë palës paditëse të njihet me deklaratën e mbrojtjes dhe provat bashkëlidhur ku brenda 30 ditëve të paraqes propësime nëse ka, e më pas ti vihen në dispozicion palës së paditur dhe për këtë shkak seanca e sotme do të shtyhet për më dt. 09.11.2021 ora 12.00. Palët prezent morën dijeni. Tiranë më 30.06.2021, ora 12.30"*.
13. **Seanca e datës 09.11.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*VENDIM Gjykata vendosi të ndërpres seancën e sotme për t'i dhënë kohë palës së paditur të njihet me propësimet e palës paditëse mbi deklaratën e mbrojtjes, që të mbaj qëndrimin e tij me shkrim dhe për këtë shkak seanca e sotme do të shtyhet për më dt. 02.03.2022 ora 12.00. Palët prezent morën dijeni. Tiranë më 09.11.2021, ora 12.20"*.
14. **Seanca e datës 02.03.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 28.06.2022 për thirrur në këtë proces, Avokaturën e Shtetit.
15. **Seanca e datës 28.06.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 06.10.2022, me qëllim dhënien kohë palës paditëse të njihet me deklaratën e mbrojtjes së Avokaturës së Shtetit si dhe për të njoftuar edhe njëherë palën e paditur.

16. **Seanca e datës 06.10.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur të kalojë çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, e cila u caktua për në datë 20.03.2023;
17. **Seanca gjyqësore e datës 20.03.2023**, në të cilën gjykata ka shtyrë seancën për në datë 28.03.2023, për t'u dhënë kohë palëve që të paraqesin pretendimet përfundimtare me shkrim.
18. **Seanca e datës 28.03.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 13.04.2023, me qëllim shpalljen e arsytuar të vendimit.
19. **Seanca e datës 13.04.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
20. **Seanca e datës 19.04.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban informacion mbi zhvillimin e kësaj seance. Ndërkaq, referuar vendimit të shpallur për këtë çështje, të gjeneruar po nga sistemi elektronik, rezulton se gjykata në këtë seancë ka shpallur vendimin për pranimin e padisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 18⁸³ (tetëmbëdhjetë) seanca nga të cilat 3⁸⁴ (tre) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar dhe për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion për zhvillimin e saj. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme të pasjella nga palët. Për sa i përket distancës kohore⁸⁵ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 6 ditë (seanca 13.04.2023 – 19.04.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 5 muaj e 29 ditë (seanca 25.03.2020 – 23.09.2020).

- **Dy çështje me objekt “Zgjidhje martesë”:**

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Kërkesë padia është regjistruar në gjykatë në datë 04.04.2023 dhe është shortuar po në datë 04.04.2023. Me objekt “1. Zgjidhja e martesës lidhur midis palëve ndërgjyqëse. 2. Likuidimi i regjistrimit pasuror martesor”.

Nga ana e gjyqtarit të çështjes, janë kryer këto veprime përkatësisht:

- Me vendimin “**Për veçimin e kërtimeve të kërkesë padisë**” datë 11.04.2023, gjykata në kuadër të veprimeve paraprake, ka vlerësuar se ndodhet në kushtet e parashikuara

⁸³ Në këtë numër nuk përfshihen 2 seancat e para përkatësisht e datës 14.05.2019 dhe 24.05.2019.

⁸⁴ Në këtë numër nuk përfshihet seanca e datës 25.03.2020, në procesverbalin e së cilës referon për një seancë tjetër 30.06.2020 jo 25.03.2020.

⁸⁵ Në përlogaritjen e distancës kohore më shkurtër apo më të largët janë përjashtuar dy seancat e para përkatësisht e datës 14.05.2019 dhe 24.05.2019.

në nenin 159 të Kodit të Procedurës Civile, ku shqyrtimi së bashku i kërtimeve të parashtruara në kërkesë padi, krijon vështirësi të dukshme në zhvillimin e gjykimit. Gjykata bazuar në nenet 158/a, paragrafi 2, pika "ë", 159 të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenin 138 paragrafi 2, të Kodit të Familjes ka vendosur veçimin e kërtimeve në lidhje me kërkimin e dytë dhe ka urdhëruar sekretarinë gjyqësore të fotokopjojë si dhe njësojë me origjinalin të gjithë dosjen civile duke formuar një dosje të re me numër të ri regjistrimi.

- Me vendimin datë 11.04.2023 "**Për caktimin e seancës së pajtimit**", gjykata në kuadër të veprimeve paraprake, ka vendosur të caktojë seancën e pajtimit në datë 08.05.2023.

1. **Seanca e pajtimit e datës 08.05.2023**, në të cilën gjykata ka konstatuar se pala e paditur nuk është njoftuar nga ftuesi i gjykatës. Gjatë kësaj seance, gjykata nga paditësi është njoftuar se i padituri ka ndryshuar adresë dhe ka vendosur të njoftojë palën e paditur në adresën e re të referuar nga paditësja. Për këtë arsye, seanca është shtyrë për në datë 24.05.2023.

2. **Seanca e pajtimit e datës 24.05.2023**, në të cilën gjykata ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet me pajtim dhe ka nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Gjykata ka vijuar seancën gjyqësore po në këtë datë, pas shqyrtimit gjyqësor të së cilës ka vendosur të mbyllë shqyrtimin gjyqësor duke ftuar palët për pretendimet përfundimtare dhe pasi është tërhequr për vendim, ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesëpadisë duke e deklaruar të mbyllur seancën e datës 24.05.2023.


Nga përmbajtja e seancave rezulton se për gjykimin e kësaj çështje, janë zhvilluar dy seanca respektivisht një seancë pajtimi dhe një seancë gjyqësore. Nga përmbajtja e këtyre seancave rezulton se, të jetë shtyrë vetëm seanca e pajtimit, kjo për shkak të mosmarrjes dijeni të të paditurit. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se, seancat janë lënë në një distancë të shkurtër kohore dy javore.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 12.06.2018, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 12.06.2018 dhe është shortuar në datë 19.10.2021 (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e pajtimit e datës 18.07.2018**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*shtyhet me kërkesë të paditësit*", ndërsa tek rubrika "shënim për seancën"



konstatohet shënimi "Për të njoftuar palën e paditur seanca e pajtimit shtyhet për më datë 01.10.2018, ora 12.30. Pala paditëse prezent mori dijeni. Të njoftohet pala e paditur".

2. **Seanca e pajtimit e datës 01.10.2018.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtare K.A mungon për arsye objektive (me raport mjekësor). Në procesverbal relatohet fakti se për seancën e ardhshme palët do të njoftohen me fletëthirrje.
3. **Seanca përgatitore e datës 13.11.2018.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "seancë pajtimi" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Seanca përgatitore u zhvillua në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur. Gjykata shtyn seancën e pajtimit më datë 19.12.2018 ora 13.00. Pala paditëse mori dijeni, të njoftohet pala e paditur".
4. **Seanca e pajtimit e datës 19.12.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.02.2019, me qëllim njoftimin e palës së paditur me fletëthirrje dhe shpallje publike.
5. **Seanca e pajtimit e datës 19.02.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Seanca e pajtimit u zhvillua në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur. Gjykata shtyn seancën e pajtimit më datë 04.04.2019 ora 11.30. Pala paditëse mori dijeni, të njoftohet pala e paditur me shpallje publike".
6. **Seanca e datës 04.04.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Seanca e pajtimit u zhvillua në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur. Gjykata shtyn seancën përgatitore më datë 26.04.2019 ora 12.00. Pala paditëse mori dijeni, të njoftohet pala e paditur me shpallje publike".
7. **Seanca përgatitore e datës 26.04.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Seanca përgatitore e datës 26.04.2019 ora 12.00 nuk u zhvillua pasi gjyqtarja mungon për arsye shëndetësore me raport mjekësor. Seanca e radhës më datë 2019 ora . Pala e paditur ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance. Të njoftohen palët ndërgjyqëse. Tiranë datë 26.04.2019". (i kemi qëndruar strikt përmbajtjes së procesverbalit duke qenë se nuk deduktohet qartë shkaku i shtyrjes por edhe seanca e ardhshme).
8. **Seanca përgatitore e datës 22.05.2019.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja mungon për arsye shëndetësore (me raport mjekësor). Në procesverbal relatohet fakti se për seancën e ardhshme, gjykata do të njoftojë palët me fletë- thirrje.
9. **Seanca përgatitore e datës 21.06.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 20.09.2019, për t'i dhënë mundësi përfaqësuesit ligjor të palës së paditur për t'u pajisur me aktin e përfaqësimit.
10. **Seanca përgatitore e datës 20.09.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 08.11.2019, për të njoftuar edhe njëherë palën e paditur duke qenë se kjo e fundit rezultoi të mos ketë dijeni për këtë seancë.
11. **Seanca përgatitore e datës 08.11.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.01.2020, për shkak të mosmarrjes dijeni të palës së paditur për

zhvillimin e kësaj seance dhe njoftimin e saj edhe njëherë në numrin e telefonit celular të vënë në dispozicion nga pala paditëse.

12. **Seanca përgatitore e datës 23.01.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 20.02.2020, për shkak të mosmarrjes dijeni të palës së paditur për zhvillimin e kësaj seance dhe njoftimin e saj edhe njëherë në numrin e telefonit celular, e konfirmuar edhe njëherë nga pala paditëse.
13. **Seanca përgatitore e datës 20.02.2020**, në të cilën gjykata ka konstatuar sërish mosmarrjen dijeni të palës së paditur për zhvillimin e kësaj seance, shkak për të cilin ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.03.2020, dhe njoftimin sërish të palës së paditur përmes numrit të tij të telefonit celular.
14. **Seanca përgatitore e datës 19.03.2020**. Në bazë të aktit normativ nr.9, datë 25.03.2020 *"Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19"* dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.127 datë 10.03.2020 *"Për pezullimin e veprimtarisë gjyqësore në të gjithë gjykatat e Republikës së Shqipërisë"*, kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore. Seanca e ardhshme u caktua në datë 08.07.2020.
15. **Seanca përgatitore e datës 15.06.2020**. Në këtë seancë, gjykata relatton paraqitjen e një kërkesë për shtyrje nga ana e palës paditëse, shkak për të cilin gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 08.07.2020, duke çmuar njëherazi edhe njoftimin e palës së paditur me shpallje publike në kushtet kur kjo e fundit nuk disponon adresë banimi apo numër telefoni të saktë.
16. **Seanca e datës 08.07.2020**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënim *"Vendim: Gjykata në bazë të nenit 125, 158/c të K.Pr.C. vendos të kaloj çështjen në seancë gjyqësore si dhe për t'i dhënë kohë psikologes për të përgatitur raportin e vlerësimit psikologjik. Seanca e ardhshme gjyqësore do të zhvillohet më datë 29.09.2020 ora 13.30. Palët prezent morën dijeni, të njoftohet pala e paditur me shpallje publike"*.
17. **Seanca gjyqësore e datës 29.09.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 03.12.2020, me qëllim për t'i dhënë edhe një mundësi eksperte psikologe që të paraqesë raportin e vlerësimit psikologjik.
18. **Seanca gjyqësore e datës 03.12.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 25.01.2021, për të njëjtin shkak sikundër cituar në rastin e seancës gjyqësore të datës 29.09.2020, duke i dhënë sërish kohë ekspertes psikologe që të paraqesë raportin e vlerësimit psikologjik.
19. **Seanca gjyqësore e datës 25.01.2021**, në të cilën gjykata ka konstatuar se ekspertja psikologe ka patur pengesa nga pala e paditur për të përmbushur detyrën e caktuar nga gjykata, shkak për të cilin ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 10.03.2021.
20. **Seanca e datës 10.03.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënim *"Procesverbal administrativ. Seanca përgatitore⁸⁶ e datës 10.03.2021 ora 11.00 nuk*

⁸⁶ Cilësohet në procesverbal si përgatitore por në fakt kjo seancë është zhvilluar pas seancës gjyqësore të datës 08.07.2020.

u zhvillua se gjyqtarja mungon për arsye shëndetësore, (me leje vjetore për shkak të COVID-19). Seanca e ardhshme do të zhvillohet më datë 11.06.2021..”.

- 21. Seanca e datës 11.06.2021.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja mungon për arsye shëndetësore (me raport mjekësor). Seanca e ardhshme u caktua për në datë 01.07.2021.
- 22. Seanca gjyqësore e datës 01.07.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 22.09.2021, për t'i dhënë sërish kohë ekspertës psikologe, për të përmbushur detyrën e dhënë nga gjykata.
- 23. Seanca e datës 22.09.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
- 24. Seanca e pajtimit e datës 28.02.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 30.05.2022 për shkak të mosmarrjes dijeni të palës së paditur për zhvillimin e kësaj seance. (sipas procesverbalit rezulton për herë të parë gjyqtare e çështjes V. Z) .
- 25. Seanca e datës 30.05.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “shënim për seancën” konstatohet shënimi *“Vendim: Gjykata në bazë të nenit 158 të K.Pr.Civile vendos që të kalojë çështjen në seancë të veprimeve përgatitore. Seanca e veprimeve përgatitore do të zhvillohet në datë 12.09.2022 ora 10.30. Pala paditëse prezent mori dijeni. Të njoftohet pala e paditur për seancën e veprimeve përgatitore dhe për deklaratën e mbrojtjes tek av.B.K. . Palës së paditur i lihet kohë që të paraqesë deklaratën e mbrojtjes dhe prova të tjera nëse ka, brenda 30 ditëve nga e nesërmyja e marrjes dijeni”.*
- 26. Seanca përgatitore e datës 12.09.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit më datë 28.10.2022 si dhe caktimin e ekspertës L.H.
- 27. Seanca gjyqësore e datës 28.10.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.01.2023, me qëllim dhënien kohë ekspertës që të paraqesë akt ekspertimin.
- 28. Seanca e datës 23.01.2023.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
- 29. Seanca gjyqësore e datës 06.03.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 20.03.2023, me qëllim komunikimin e një kopje të akt-ekspertimit palës së paditur.
- 30. Seanca e datës 20.03.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin për pranimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 30 (tridhjetë) seanca nga të cilat 6 (gjashtë) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar dhe për 2 (dy) seanca nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të tyre. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga mosmarrja dijeni e palëve ndërgjyqëse (specifikisht palës së paditur), veprimet procedurale që lidhen me ekspertë ose akt ekspertimin, mungesë e gjyqtarit për arsye

objektive si edhe gjendja e pandemisë së COVID-19, e cila solli për pasojë pezullimin e veprimtarisë gjyqësore. Kjo çështje rezulton që të jetë marrë në shqyrtim në fillim nga gjyqtare K.A (e cila rezulton gjyqtare e kësaj çështje deri më datë 01.07.2021, kur u zhvillua seanca e caktuar në këtë datë). Më tej evidentohet fakti seanca e datës 28.02.2022 si dhe ato të caktuara në vijim, të jenë zhvilluar nga gjyqtare V.Z, e cila rezulton të ketë shpallur dhe vendimin përkatës për këtë çështje. (Lidhur me procesverbalin e seancës së datës 22.09.2021, i cili rezulton se nuk përmban asnjë të dhënë, mund të jetë rasti që kjo seancë e paracaktuar nga gjyqtarja K.A nuk është zhvilluar për shkak të shkarkimit të saj më datë 10.09.2021 me vendimin nr. 437 të KPK), Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 14 ditë (seanca 06.03.2023 – 20.03.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 5 muaj e 6 ditë (seanca 22.09.2021 – 28.02.2022). Kjo e fundit përkon me fazën procedurale kur është ndryshuar trupa gjykuese.

- *Dy çështje me objekt "kundërshtim veprimesh përmbaremore":*

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Ankimi është paraqitur në gjykatë në datë 19.01.2023⁸⁷, është regjistruar në këtë të fundit në datë 27.01.2023 dhe është shortuar në datë 31.01.2023⁸⁸.

- Me vendimin "Për caktimin e seancës gjyqësore" datë 02.02.2023, gjyqtarja ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit më datë 13.03.2023.
- 1. **Seanca gjyqësore e datës 13.03.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për më datë 06.04.2023 për t'iu drejtuar me kërkesë gjyqtarës A.K nëse nga ana e Zyrës së Përmbaremit Tiranë është ekzekutuar vendimi i saj.
- 2. **Seanca gjyqësore e datës 06.04.2023**, në të cilën gjykata pasi ka dëgjuar pretendimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse, ka vendosur mbylljen e hetimit gjyqësor dhe shtyrjen e seancës më datë 25.04.2023, me qëllim shpalljen e arsytuar të vendimit. *(në sistemin elektronik nuk evidentohet procesverbal me këtë datë seance por me datën 24.04.2023, i cili rezulton të jetë bosh pa asnjë informacion).*
- 3. **Seanca e datës 25.04.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar duke pranuar ankimin e kërkuarit për këtë çështje.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 3 (tre) seanca të cilat rezultojnë të jenë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se kryesisht dy seancat e para janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër relatuar më sipër. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave evidentohet fakti se distanca më e

⁸⁷ Referuar numërorit fizik rezulton se datë e paraqitjes është 26.01.2023 ndërsa referuar sistemit elektronik të gjykatës rezulton se datë e paraqitjes është 19.01.2023.

⁸⁸ Referuar tabelës me të dhënat statistikore nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit.

shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 1 dite (seanca 24.04.2023 - 25.04.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 1 muaj e 1 ditë (seanca 24.04.2023 – 25.04.2023).

II. Çështja nr.2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 06.07.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 06.07.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezultojnë:

1. **Seanca e datës 15.07.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.07.2020, për të përsëritur njoftimin për njërin nga të paditurit, i cili rezultojnë të mos ketë dijeni për zhvillimin e seancës së kësaj date.
2. **Seanca e datës 23.07.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 17.09.2020, për t'i dhënë mundësi palës së paditur që të përgatisë deklaratat e mbrojtjes në kuadër të padisë objekt gjykimi. Në procesverbal raportohet fakti se seanca caktohet në datë 17.09.2020 për shkak se në muajin gusht 2020, gjykata e pezullon veprimtarinë e saj për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve.
3. **Seanca e datës 17.09.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 21.10.2020, me qëllim dhënien mundësi përfaqësuesve të palës paditëse, që të jenë prezent.
4. **Seanca e datës 21.10.2020**, në të cilën gjykata ka vlerësuar si të arsyeshme kërkesën e palës së paditur, për shtyrjen e seancës, në pritje të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë datë 23.07.2020, të disponuar lidhur me ankimin e palës së paditur për "pezullimin e veprimeve përmbartimore". Për këtë shkak, seanca u shty për në datë 11.12.2020.
5. **Seanca e datës 11.12.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 15.01.2021, për t'i dhënë mundësi palës paditëse që të njihet me deklaratën e mbrojtjes së palës së paditur, të paraqesë provat e pretenduara prej saj dhe që një të paditurit të paraqesë kartelën e rifreskuar të pronës së tij.
6. **Seanca gjyqësore e datës 15.01.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 27.01.2021, me qëllim njoftimin e ekspertës për t'u paraqitur në këtë gjykim si dhe për t'i dhënë kohë palës paditëse që të paraqesë provën e pretenduar.
7. **Seanca gjyqësore e datës 27.01.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 25.02.2021, me qëllim dhënien kohë ekspertës që të përfundojë aktin e ekspertimit.
8. **Seanca gjyqësore e datës 25.02.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i disponuar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Gjykata vendos të shtyjë seancën gjyqësore për t'i dhënë mundësi palës paditëse që të marrë përgjigjen nga ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë lidhur me

paditësit A.K dhe D.K. Për këtë arsye, seanca e ardhshme caktohet në datë 07.04.2021 ora 12:30".

9. **Seanca gjyqësore e datës 07.04.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 18.05.2021, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse që të njihen me aktin e ekspertimit.
10. **Seanca gjyqësore e datës 18.05.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur vënien në dispozicion ekspertes B.L. të detyrave shtesë të parashtruara prej palëve, me qëllim përgatitjen e shtesë akt ekspertimit nga ekspertja. Për këtë shkak, gjykata shtyn seancën për në datë 08.06.2021.
11. **Seanca gjyqësore e datës 08.06.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 30.06.2021, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse që të njihen me shtesë akt- ekspertimin si dhe pala e paditur të njihet me provën e re shkresore, të depozituar nga pala paditëse.
12. **Seanca gjyqësore e datës 30.06.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 29.09.2021, me qëllim që ekspertes, t'i vihen në dispozicion pyetjet shtesë, për të përgatitur dhe paraqitur shtesë akt - ekspertimin.
13. **Seanca gjyqësore e datës 29.09.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 11.11.2021, me qëllim dhënien mundësi përfaqësuesve të palës së paditur B.A. që të jenë prezent në gjykim.
14. **Seanca përgatitore⁸⁹ e datës 11.11.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 28.01.2022, për t'i dhënë kohë palëve ndërgjyqëse që të njihen me shtesë akt-ekspertimin.
15. **Seanca e datës 28.01.2022**, në të cilën gjykata, me kërkesë të përfaqësuesit të palës paditëse, ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 08.03.2022, duke e çmuar mosparaqitjen në gjykim për shkaqe të ligjshme.
16. **Seanca e datës 08.03.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 04.05.2022, për t'i dhënë kohë ekspertes të përgatisë shtesën e akt ekspertimit dhe njëkohësisht palës paditëse të saktësojë nëse ka patur ndonjë kalim të drejtash nga D.K tek B.K, nga koha e fitimit të pronësisë deri në momentin e kryerjes së legalizimit nga ky i fundit.
17. **Seanca e datës 04.05.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 13.05.2022, me qëllim njoftimin e ekspertes.
18. **Seanca përgatitore⁹⁰ e datës 13.05.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi " *Vendim:Gjykata, referuar edhe kërkesës së palës paditëse, vendos të shtyjë seancën përgatitore për t'i dhënë kohë dhe mundësi palës së paditur të paraqitet në gjykim, në kushtet kur nuk ka munguar në asnjë seancë. Seanca e ardhshme do të zhvillohet më datë 09.06.2022 ora 11.30". (nuk kuptohet qarte*

⁸⁹ Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës, relatohet konkretisht "seanca e ardhshme përgatitore caktohet në datë 28.01.2022 ora 11.00" duke e cilësuar seancën e datës 11.11.2021 si përgatitore".

⁹⁰ Në procesverbal kjo seancë referohet si përgatitore ndërkohë seancat e mëparshme si gjyqësore, çka mund të jetë lapsus.

shkakut i shtyrjes pra nese eshte paraqitur kerkese per shtyrje nga pala paditese vetem apo edhe nga pala e paditur".

19. **Seanca e datës 09.06.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 12.09.2022, për t'i dhënë kohë palës paditëse që të paraqesë vërtetimin hipotekar të cituar në procesverbalin audio.
20. **Seanca gjyqësore e datës 12.09.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.09.2022, për t'iu dhënë kohë palëve që të paraqesin pretendimet përfundimtare me shkrim.
21. **Seanca gjyqësore e datës 19.09.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 07.10.2022, për të shpallur vendimin e arsyetuar.
22. **Seanca e datës 07.10.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur riçeljen e hetimit gjyqësor, me qëllim që të plotësohet akti i ekspertimit. Ndër të tjerash, gjykata ka vendosur të caktojë si eksperte R.D dhe të shtyjë seancën për në datë 18.10.2022, me qëllim betimin e saj dhe dhënien e detyrave nga ana e gjykatës.
23. **Seanca e datës 18.10.2022**, në të cilën gjykata ka pranuar kërkesën e përfaqësuesve të njërit prej të paditurve për shtyrje seance, duke e vlerësuar si të ligjshëm shkaku të mosparaqitjes së tyre. Seanca e ardhshme u caktua për në datë 31.10.2022.
24. **Seanca gjyqësore e datës 31.10.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 18.11.2022, për t'i dhënë mundësi ekspertës, që të jetë prezent në gjykim.
25. **Seanca e datës 18.11.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 16.12.2022, për t'i dhënë mundësi ekspertës që të përgatisë dhe paraqes akt ekspertimin.
26. **Seanca gjyqësore e datës 16.12.2022**, është shtyrë me kërkesë të ekspertës, duke pranuar kërkesën e kësaj të fundit për t'i dhënë autorizim nga gjykata, me qëllim që të paraqitet pranë ASHK, për të bërë verifikimet përkatëse për pasuritë objekt gjykimi. Gjykata ka caktuar seancën e radhës për në datë 24.01.2023.
27. **Seanca gjyqësore e datës 24.01.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 03.02.2023, me qëllim dhënien kohë palëve që të njihen me aktin e ekspertimit të depozituar në ekspertja.
28. **Seanca gjyqësore e datës 03.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 13.02.2023, për t'i dhënë mundësi ekspertës që të saktësojë përgjigjen e pyetjes nr.3, të caktuar më parë nga gjykata.
29. **Seanca gjyqësore e datës 13.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 10.03.2023 për t'i dhënë kohë mundësi palëve ndërgjyqëse që të njihen me shtesë akt ekspertimin.
30. **Seanca gjyqësore e datës 10.03.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 15.03.2023, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse që të paraqesin pretendimet përfundimtare me shkrim.
31. **Seanca gjyqësore e datës 15.03.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 05.04.2023, për të shpallur vendimin e arsyetuar.

32. **Seanca gjyqësore e datës 05.04.2023.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtari D.C. ishte me leje vjetore. Seanca e ardhshme u caktua për në datë 20.04.2023.
33. **Seanca e datës 20.04.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin për pranimin e padisë së paditësit XH.LI, pranimin pjesërisht të padisë së paditësve I.K dhe A.K dhe rrëzimin e padisë së paditësit D.K.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 33 (tridhjetë e tre) seanca nga të cilat 1 (një) seancë nuk rezulton të jetë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të pasjella nga kërkesat e palëve ndërgjyqëse dhe/ose përfaqësuesve si edhe nga veprimet procedurale që lidhen me ekspertë ose akt ekspertimin. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 5 ditë (seanca 10.3.2023 – 15.03.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 3 muaj (seanca 30.06.2021 – 29.09.2021).

- Dy çështje me objekt “shkaktim dëmi”:

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 15.08.2022, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 15.08.2022 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatesisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 10.10.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimet e kësaj seance.
2. **Seanca e datës 24.11.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “shënim për seancën” është bërë shënimi “Gjykata në veprime paraprake vendosi: 1. Caktimin e seancës së veprimeve përgatitore. 2. Seanca përgatitore do të zhvillohet më datë 02.12.2022 ora 12.30, që do të zhvillohet në zyrën nr.207, kati i II-të. 3. Sekretaria gjyqësore do të njoftojë palët për seancën përgatitore”. (i jemi referuar strikt përmbajtjes duke qenë se referohet si seancë)
3. **Seanca përgatitore e datës 02.12.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datë 23.01.2023, me qëllim që të përsëritet njoftimi për palën e tretë në gjykim si dhe të njoftohet Avokatura e Shtetit dhe për kërkesëpadinë dhe provat.
4. **Seanca e datës 23.01.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 07.03.2023 me qëllim dhënien kohë ekspertit për akt-ekspertimin.

5. **Seanca e datës 07.03.2023**, në të cilën gjykata bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit për në datë 04.04.2023.
6. **Seanca gjyqësore e datës 04.04.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 04.05.2023 me qëllim dhënien mundësi palës paditëse që të sjellë vërtetim të ri bashkë me aktet e shoqatës.
7. **Seanca e datës 04.05.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse për t'i dhënë kohë që të paraqesë pretendimet përfundimtare duke e shtyrë seancën për në datë 09.05.2023.
8. **Seanca e datës 09.05.2023**, në të cilën gjykata, ka vendosur bazuar në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile, shtyrjen e seancës për në datë 15.05.2023, me qëllim shpalljen e arsyetuar të vendimit përfundimtar.
9. **Seanca e datës 15.05.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar, për pranimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 8⁹¹ (tetë) seanca nga cilat për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin e saj. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër janë njoftimi i personit të tretë, kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhënien kohë palës paditëse për paraqitjen e provave apo pretendimeve përfundimtare etj. Për sa i përket distancës kohore⁹² ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 5 ditë (seanca 15.03.2023- 21.03.2023), ndërsa distanca më e largët është ajo prej 1 muaj e 21 ditë (seanca 02.12.2022 – 23.01.2023).

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 27.09.2017, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 27.09.2017 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatesisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton se:

1. **Seanca e datës 26.10.2017**, në të cilën gjykata ka vendosur që në bazë të nenit 158 të Kodit të Procedurës Civile të kalojë çështjen në seancë gjyqësore. Gjykata caktoi zhvillimin e kësaj seancë për në datë 21.11.2017 dhe vendosi njoftimin e palës së paditur në mungesë për datën e kësaj seance gjyqësore.

⁹¹ Në këtë numër nuk përfshihet seanca e datës 24.11.2022.

⁹² Në përlogaritjen e distancës kohore më të shkurtër apo më të largët është përjashtuar seanca e datës 10.10.2022 për të cilën nuk ka informacion dhe seanca e datës 24.11.2022.

2. **Seanca gjyqësore e datës 21.11.2017.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja është në një ceremoni mortore të një punonjësi të gjykatës. Seanca e radhës u caktua për në datë 18.12.2017.
3. **Seanca e datës 18.12.2017,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.01.2018 me qëllim përsëritjen e njoftimit për palën e paditur.
4. **Seanca e datës 23.01.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 12.02.2018, për t'i dhënë mundësi palës së paditur që të paraqesë provat shkresore në formën e kërkuar nga ligji.
5. **Seanca e datës 12.02.2018.** Kjo seancë nuk u zhvillua pasi gjyqtarja nuk u paraqit në punë, për arsye shëndetësore. Seanca e radhës u caktua për në datë 12.03.2018.
6. **Seanca gjyqësore e datës 12.03.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse dhe të marrë provën me ekspert. Për këtë qëllim, seanca gjyqësore shtyhet për në datë 03.04.2018, për të thirrur një ekspert të fushës.
7. **Seanca gjyqësore e datës 03.04.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur që në bazë të nenit 125 të Kodit të Procedurës Civile, të shtyjë seancën gjyqësore për në datë 10.04.2018, me qëllim njoftimin e ekspertit.
8. **Seanca gjyqësore e datës 10.04.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur që në bazë të nenit 125 të Kodit të Procedurës Civile të shtyjë seancën gjyqësore për në datë 03.05.2018, me qëllim dhënien kohë ekspertit për të përgatitur akt ekspertimin.
9. **Seanca e datës 03.05.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur revokimin e vendimit për caktimin e ekspertit duke pranuar kërkesën e tij dhe caktuar si eksperte të fushës. Me qëllim njoftimin e ekspertës në fjalë, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 11.05.2018.
10. **Seanca gjyqësore e datës 11.05.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 31.05.2018, me qëllim dhënien kohë ekspertës për të përgatitur akt ekspertimin.
11. **Seanca gjyqësore e datës 31.05.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 13.06.2018, duke pranuar kërkesën e palës paditëse për t'i dhënë kohë për paraqitjen e aktit që vërteton se i dëmtuari ka qenë në marrëdhënie pune.
12. **Seanca gjyqësore e datës 13.06.2018,** në të cilën gjykata, bazuar në nenin 125 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 02.07.2018 me qëllim dhënien kohë ekspertës për të përfunduar aktin e ekspertimit.
13. **Seanca gjyqësore e datës 02.07.2018.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se bazuar në nenin 125 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës më datë 19.07.2018 *(në procesverbalin e kësaj seance citohet kjo date)*, për t'i dhënë kohë palëve për t'u njohur me aktin e ekspertimit.
14. **Seanca e datës 19.09.2018.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" rezulton shënimi *"Gjykata relatton shtyrjen e seancës së kaluar. Me që seanca e datës 19.07.2018 nuk është zhvilluar për arsye shëndetësore të gjyqtarës së çështjes dhe nga ana e sekretarës gjyqësore janë përsëritur njoftimet rezulton të mos ketë një kthim përgjigje të fletëthirrjes së ekspertës dhe në këto kushte meqë prezenca e saj është*

- e domosdoshme në gjykim shtyhet seance për në datë 01.10.2018 ora 13.00". (Fakti i shtyrjes së seancës së datës 19.07.2018 evidentohet në procesverbalin e seancës datë 19.09.2018, ndërkohë që sistemi elektronik i gjykatës lidhur me këtë çështje, nuk rezultoi të gjenerojë procesverbal për seancën e datës 19.07.2018)*
- 15. Seanca e datës 01.10.2018.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezultoi se gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.10.2018 me qëllim dhënien kohë ekspertës për t'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara përmes shtesë akt ekspertimit që do të përgatisë.
- 16. Seanca gjyqësore e datës 23.10.2018,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 05.11.2018, me qëllim dhënien kohë palëve për t'u njohur me shtesë akt ekspertimin e përgatitur nga ekspertja.
- 17. Seanca e datës 05.11.2018.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezultoi se gjykata ka marrë në shqyrtim një kërkesë të parashtruar nga ana e palës së paditur, për të cilën ka vendosur të shtyjë seancën për në datë 08.11.2018, me qëllim për t'u shprehur me vendim brenda ditëve sikundër përcakton neni 183 i Kodit të Procedurës Civile. Në procesverbalin e kësaj seance nuk specifikohet lloji apo objekti i kërkesës së parashtruar.
- 18. Seanca e datës 08.11.2018.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar në sistemin elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" evidentohet shënimi "*për të caktuar ekspert*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e palës së paditur duke caktuar një grup ekspertësh që përbëhet nga ekspert mjeko ligjore, duke e kërkuar nga IML, si dhe të caktojë një ekspert vlerësues. Seanca gjyqësore caktohet në dt.22.11.2018 ora 13.30".*
- 19. Seanca gjyqësore e datës 22.11.2018.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar në sistemin elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" evidentohet shënimi "*për të njoftuar ekspertët*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e palës së paditur duke caktuar një grup ekspertësh që përbëhet nga ekspert mjeko ligjor, duke e kërkuar nga IML. Seanca gjyqësore caktohet në dt. 05.12.2018 ora 13.30".*
- 20. Seanca e datës 05.12.2018.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja nuk ishte paraqitur në punë (kishte një rast vdekjeje). Seanca e radhës u caktua për në datë 24.12.2018.
- 21. Seanca gjyqësore e datës 24.12.2018.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar në sistemin elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" evidentohet shënimi "*Gjykata vendosi në bazë të nenit 125 të K.Pr.C. të shtyjë seancën gjyqësore për ti dhënë kohë palëve për realizimin e akt – ekspertimit. Gjykata pyetjet për ekspertët do t'i jap me një vendim të shkruar. Seanca gjyqësore caktohet në datë 31.01.2019...".*
- 22. Seanca gjyqësore e datës 31.01.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur që në bazë të nenit 125 të Kodit të Procedurës Civile, të shtyjë seancën gjyqësore për t'i dhënë kohë palëve për t'u njohur me akt ekspertimin.
- 23. Seanca gjyqësore e datës 25.02.2019.** Kjo seancë gjyqësore nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja është me raport.

24. **Seanca gjyqësore e datës 02.04.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur që të pranojë kërkesën e ekspertit për t'i dhënë mundësi këtij të fundit që të bëjë shtesë akt – ekspertimin. Për këtë arsye, gjykata vendos shtyrjen e seancës për në datë 30.04.2019.
25. **Seanca gjyqësore e datës 30.04.2019**. Me kërkesë të palës së paditur, gjykata ka vendosur që të shtyjë seancën gjyqësore për në datë 14.05.2019, për t'i dhënë mundësi përfaqësuesit të palës së paditur për t'u njohur me akt ekspertimin.
26. **Seanca gjyqësore e datës 14.05.2019**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “shënim për seancën” konstatohet shënimi “Gjykata vendosi të shtyjë seancën gjyqësore për t'i dhënë ekspertit si detyrë për të bërë ndarjen në tre figura të veçanta, si dhe pyetjen e palës së paditur “a i ka kryer këto shpenzime paditësi. *Seanca gjyqësore caktohet në dt.07.06.2019*”.
27. **Seanca gjyqësore e datës 07.06.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur që të shtyjë seancën gjyqësore për në datë 27.06.2019, për t'i dhënë kohë përfaqësuesit të palës paditëse për t'u njohur me ndryshimet e aktit të ekspertimit të bëra në këtë seancë nga eksperti.
28. **Seanca gjyqësore e datës 27.06.2019**. Kjo seancë nuk u zhvillua pasi gjyqtarja është me raport. *Seanca gjyqësore e radhës u caktua për në datë 19.07.2019*.
29. **Seanca e datës 19.07.2019**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
30. **Seanca gjyqësore e datës 01.10.2019**, në cilën gjykata, konform nenit 224/a, të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur kryerjen e një akti ekspertimi psikologjik mjekoligjor dhe vlerësues dëmi duke caktuar ekspertë.....dhe një ekspert nga IML, duke përjashtuar ekspertët që kanë dhënë mendim për rastin në fjalë pasi çmon se nevojiten njohuri të posaçme shkencore në fushat respektive. Në këto kushte, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.10.2019.
31. **Seanca gjyqësore e datës 23.10.2019**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 15.11.2019, për t'u bërë të mundur ekspertëve që të dorëzojnë aktet e ekspertimeve si dhe për t'i përsëritur njoftimin Institutit të Mjekësisë Ligjore për caktimin e një mjeku për kryerjen e një akti ekspertimi mjekoligjor.
32. **Seanca gjyqësore e datës 15.11.2019**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja ndodhet në një konferencë të organizuar nga Ministria e Drejtësisë, të miratuar me leje nga kryetari i gjykatës.
33. **Seanca gjyqësore e datës 20.01.2020**. Në këtë seancë, gjykata ka konstatuar faktin se eksperti Z.I, rezulton të ketë dhënë më parë vendim në kushtet e riekspertimit ligjor në gjykimin penal të çështjes, shkak për të cilin gjykata vendos zëvendësimin e tij me një tjetër ekspert mjeko – ligjor. Në këto kushte, gjykata vendos shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 03.02.2020, me qëllim për t'iu drejtuar me shkresë Institutit të Mjekësisë Ligjore, duke i bërë me dije këtij të fundit ekspertët (S.M, Z.I, L.D, A.LL) të cilët përjashtohen në këtë rast, pasi kanë dhënë mendim më parë.

- 34. Seanca gjyqësore e datës 03.02.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur që të shtyjë seancën për në datë 28.02.2020, për: t'i dhënë mundësi ekspertit mjeko - ligjor që të konkludojë me detyrat e dhëna nga gjykata; t'i komunikuar palës së paditur në mungesë, një kopje të akt ekspertimit psikologjik si dhe; për të bërë rinjoftimin e ekspertit G.J.S.
- 35. Seanca e datës 28.02.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 30.03.2020, për t'i dhënë kohë dhe mundësi ekspertit mjeko-ligjor për të konkluduar me aktin e ekspertimit. Gjithashtu, gjykata vendos njoftimin edhe të ekspertëve që mungonin në këtë seancë.
- 36. Seanca e datës 30.03.2020**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore, me vendimin nr.127 datë 10.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor *"Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë"* si dhe aktin normativ nr.9, datë 25.03.2020 *"Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19"*. (procesverbali nuk referon ndonjë datë seance të ardhshme sikunder kemi konstatuar në raste të ngjashme).
- 37. Seanca e datës 03.07.2020**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Gjykata urdhëron që pasi akti i ekspertimit të depozitohet në sekretarinë gjyqësore, t'i komunikohet palëve ndërgjyqëse për t'u njohur me të. Një kopje e aktit të ekspertimit do të vihet në dispozicion edhe ekspertit G.J.S, i cili është betuar dhe ka marrë detyrat në seancat pararendëse. Sa më sipër, shtyn seancën për në datë 14.09.2020, ora 10.00. Të njoftohen ekspertët I.H, dhe A.K"*.
- 38. Seanca gjyqësore e datës 14.09.2020**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Gjykata urdhëron komunikimin e aktit të ekspertimit mjekoligjor palës së paditur, me qëllim diskutimin e tij në seancën gjyqësore të radhës, në mënyrë që të jetë prezent edhe eksperti mjekoligjor. Sa më sipër, shtyn seancën për në datë 16.10.2020 ora 11.00. Të njoftohet pala në mungesë dhe ekspertët"*.
- 39. Seanca gjyqësore e datës 16.10.2020**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Gjykata urdhëron që kontestimet me shkrim të palëve paditëse, t'i përcillen ekspertit A.K, i cili duhet të shprehet me shkrim në lidhje me mospërfshirjen e një pjese të dëmtimeve shëndetësore të palëve paditëse në analizën e aktit të ekspertimit dhe për pasojë në përqindjen e paaftësisë në punë të referuar nga eksperti. Urdhërohet eksperti A.K të jetë prezent në seancën gjyqësore të radhës për të diskutuar aktin dhe kontestimet me shkrim të palëve paditëse. Sa më sipër, gjykata shtyn seancën për në datë 12.11.2020, ora 12.30. Të njoftohet pala në mungesë dhe ekspertët"*.
- 40. Seanca gjyqësore e datës 12.11.2020**, në të cilën gjykata ka konstatuar faktin se eksperti mjeko – ligjor i caktuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, nuk i është

përgjigjur me shkrim kontestimeve të palës paditëse shkak ky, për të cilin gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 09.12.2020.

41. **Seanca e datës 09.12.2020**, në të cilën gjykata ka konstatuar mosparaqitjen në gjykim të ekspertit A.K, për shkak të arsyeshme shëndetësore, shkak për të cilin vendos shtyrjen e seancës për në datë 29.01.2021.
42. **Seanca e datës 29.01.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Seanca e datës 29.01.2021 nuk u zhvillua për shkak të mungesës së gjyqtarës për arsye shëndetësore të vërtetuara me raport mjekësor. Vendim për caktimin e seancës gjyqësore. Seanca e radhës e çështjes civile nr.469 akti, do të zhvillohet më datë 26.03.2021*".
43. **Seanca e datës 26.03.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për në datë 12.04.2021 me qëllim dhënien kohë ekspertëve për të përgatitur akt ekspertimin. Gjithashtu gjykata ka vendosur njoftimin e shoqërisë së sigurimeve "... " sh.a.
44. **Seanca gjyqësore e datës 12.04.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Seanca gjyqësore datë 12.04.2021 e çështjes civile nr. Akti nuk u zhvillua, për shkak të mungesës së gjyqtarës A.P. për arsye shëndetësore të vërtetuara me raport mjekësor. Vendim për caktimin e seancës gjyqësore . Seanca gjyqësore e radhës e çështjes civile nr. Akti do të zhvillohet më datë 10.05.2021 ora 13.00. Urdhërohet sekretaria gjyqësore të realizojë njoftimin e palëve. Tiranë më datë 12.04.2021.*"
45. **Seanca e datës 10.05.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 16.06.2021, për t'u mundësuar ekspertëve depozitimin e aktit të ri ekspertimit.
46. **Seanca e datës 16.06.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 30.06.2021, me qëllim për t'i dhënë kohë edhe njëherë paditësit për të bërë të mundur parapagimin e shpenzimeve të aktit të ekspertimit.
47. **Seanca e datës 30.06.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 17.09.2021 me qëllim dhënien kohë palës paditëse për t'u njohur me aktin e ekspertimit si dhe për t'i komunikuar një kopje të akt ekspertimit palës së paditur në mungesë.
48. **Seanca e datës 17.09.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës, tek rubrika " shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Vendim; Gjykata në kushtet e mosparaqitjes në gjykim të përfaqësuesit të palës së paditur juristit E.O, vendos shtyrjen e seancës në dt.01.11.2021 ora 11.00 për ekonomi gjyqësore gjykata urdhëron që kontestimet dhe pyetjet në lidhje me aktin e ekspertimit vlerësues të depozituara me shkrim në protokoll nga ana e palës paditëse t'i vihen në dispozicion ekspertëve për të reflektuar me shkrim qëndrimin e tyre që do të debatohet në seancën e radhës. sipas procesverbalit të së cilës rezulton se, në kushtet e mosparaqitjes në gjykim të përfaqësuesit të palës së paditur juristit E.O, gjykata ka vendosur shtyrjen e saj më për më datë 01.11.2021. Ndër të tjerash , për ekonomi gjyqësore gjykata ka urdhëruar që*

kontestimet dhe pyetjet në lidhje me aktin e ekspertimit vlerësues të depozituara me shkrim në protokoll nga ana e palës paditëse t'i vihen në dispozicion ekspertëve për të reflektuar me shkrim qëndrimin e tyre që do të debatohet në seancën e radhës".

- 49. Seanca e datës 01.11.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 09.12.2021, me qëllim dhënien kohë palës paditëse që të njihet me konkluzionet e shtesës së aktit të ekspertimit dhe të saktësojë specifikisht për secilën prej palëve, vlerën e kërkit. Gjithashtu, gjykata ka vendosur njoftimin e ekspertit G.J.S.
- 50. Seanca e datës 09.12.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.02.2022, me qëllim dhënien kohë palës së paditur për të qartësuar momentin e përfshirjes së vlerës së dëmshpërblimit në shumën 10 500 euro.
- 51. Seanca e datës 23.02.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur të caktojë një seancë të posaçme për administrimin e provave shkresore, shkak për të cilin vendos shtyrjen e seancës për në datë 05.05.2022.
- 52. Seanca gjyqësore e datës 05.05.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Seanca e datës 05.05.2022, nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja është me leje të miratuar nga kryetari. Seanca gjyqësore e radhës e çështjes civile do të zhvillohet më datë 29.06.2022, ora 10.00. Palët prezent morën dijeni. Të njoftohen palët në mungesë"*.
- 53. Seanca gjyqësore e datës 29.06.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Seanca gjyqësore e datës 29.06.2022 e çështjes civile nr. Akti nuk u zhvillua për shkak të mungesës së gjyqtarës për arsye shëndetësore (leje e miratuar nga Kryetari i gjykatës). Seanca e radhës e çështjes civile nr. Akti do të zhvillohet më datë 04.10.2022 ora 11:30"*.
- 54. Seanca e datës 04.10.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 11.11.2022 me qëllim paraqitjen e dy provave në formën e kërkuar nga ligji.
- 55. Seanca e datës 11.11.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" evidentohet shënimi *"Seanca e datës 11.11.2022 e çështjes civile me nr. Akti nuk u zhvillua për arsye se gjyqtarja A.P, nuk u paraqit në detyrë pasi është me leje, të miratuar nga kryetari i gjykatës për shkak të plotësimit të pyetësorit të vetingut. Seanca shtyhet për në datë 07.02.2023, ora 13.30. Të njoftohen palët"*.
- 56. Seanca e datës 07.02.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 14.02.2023 për t'i dhënë mundësi palës së paditur që të paraqesë pretendimet përfundimtare me shkrim.
- 57. Seanca e datës 14.02.2023.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"vendim gjykata shpall vendimin në datë 06.03.2023 ora 14.30. Palët prezent morën dijeni"*.

- 58. Seanca e datës 06.03.2023.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të largimit të gjyqtarës A.P, për arsye objektive (arsye shëndetësore të vajzës). Seanca e radhës u caktua për në datë 21.03.2023.
- 59. Seanca e datës 21.03.2023,** nuk u zhvillua për shkak të mosparaqitjes së gjyqtarës A.P, për arsye shëndetësore (raport mjekësor). Seanca e radhës u caktua për në datë 14.04.2023.
- 60. Seanca e datës 14.04.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin për pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 60 (gjashtëdhjetë) seanca nga të cilat 14 (katërmëdhjetë) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar dhe për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të saj. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga kërkesat e palëve ndërgjyqëse dhe/ose përfaqësuesve, veprimet procedurale që lidhen me ekspertë ose akt ekspertimin, apo edhe mungesë e gjyqtarit. Një rast shtyrje seance specifike evidentohet ajo e datës 23.02.2022, me arsyetimin e caktimit të një "seance të posaçme" për administrimin e provave shkresore. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 3 ditësh (seanca 05.11.2018 – 08.11.2018) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 3 muaj e 5 ditë (seanca 29.06.2022 – 04.10.2022).

- Dy çështje me objekt "kontratë shitje":

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 03.09.2021, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 03.09.2021 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me dhënat statistikore).

Përkatesisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

- 1. Seanca e datës 22.09.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar në sistemin elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "veprim paraprak" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "Drejtuar: A.S.H, e bija e I. dhe e F., e dël ..., lindur në Tiranë, dhe banues në Njësia Administrative..., madhore me zotësi të plotë për të vepruar, Bazuar në nenin 158 të K.Pr.Civile hashkëlidhur kësaj dëftese komunikimi po ju dërgojmë: - Kërkesëpadinë dhe provat shkresore të depozituara nga pala paditëse. – Bashkëlidhur formulari i plotësimit të të dhënave. Gjykata me vendim paraprak të datës 17.09.2021 ka vendosur që pala e paditur duhet të lëshojë deklaratiën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga dita e nesërme e marrjes dijeni për kërkesë-padinë dhe provat.

2. **Seanca e datës 29.10.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "veprim paraprak" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "Dëftesë komunikimi. Drejtuar palës paditëse: A.B, i biri i S. dhe Gj., lindur më ..., me adresë për komunikim: Av.S.V., Blv. Gjykata me vendim paraprak të datës 17.09.2021 ka vendosur që palës paditëse ti caktohet një afat 30 ditë nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes dhe provave, për të paraqitur prova të tjera që lidhen me prapësimet e parashtruara prej palës së paditur në deklaratën e mbrojtjes. Bazuar në nenin 158 të K.Pr.Civile bashkëlidhur kësaj dëftesë komunikimi po ju dërgojmë: - Deklaratën e mbrojtjes dhe provat shpresore të paraqitura nga pala e paditur".
3. **Seanca e datës 03.12.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "veprim paraprak" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "..... Dëftesë Komunikimi, Drejtuar D.F, i biri i K.,..... . Me adresë për komunikim: Gjykata me vendim paraprak të datës 17.09.2021 ka vendosur që palës paditëse ti caktohet një afat 30 ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes dhe provave, për të paraqitur prova të tjera që lidhen me prapësimet e parashtruara prej palës së paditur në deklaratën e mbrojtjes. Bazuar në nenin 158 të K.Pr.Civile bashkëlidhur kësaj dëftesë komunikimi po ju dërgojmë: - Prapësimet e palës paditëse".
4. **Seanca e datës 19.10.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit në datë 15.03.2023.
5. **Seanca gjyqësore e datës 15.03.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur t'i japë fund hetimit gjyqësor dhe të shtyjë seancën për në datë 21.03.2023, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim.
6. **Seanca e datës 21.03.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 06.04.2023, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar, të arsyetuar.
7. **Seanca e datës 06.04.2023.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance. Ndërkaq referuar vendimit të shpallur për këtë çështje, të gjeneruar po nga sistemi elektronik rezulton se gjykata në këtë seancë ka shpallur vendimin për pranimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 4⁹³ (katër) seanca. Nga përmbajtja e seanceve rezulton se këto të fundit janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër janë kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare etj. Për sa i përket distancës kohore⁹⁴ ndërmjet seanceve, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 6 ditë (seanca 15.03.2023- 21.03.2023), ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 9 ditë (seanca 19.10.2022 – 15.03.2023).

⁹³ Në këtë numër nuk përfshihen 3 seancat përkatësisht e datës 22.09.2021, 29.10.2021 dhe 03.12.2021 të cilat sipas sistemit elektronik rezultojnë me procesverbale seancash.

⁹⁴ Në përlogaritjen e distancës kohore më shkurtër apo më të largët janë përjashtuar 3 seancat e para.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 28.09.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 28.09.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton se:

1. **Seanca e datës 09.03.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 10.05.2021, për të përsëritur njoftimin për palën e paditur M.A pasi nuk konfirmohet marrja dijeni e tij për zhvillimin e kësaj seance si dhe për t'i dhënë mundësi përfaqësuesit të palës së paditur shoqërisë "....." sh.p.k., që të paraqitet në gjykim me aktin e përfaqësimit.
2. **Seanca përgatitore e datës 10.05.2021**. Kjo seancë nuk u zhvillua për arsye shëndetësore familjare të gjyqtarit të cilit iu desh të largohej nga puna në mënyrë urgjente. Me porosi të gjyqtarit seanca e ardhshme do të zhvillohet për në datë 14.07.2021.
3. **Seanca përgatitore e datës 14.07.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 09.11.2021 për t'i dhënë mundësi përfaqësueses së palës paditëse që të paraqesë në cilësinë e provës shkresore praktikën e lejes së legalizimit të godinës ku ndodhet njësia objekt gjykimi. Gjykata ka evidentuar gjithashtu faktin se seanca është caktuar në këtë datë për shkak të ngarkesës në punë si dhe për faktin që në muajin gusht 2021 gjykata e pezullon veprimtarinë e saj normale për shkak të marrjes së lejes vjetore të gjyqtarëve, të përcaktuar me ligj.
4. **Seanca e datës 09.11.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 16.02.2022, për t'i dhënë mundësi përfaqësueses së palës paditëse që të paraqesë një vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës lidhur me arsyen e mosregjistrimit të lejes së legalizimit si dhe t'i japë kohë dhe mundësi përfaqësuesit të palës së paditur për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji shkresat e paraqitura në lidhje me aplikimin për regjistrimin e lejes së legalizimit.
5. **Seanca përgatitore e datës 16.02.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore duke caktuar datën 11.05.2022, për zhvillimin e saj.
6. **Seanca përgatitore⁹⁵ e datës 11.05.2022**, në të cilën gjykata pas shqyrtimit të kërkesës së përfaqësuesit të palës së paditur për shtyrje seance, të cilën e ka vlerësuar si të ligjshme, ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 13.07.2022.

⁹⁵ Referuar procesverbalit të kësaj seance, kjo e fundit cilësohet si përgatitore por që në fazën procedurale ky ndodhet ky proces, çështja ka kaluar në seancë gjyqësore publike.

7. **Seanca përgatitore⁹⁶ e datës 13.07.2022**, në të cilën gjykata pas shqyrtimit të kërkesës së përfaqësueses së palës paditëse për shtyrje seance, të cilën e ka vlerësuar si të ligjshme, ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 10.11.2022.
8. **Seanca përgatitore/gjyqësore⁹⁷ e datës 10.11.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Seanca përgatitore/gjyqësore e datës së sotme 10.11.2022 ora 12:30 nuk do të zhvillohet për shkak se gjyqtari D.C. (i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor) ndodhet në një vizitë studimore në Kroaci. Për sa i përket datës së seancës së ardhshme (e planifikuar paraprakisht nga gjyqtari) do të zhvillohet në datë 30.01.2023 ora 13:30...*".
9. **Seanca e datës 31⁹⁸.01.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e përfaqësueses së palës paditëse për shtyrje seance, për shkak të një procesi gjyqësor tjetër të saj në orën 14:00, duke caktuar seancën e radhës për në datë 18.04.2023.
10. **Seanca gjyqësore e datës 18.04.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 09.05.2023, me qëllim shpalljen e arsyetuar të vendimit.
11. **Seanca e datës 09.05.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) seanca nga të cilat 2 (dy) nuk rezultojnë të jenë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët dhe/ose kërkesat e përfaqësuesve të tyre për shtyrje seance. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 21 ditë (seanca 18.04.2023 – 09.05.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 3 muaj e 28 ditë (seanca 13.07.2022 – 10.11.2022).

- Dy çështje me objekt "padi për marrëdhënie pune":

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadija është paraqitur në gjykatë në datë 18.07.2022, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 18.07.2022 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

⁹⁶ Referuar procesverbalit të kësaj seance, kjo e fundit cilësohet si përgatitore por që në fazën procedurale ky ndodhet ky proces, çështja ka kaluar në seancë gjyqësore publike, me seancën e datës 11.05.2022

⁹⁷ Cilësohet e tillë sipas procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës.

⁹⁸ Në procesverbalin e seancës pararendëse citohet data 30.01.2023 jo (31.01.2023) por që mund të jetë lapsus.

1. **Seanca e datës 22.07.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*vendim për veprime paraprake*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendosi: 1.Njoftimin e kërkesë-padisë dhe një kopje të provave të paraqitura nga pala paditëse, palës së paditur. 2. Palës së paditur i caktohet një afat 30 ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të kërkesëpadisë dhe akteve bashkëlidhur, për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes. 3.Në rast se i padituri nuk merr dijeni në adresën e dhënë, të bëhet njoftimi me shpallje në adresën zyrtare sipas nenit 133 të K.Pr.C.4.Në rast të paraqitjes së deklaratës nga pala e paditur, palës paditëse t'i lihet 30 ditë kohë nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes (prapsimeve) dhe akteve bashkëlidhur për të kundërshtuar qëndrimin e palës së paditur*".
2. **Seanca e datës 28.12.2022;** në të cilën gjykata ka çmuar si objektivisht të justifikuar kërkesën e palës paditëse për shtyrje seance duke e shtyrë këtë të fundit për në datë 09.02.2023.
3. **Seanca e datës 09.02.2023,** në të cilën gjykata bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur të kalojë çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit për në datë 17.03.2023.
4. **Seanca gjyqësore e datës 17.03.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 21.03.2023, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim.
5. **Seanca e datës 21.03.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 24.03.2023, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar, të arsyetuar.
6. **Seanca e datës 24.03.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për rrëzimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 5⁹⁹ (pesë) seanca. Nga përmbajtja e seancave rezulton se këto të fundit janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër janë kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, shpallja e vendimit përfundimtar të arsyetuar etj. Për sa i përket distancës kohore¹⁰⁰ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 3 ditë (seanca 21.03.2023- 24.03.2023), ndërsa distanca më e largët është ajo prej 1 muaj e 12 ditë (seanca 28.12.2022 – 09.02.2023).

II. Çështja nr.2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë

⁹⁹ Në këtë numër nuk përfshihet seanca e datës 22.07.2022.

¹⁰⁰ Në përlogaritjen e distancës kohore më të shkurtër apo më të largët është përjashtuar seanca e datës 22.07.2022.

25.02.2019, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 25.02.2019 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 12.04.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "veprime paraprake" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi " *Vendim: Gjykata bazuar në nenin 158 të K.Pr.C vendosi të shtyjë seancën për ti dhënë kohë palës paditëse që të njihet me deklaratën e mbrojtjes dhe bazuar në nenin 158/b të K.Pr.C, çmon që veprimet paraprake janë kryer, për këtë shkak vendosi të nxjerrë urdhërin për caktimin e seancës përgatitore për më datë 15.05.2019 ora 10.00. Paditësit prezent mori dijeni të njoftohet pala e paditur*".
2. **Seanca përgatitore e datës 15.05.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 14.06.2019, duke çmuar t'i japë mundësinë palës paditëse që të paraqitet në seancë si dhe ti tërheqë vëmendjen që të mos bëhet shkak për zvarritje të procesit.
3. **Seanca përgatitore e datës 14.06.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi " *Vendim: Gjykata për arsye kohe dhe të gjyqeve të tjera të planifikuara ndërpret seancën përgatitore duke e shtyrë për më datë 15.07.2019 ora 10:00. Përfaqësuesit e palëve prezent morën dijeni*".
4. **Seanca e datës 15.07.2019,** në të cilën gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën e palës së paditur për të caktuar ekspert kriminalist të ekzaminimeve kompjuterike dhe ka vendosur të pranojë këtë kërkesë duke e shtyrë seancën për në datë 17.09.019, për thirrjen e këtij eksperti.
5. **Seanca e datës 17.09.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi " *Vendim: gjykata ndodhur në këto kushte shtyn seancën për të përsëritur shkresën edhe njëherë për IPSH për më datë 29.10.2019 ora 12:00. Përfaqësuesit e palëve prezent morën dijeni. Të thirret eksperti*".
6. **Seanca përgatitore e datës 29.10.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 04.12.2019, për t'i dhënë kohë ekspertit për të realizuar aktin e ekspertimit dhe paraqitjen e akt-ekspertimit në datën e planifikuar për seancën e ardhshme.
7. **Seanca e datës 04.12.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi " *Seanca e datës 04.12.2019 ora 13:00 për çështjen me nr. 663 Akti, nuk u zhvillua për shkak të situatës së krijuar si rrjedhojë e lëkundjeve sizmike, duket patur prioritet kryesor sigurinë e qytetarëve dhe të personelit të gjykatave, Këshilli i Lartë Gjyqësor njofton se nuk do të zhvillohen gjyqe në gjykatat që ndodhen në qytetet Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Lezhë, Laç deri sa autoritetet kompetente të konfirmojnë përshtatshmërinë e godinave respektive. Këshilli i Lartë Gjyqësor do të jetë në komunikim të vazhdueshëm*

me drejtuesit e gjykatave për çdo zhvillim të mëtejshëm. Me porosi të gjyqtare, seanca shtyhet për një afat të gjatë kohor për shkak të festave të fundvitit dhe periudhës së mbartjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (1-15 janar) për më datë 17.01.2020 ora 10:30". (referuar permbajtjes së procesverbalit rezulton se në këtë rast i referohet një cështje me nr. 663 Akti që nuk perkon me cështjen objekt relativimi)

8. **Seanca përgatitore e datës 17.01.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Vendim: Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e palës paditëse për tu njohur me aktin e ekspertimit si dhe për t'ia komunikuar kopjen e aktit të palës së paditur. Për këtë shkak, shtyn seancën përgatitore për më datë 17.02.2020 ora 11:30. Përfaqësuesi i palës paditëse dhe eksperti prezent morën dijeni. Ti komunikohet akti palës së paditur...".
9. **Seanca përgatitore e datës 17.02.2020,** në të cilën gjykata ka çmuar se janë kryer të gjitha veprimet paraprake e përgatitore për çështjen objekt gjykimi dhe bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Seanca gjyqësore u caktua në datë 24.03.2020.
10. **Seanca gjyqësore e datës 24.03.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Urdhër për caktimin e seancës për çështjen civile me nr.Regj.Them.1662 datë regjistrimi 25.02.2019. Seanca e caktuar më datë 24.03.2020 ora 10.30, nuk u zhvillua dhe shqyrtimi i kësaj çështje u pezullua, me vendimin nr.127 datë 10.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë", vendimin nr.128 datë 24.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", miratuar me ligjin nr.30/2020. Me hyrjen në fuqi të aktit normativ të datës 27.05.2020, është vendosur rifillimi i veprimtarisë gjyqësore dhe zhvillimi i seancave gjyqësore civile, duke zbatuar masat organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore, të nevojshme për të shmangur grumbullimet në ambientet e gjykatave dhe brenda sallave gjyqësore. Për sa më lart, urdhëroj rifillimin e shqyrtimit të çështjes civile. Seanca caktohet për në datë 03.09.2020.
11. **Seanca e datës 03.09.2020.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja DH.B është sëmurë me raport mjekësor.
12. **Seanca gjyqësore e datës 27.10.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Vendim: gjykata ndodhur në këto kushte vendosi të shtyjë seancën gjyqësore për më datë 22.12.2020 ora 13:00. Për palën paditëse merr përsipër njoftimin asistentja e zyrës. Pala e paditur present mori dijeni".
13. **Seanca e datës 22.12.2020,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës me kërkesë të palës së paditur, duke e vlerësuar këtë të fundit si të bazuar në shkaqe të përligjura. Në këto kushte, gjykata ka caktuar seancën e radhës për një afat të gjatë kohor (përkatësisht më datë 29.03.2021), kjo për shkak të pandemisë së COVID-19,

- periudhës së mbartjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰¹ (1-15 janar 2021) si dhe paracaktimit të seancave të tjera gjyqësore në muajin janar, shkurt dhe mars 2021.
- 14. Seanca e datës 29.03.2021.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja DH.B është sëmurë me raport mjekësor.
- 15. Seanca përgatitore¹⁰² e datës 02.12.2021,** në të cilën gjykata, bazuar në nenin 224 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur thirrjen e një eksperti të ekzaminimeve kompjuterike, caktimin e të njëjtit ekspert z.T.C, kjo për ekonomi gjyqësore dhe pasi mori mendimin e palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu, gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore për më datë 09.02.2022. (referuar këtij procesverballi kjo seancë është zhvilluar nga gjyqtare A.C- Z, e cila del për herë të parë në këtë seancë si gjyqtare e kësaj çështje).
- 16. Seanca gjyqësore e datës 09.02.2022.** Kjo seancë, nuk u zhvillua pasi gjyqtarja A.C- Z është me leje të miratuar nga kryetari i gjykatës, për arsye familjare. Seanca e ardhshme është caktuar për në datë 02.06.2022.
- 17. Seanca e datës 02.06.2022.** Referuar procesverballit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance. (gjyqtare Anila Capo- Zere, me vendimin nr.527 date 04.05.2022 të KPK, i është ndërprerë procesi i rivlerësimit për shkak të dorëheqjes se saj dhe kjo seance nuk është zhvilluar).
- 18. Seanca përgatitore¹⁰³ e datës 27.10.2022,** në të cilën gjykata pasi ka konstatuar se kërkesëpadia është në juridiksionin gjyqësor dhe kompetencë të kësaj gjykate, është e plotë, pa të meta dhe përmban të gjitha elementët e nevojshëm procedurale, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Seanca gjyqësore, është caktuar për në datë 31.01.2023. (Ky procesverbal nuk përmban të dhëna mbi gjyqtarin që ka gjykuar çështjen në këtë seancë).
- 19. Seanca gjyqësore e datës 31.01.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës me kërkesë të palës paditëse duke e çmuar këtë të fundit si objektivisht të justifikuar. Seanca është caktuar për në datë 06.04.2023. Në këtë procesverbal si edhe procesverbalin e seancës vijuese, gjyqtari i çështjes rezulton të jetë E.P.
- 20. Seanca e datës 06.04.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për rrëzimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 19¹⁰⁴ (nëntëmbëdhjetë) seanca nga të cilat 5 (pesë) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar dhe për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të saj. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të pasjella nga kërkesat e palëve ndërgjyqëse dhe/ose përfaqësuesve të tyre, veprimet

¹⁰¹ Sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

¹⁰² Referuar procesverballit të kësaj seance rezulton se tashmë gjyqtare e çështjes është A.C-Z dhe çështja ka kaluar sërish në seancë gjyqësore.

¹⁰³ Referuar procesverballit të kësaj seance rezulton se tashmë gjyqtari i çështjes është E.P dhe çështja ka kaluar sërish në seancë gjyqësore, gjë e cila mund të ketë ardhur si pasojë e ndryshimit të trupit gjykues dhe rrjedhimisht rifillimit nga e para të shqyrtimit gjyqësor.

¹⁰⁴ Në këtë numër nuk përfshihet seanca e parë, e datës 12.04.2019.

procedurale që lidhen me ekspertë ose akt ekspertimin, mungesë e gjyqtarit si edhe gjendja e pandemisë së COVID-19, e cila solli për pasojë pezullimin e veprimtarisë gjyqësore. Kjo çështje rezulton që të jetë marrë në shqyrtim në fillim nga gjyqtare D.H.B (e cila rezulton gjyqtare e kësaj çështje deri më datë 29.03.2021, kur seanca e paracaktuar në këtë datë nuk u zhvillua për shkak të qënies së kësaj gjyqtare me raport mjekësor). Më tej konstatohet se seancat e datave 02.12.2021 dhe 09.02.2022 të jenë zhvilluar nga gjyqtare A.C-Z, ndërsa seancat e dt.31.01.2023, 06.04.2023 të jenë zhvilluar nga gjyqtar E.P, i cili rezulton të ketë shpallur dhe vendimin përkatës për këtë çështje. Për sa i përket distancës kohore¹⁰⁵ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 31 ditë (seanca 15.05.2019 – 14.06.2019) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 5 muaj e 10 ditë (seanca 24.03.2020 – 03.09.2020). Kjo e fundit përkon me periudhën e pandemisë së COVID-19, e cila solli për pasojë pezullimin e veprimtarisë gjyqësore.

- Dy çështje me objekt “përmbushje detyrimi civil”:

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 07.03.2023 është regjistruar në këtë të fundit po në datë 07.03.2023 dhe është shortuar në datë 09.03.2023 (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 23.03.2023.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “Vendimi i seancës” është bërë shënimi “Vendosi: 1. Njoftimin e kërkesë-padisë dhe një kopje të provave të paraqitura nga pala paditëse, palës së paditur. 2. Palës së paditur i caktohet një afat 30 ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të kërkesë-padisë dhe akteve bashkëlidhur, për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes. 3. Në rast se i padituri nuk merr dëjten në adresën e dhënë, të bëhet njoftimi me shpallje në adresën zyrtare të selisë së tij. 4. Në rast të paraqitjes së deklaratës së mbrojtjes nga pala e paditur, palës paditëse t’i lihet 30 ditë kohë nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes (prapësimëve) dhe akteve bashkëlidhur për të kundërshtuar qëndrimin e palës së paditur”.

Ndërkaq, referuar vendimit¹⁰⁶ të shpallur për këtë çështje, më datë 16.05.2023, rezulton se gjykata e ka shqyrtuar këtë çështje me gjykim të shkurtuar, sipas procedurës të përcaktuar

¹⁰⁵ Në përlogaritjen e distancës kohore më të shkurtër apo më të largët është përjashtuar seanca e parë, e datës 12.04.2019.

¹⁰⁶ Gjeneruar po nga sistemi elektronik i gjykatës.

në nenin 162/a të Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim të këtij gjykimi, gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 28.02.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 28.02.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 16.10.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 29.01.2021 (ne procesverbalin e kësaj seance referohet si date shtyrje 29.01.2020 por qe duket qe është lapsus), me qëllim përsëritjen e njoftimit për palën e paditur.
2. **Seanca e datës 29.01.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
3. **Seanca e datës 30.04.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 06.07.2021 (edhe në këtë procesverbal rezulton te jete lapsus data e shtyrjes pasi viti ne procesverbal është 2020) , me qëllim përsëritjen edhe njëherë të njoftimit për palën e paditur.
4. **Seanca e datës 06.07.2021**, në të cilën gjykata bazuar në nenin 133/a të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur njoftimin e palës së paditur me shpallje publike, shkak për të cilin shtyn seancën për në datën 23.11.2021.
5. **Seanca e datës 23.11.2021**, në të cilën gjykata, bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore duke përsëritur njoftimin me shpallje publike për palën e paditur. Seanca gjyqësore u caktua në datë 05.04.2022 (edhe ne këtë procesverbal rezulton te jete lapsus data e shtyrjes pasi viti ne procesverbal është 2021).
6. **Seanca gjyqësore e datës 05.04.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 09.06.2022 me qëllim përsëritjen e njoftimit për palën e paditur.
7. **Seanca e datës 09.06.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
8. **Seanca e datës 27.02.2023**, në të cilën gjykata ka pranuar kërkesën e palës paditëse dhe ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 25.05.2023, me qëllim dhënien kohë palës paditëse për plotësimin e akteve.
9. **Seanca e datës 25.05.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "Gjykata pranon kërkesën e palës paditëse dhe me qëllim që të paraqesë sa më lart shtyn seancën për në datë 30.05.2023".

10. Seanca e datës 30.05.2023, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 10 (dhjetë) seanca nga të cilat për 2 (dy) seanca nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të tyre. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët ndërgjyqëse sikundër është mosmarrja dijeni e palës së paditur apo kërkesat e palës paditëse për shtyrje seance. Kjo çështje rezulton që të jetë marrë në shqyrtim në fillim nga gjyqtare A.C-Z (e cila rezulton të ketë gjykuar këtë çështje deri më datë 05.04.2022 referuar procesverbalit të seancës së zhvilluar po në këtë datë). Më tej konstatohet se seancat e datës 27.02.2023 e në vijim të jenë zhvilluar nga gjyqtare E.B(V). Procesverbali i seancës së datës 09.06.2022 rezulton të jetë bosh. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 5 ditë (seanca 25.05.2023 – 30.05.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 8 muaj e 18 ditë (seanca 09.06.2022 – 27.02.2023).

- **Dy çështje me objekt “pagim shume civile”:**

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 24.01.2022, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 24.01.2022 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

- 1. Seanca e datës 07.04.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “Vendimi i seancës” është bërë shënimi “*veprime paraprake*” ndërsa tek rubrika “Shënim për seancën” konstatohet shënimi “*...padia është e plotë formalisht dhe konform neneve 154, 154/a dhe 158 të K.Pr.Civile urdhëron: - T’i nisen palës së paditur dhe palës së tretë padia dhe provat nëpërmjet dëftesës së komunikimit. – Të paditurit i caktohet afat 30 ditë nga marrja në dorëzim, për të paraqitur Deklaratën e Mbrojtjes dhe provave respektive. - Ngarkohet sekretaria gjyqësore me kryerjen e veprimeve*”.
- 2. Seanca e datës 20.06.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “Shënim për seancën” konstatohet shënimi “*Pala e paditur ka marrë në dorëzim aktet në datë 19.05.2022. Afati i paraqitjes së deklaratës së mbrojtjes përfundon në datë 19.06.2022. Nga ana e palës së paditur është paraqitur deklarata e mbrojtjes nr.4483, datë 15.06.2022, brenda afatit. T’i niset palës paditëse një kopje e deklaratës së mbrojtjes. Në kushtet kur veprimet paraprake janë të plota*

konform nenin 158/b të K.Pr.Civile, të njoftohen palët për seancë përgatitore në datë 09.11.2022 ora 10.00".

- 3. Seanca përgatitore e datës 09.11.2022,** në të cilën gjykata konform nenit 158/c të Kodit të Procedurës Civile, ka urdhëruar kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit në datë 30.03.2023.
- 4. Seanca gjyqësore e datës 30.03.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 05.04.2023, me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim.
- 5. Seanca e datës 05.04.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 24.04.2023, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar, të arsyetuar
- 6. Seanca e datës 24.04.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për rrëzimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 4¹⁰⁷ (katër) seanca. Nga përmbajtja e seancave rezulton se këto të fundit janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër janë kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare etj. Për sa i përket distancës kohore¹⁰⁸ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 6 ditë (seanca 30.03.2023 – 05.04.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 21 ditë (seanca 09.11.2022 – 30.03.2023).

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 26.05.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 26.05.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatesisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

- 1. Seanca e datës 06.07.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Vendimi i seancës" është bërë shënimi "vendim për veprime paraprake" ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" konstatohet shënimi "Vendosi: 1.Njoftimin e kërkesëpadisë dhe të një kopje e provave të paraqitura nga pala paditëse, palëve të paditura. 2.Bashkë me njoftimin të komunikohet dhe kërkesa sipas ligjit, mbi elementët përbërës së deklaratës së mbrojtjes, i vendosur në një format, i cili mund të shërbejë si shembull për t'u plotësuar nga i padituri. 3.Të gjitha provat sipas pikës 1 të këtij vendimi t'i komunikohet palëve të paditura. 4.Palëve të paditur i caktohet në afat 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e nesërme e njoftimit të

¹⁰⁷ Në këtë numër nuk përfshihen dy seancat e para respektivisht të datave 07.04.2022 dhe 20.06.2022.

¹⁰⁸ Në përlogaritjen e distancës kohore me të shkurtër apo më të largët janë përjashtuar dy seancat e para sikundër cituar më sipër.

kërkesëpadisë dhe akteve bashkëlidhur, për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes.
5.Urdhërohet sekretaria gjyqësore për njoftimet sipas këtij vendimi”.

2. **Seanca e datës 10.09.2020**, në të cilën gjykata ka caktuar seancën e parë përgatitore, për në datë 11.11.2020.
3. **Seanca e datës 11.11.2020**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “Shënim për seancën” konstatohet shënimi “*Për sa u vu në diskutim në këtë seancë gjykata duke çmuar se të paditurit nuk kanë dijeni vendos të pranoj kërkesën për të rinjofitur të paditurit kjo në baze të nenit 175 të K.Pr.Civile. Seanca caktohet më datë 03.02.2021 ora 10.00.Pala present dakord.Të njoftohen palët në mungesë”.*
4. **Seanca e datës 03.02.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur gjykimin në mungesë për të paditurën E.N., dhe shtyrjen e seancës për në datë 09.04.2021, për t’i dhënë kohë palës paditëse që të saktësojë adresën e palës së paditur N.N.
5. **Seanca e datës 09.04.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 14.06.2021, për t’i kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, vënien në dispozicion gjykatës të adresës së palës së paditur N.N.
6. **Seanca e datës 14.06.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 22.10.2021, duke e çmuar si të ligjshme kërkesën e përfaqësuesit të palës paditëse për shtyrjen e seancës.
7. **Seanca e datës 22.10.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
8. **Seanca e datës 21.04.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.07.2022, për t’i kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, vënien në dispozicion gjykatës të adresës zyrtare të palës së paditur.
9. **Seanca e datës 19.07.2022**. Bazuar në nenin 175 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse për shtyrje seance duke e çmuar si objektivisht të justifikuar dhe ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 06.12.2022.
10. **Seanca e datës 06.12.0222**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 12.04.2023 me qëllim njoftimin e palës së paditur me shpallje publike.
11. **Seanca e datës 12.04.2023**, në të cilën gjykata, bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit në datë 30.05.2023.
12. **Seanca gjyqësore e datës 30.05.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 11¹⁰⁹ (njëmbëdhjetë) seanca nga të cilat për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të saj. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme të passjella nga palët ndërgjyqëse sikundër është mosmarrja dijeni e palës së paditur apo kërkesat e palës paditëse për shtyrje seance.

¹⁰⁹ Në këtë numër nuk përfshihet seanca e parë e datës 06.07.2020.

Kjo çështje rezulton që të jetë marrë në shqyrtim në fillim nga gjyqtare A.M (i cili rezulton të ketë gjykuar këtë çështje deri më datë 14.06.2021 referuar procesverbalit të seancës së zhvilluar po në këtë datë). Më tej konstatohet se seancat e datës 21.04.2022 e në vijim të jenë zhvilluar nga gjyqtare F.D. Procesverbali i seancës së datës 22.10.2021 rezulton të jetë bosh. Për sa i përket distancës kohore¹¹⁶ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 1 muaj e 19 ditë (seanca 12.04.2023 – 30.05.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 6 muaj e 1 ditë (seanca 22.10.2021 – 21.04.2022).

- Dy çështje me objekt “përmbushje detyrimi tregtar”:

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 13.12.2022, është regjistruar në këtë të fundit në datë 13.12.2022, dhe është shortuar në datë 15.12.2022.

- Me vendimin datë 19.12.2022 “Për veprimet paraprake”, gjykata bazuar në nenin 158 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur: njoftimin e kërkesëpadiës dhe të një kopje të provave të paraqitura nga pala paditëse, palës së paditur; caktimin kësaj të fundit e afatit 30 ditor nga dita e nesërme e njoftimit të kërkesëpadiës, për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes; në rast se i padituri nuk merr dijeni në adresën e dhënë, njoftimin e tij me shpallje në adresën zyrtare; si dhe në rast paraqitje të deklaratës së mbrojtjes nga pala e paditur, lënien 30 ditë kohë nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes, palës paditëse për të kundërshtuar qëndrimin e palës së paditur.
- Me vendimin datë 03.02.2023 “Për caktim seance në dhomë këshillimi”, gjykata ka vendosur caktimin e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi në datë 10.03.2023

Përkatesisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca gjyqësore e datës 10.03.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur të administrojë provat shkresore, të përfundojë hetimin gjyqësor dhe të shpallë vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesëpadiës.

Sa më sipër, konstatohet se gjykata e ka shqyrtuar këtë çështje me gjykim të shkurtuar, referuar nenit 162/a të Kodit të Procedurës Civile.

¹¹⁶ Në përlogaritjen e distancës kohore me të shkurtër apo më të largët është përjashtuar seanca e parë e datës 06.07.2020.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 08.06.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 08.06.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 23.07.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Vendimi i seancës" është bërë shënimi "*veprime paraprake*" ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" konstatohet shënimi "*komunikim aktesh palës së paditur*".
2. **Seanca e datës 17.09.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Vendimi i seancës" është bërë shënimi "*komunikim aktesh*" ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" konstatohet shënimi "*komunikim aktesh*".
3. **Seanca e datës 03.12.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Vendimi i seancës" është bërë shënimi "*veprime paraprake*" ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" konstatohet shënimi "*ripërsëritje njoftimi për palën e paditur*".
4. **Seanca e datës 26.01.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur caktimin e seancës përgatitore më datë 24.03.2021.
5. **Seanca përgatitore e datës 24.03.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës përgatitore në datë 18.05.2021, me qëllim përsëritjen e njoftimit për palën e paditur.
6. **Seanca e datës 18.05.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
7. **Seanca përgatitore e datës 05.10.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.01.2022, duke pranuar dhe çmuar të ligjshme kërkesën e përfaqësuesit të palës paditëse, për shtyrjen e seancës.
8. **Seanca e datës 19.01.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 06.04.2022, me qëllim njoftimin me shpallje publike të palës së paditur për shkak të mosmarrjes dijeni të këtij të fundit.
9. **Seanca e datës 06.04.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit për në datë 05.05.2022.
10. **Seanca gjyqësore e datës 05.05.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore në datë 20.09.2022 me qëllim dhënien kohë ekspertit, për realizimin e aktit të ekspertimit. Në procesverbal relatohet edhe fakti se gjykata ka caktuar datën 30.05.2022, për depozitimin e akt-ekspertimit pranë sekretarisë gjyqësore me qëllim që palët të tërheqin paraprakisht kopjet e tyre pranë sekretarisë gjyqësore, të njihen me të dhe të mbajnë qëndrimin e tyre respektiv.

11. **Seanca gjyqësore e datës 20.09.2022.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit të çështjes në një aktivitet trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu në procesverbal tek rubrika "Shënim për seancën" konstatohet shënim i se "Bashkëngjitur këtij shënimi e-maili ftesë nga Shkolla e Magjistraturës. Me porosi të gjyqtarit seanca gjyqësore shtyhet për më datë 08.11.2022 ora 11:00".
12. **Seanca gjyqësore e datës 08.11.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënim "SHËNIM Seanca gjyqësore e datës 08.11.2022 ora 11:00 për çështjen civile me nr.2232 Akti, nuk do të zhvillohet për arsye se gjyqtar Flamur Kapllani merr pjesë në një vizitë studimore që zhvillohet në Kroaci lidhur me sistemin elektronik të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore, organizuar me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian ndaj Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (Ministria e Drejtësisë). Bashkëngjitur këtij shënimi: E-maili ftesë dhe të dhënat e biletës së fluturimit. Me porosi të gjyqtarit, seanca gjyqësore shtyhet për më datë 01.02.2023 ora 10:30. Palët ndërgjyqëse prezant marrin dijeni. Palët ndërgjyqëse në mungesë do të njoftohen me fletëthirrje".
13. **Seanca gjyqësore e datës 01.02.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e përfaqësuesit të palës paditëse, për shtyrje seance për arsye shëndetësore duke e çmuar atë si të ligjshme, dhe caktuar seancën e radhës në datë 04.04.2023.
14. **Seanca gjyqësore e datës 04.04.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e përfaqësuesit të palës paditëse për t'i dhënë kohë që të paraqesë pretendimet përfundimtare me shkrim, shkak për të cilin shtyn seancën gjyqësore në datë 11.04.2023.
15. **Seanca gjyqësore e datës 11.04.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 02.05.2023, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar të arsyetuar.
16. **Seanca e datës 02.05.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për rrëzimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 13¹¹¹ (njëmbëdhjetë) seanca nga të cilat për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të saj. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme të pasjella nga palët ndërgjyqëse sikundër është mosmarrja dijeni e palës së paditur apo kërkesat e palës paditëse për shtyrje seance. Kjo çështje rezulton që të jetë marrë në shqyrtim në fillim nga gjyqtare A.H (e cila rezulton të ketë gjykuar këtë çështje deri më datë 24.03.2021 referuar procesverbalit të seancës së zhvilluar po në këtë datë). Më tej konstatohet se seancat e datës 05.10.2021 e në vijim të jenë zhvilluar nga gjyqtar F.K. Procesverbali i seancës së

¹¹¹ Në këtë numër nuk përfshihen 3 seancat e para, respektivisht e datave 23.07.2020, 17.09.2020 dhe 03.12.2020.

datës 18.05.2021 rezulton të jetë bosh. Për sa i përket distancës kohore¹¹² ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 7 ditë (seanca 04.04.2023 – 11.04.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 17 ditë (seanca 18.05.2021 – 05.10.2021).

- Dy çështje me objekt “tregtare të tjera”:

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 07.02.2022, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 07.02.2022 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 18.02.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “Shënim për seancën” konstatohet shënimi “*Në kuadër të veprimeve paraprake, gjykata në datë 18.02.2022 ka vendosur ti dërgojë palës së paditur “Njoftim për lëshimin e deklaratës së mbrojtjes, kopje të padisë, si dhe provat shkresore të depozituara nga pala paditëse”.*
2. **Seanca e datës 02.02.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit në datë 25.05.2023.
3. **Seanca gjyqësore e datës 25.05.2023.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “Shënim për seancën” konstatohet shënimi “*Gjykata u tërhoq për vendim dhe si u kthye vendosi: 1.Rrëzimin e padisë, si e pabazuar në prova dhe në ligj.2.Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse”.*

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 2¹¹³ (dy) seanca. Nga përmbajtja e seancave rezulton se ka patur vetëm një rast shtyrje seance për shkaqe procedurale. Në seancën e parë gjyqësore, ka përfunduar hetimi gjyqësor dhe gjykata ka shpallur po në këtë seancë, vendimin përfundimtar për çështjen.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë

¹¹² Në përilogaritjen e distancës kohore me të shkurtër apo më të largët janë përjashtuar 3 seancat e para, respektivisht e datave 23.07.2020, 17.09.2020 dhe 03.12.2020.

¹¹³ Në këtë numër nuk përfshihen 3 seancat e para, respektivisht e datave 23.07.2020, 17.09.2020 dhe 03.12.2020.

13.11.2017, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 13.11.2017 dhe nuk ka të dhëna për datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca përgatitore e datës 30.01.2018**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 06.02.2018, me qëllim që palët të njihen me provat.
2. **Seanca e datës 06.02.2018**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 13.02.2018 (në sistem referon vitin 2017 por që deduktohet që është lapsus), për t'i lënë kohë palës së paditur që të plotësojë aktin e përfaqësimit.
3. **Seanca e datës 13.02.2018**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Vendim Gjykata vendos të pranojë për shqyrtim kundërpadinë. Gjykata vendosi 1.Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë të ngritur nga paditësat E.T dhe S.L.L.2.Kundër vendimit ligji nuk parashikon ankim. Gjykata vendosi 1.Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë të ngritur nga i padituri kundërpaditës shoqëria "E." sh.p.k. 2. Kundër vendimit ligji nuk parashikon ankim.Vazhdimin e veprimeve bazuar në procedurën e re".
4. **Seanca e datës 07.05.2018**. Kjo seancë nuk u zhvillua pasi gjyqtarja E.C, është me raport mjekësor. Në procesverbal relatohet fakti se palët do të njoftohen me fletëthirrje për seancën e ardhshme.
5. **Seanca e datës 18.06.2018**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Gjykata duke e çmuar sit ë drejtë dhe të ligjshme kërkesën e palës së paditur kundërpaditëse shtyn seancën për në datë 17.07.2018..."
6. **Seanca gjyqësore e datës 17.07.2018**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të mos formimit të trupit gjykues, pasi gjyqtare M.O (N.) është me raport mjekësor.
7. **Seanca e datës 01.10.2018**. Në këtë seancë gjykata pasi u njoh me pretendimet dhe prapësimet e palëve si dhe kërkesat e tyre ka vendosur t'i drejtohet Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për të marrë dokumentacionin e plotë të gjithë kontratave që kanë sjellë tjetërsimin e pasurisë objekt mosmarrëveshjeje si dhe t'u drejtohet dy noterëve për të marrë kontratat e porosisë dhe shitjes që ato disponojnë lidhur me shitjen e këtyre pasurive. Me qëllim marrjen e këtij dokumentacioni gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 06.11.2018.
8. **Seanca e datës 06.11.2018**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik në rubrikën "vendimi i seancës" është bërë shënimi "shtyhet për tu lënë kohë palëve të paraqesin prova" ndërkohë në rubrikën "shënim për seancën" relatohet përkatësisht se "Vendim: Gjykata me qëllim lënien kohë palëve të identifikojnë numrat e kontratave shtyn seancën për në datë 13.12.2018".
9. **Seanca e datës 13.12.2018**. Kjo seancë nuk u zhvillua pasi gjyqtarja ndodhet me raport mjekësor. Në procesverbal relatohet se palët do të njoftohen me fletëthirrje për seancën e radhës.

10. **Seanca e datës 11.02.2019.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja ndodhet në seminar. Në procesvebrat relatohet fakti se palët janë njoftuar paraprakisht për seancën e radhës.
11. **Seanca gjyqësore e datës 20.02.2019.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet "Gjykata pranon kërkesën për tju drejtuar me shkresë sekretariatit Teknik të Këshillit të Territorit në lidhje me ndërtimin e sendit objekt gjykimi. Sa më sipër, gjykata shtyn seancën gjyqësore për në datën 08.04.2019 .. " .
12. **Seanca e datës 08.04.2019.** Kjo seancë nuk u zhvillua për arsye mosformimi trupit gjykues, pasi një prej anëtarëve të saj, gjyqtare R.P, ndodhet në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Për këtë arsye, seanca është shtyrë për në datë 22.05.2019.
13. **Seanca e datës 22.05.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për marrje prove. Seanca është shtyrë për në datë 02.07.2019.
14. **Seanca e datës 02.07.2019.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak mosformim trupit gjykues pasi anëtarja e trupit gjykues, gjyqtare M.N është me leje vjetore. Për këtë arsye, gjykata ka caktuar seancën e ardhshme për më datë 25.09.2019.
15. **Seanca e datës 25.09.2019.** Në këtë seancë, pala e paditur ka paraqitur kërkesë për shtyrje të cilën gjykata e ka çmuar si të ligjshme e të justifikuar për sa kohë që kërkesës i është bashkëlidhur akti (fletëthirrja e gjykimit tjetër) mbi të cilën mbështetet kjo kërkesë. Për këtë arsye, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 18.11.2019 dhe njoftimin e palës së paditur.
16. **Seanca gjyqësore e datës 18.11.2019,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për të përsëritur njoftimin për palën e paditur/kundërpaditëse, ekspertët si dhe për t'u njohur anëtarja e re e trupit gjykues me çështjen kjo, me qëllim për të parë mundësinë e ndërlidhjes së çështjeve midis tyre dhe nëse është rasti që mund të marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështje. Për shkak të ngarkesës së gjykatës, festave të fundvitit, procesit administrativ të mbartjes së dosjeve në muajin janar, gjykata ka vendosur që seanca e ardhshme të zhvillohet më datë 29.01.2020.
17. **Seanca gjyqësore e datës 29.01.2020,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për t'i dhënë kohë ekspertëve për të përgatitur dhe paraqitur aktin e ekspertimit. Seanca e ardhshme do të zhvillohet për në datë 06.04.2020.
18. **Seanca e datës 06.04.2020.** Procesverbali i kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
19. **Seanca e datës 19.10.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "shtyhet". Ndërkohë që në rubrikën "shënim për seancën" të këtij procesverbali referohet vetëm caktimi i seancës së ardhshme për në datë 17.12.2020 dhe njoftimi i palëve të tjera jo të pranishme.
20. **Seanca e datës 17.12.2020.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar në sistemin elektronik, tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "shtyn seancën". Ndërsa në rubrikën "shënim për seancën" të këtij procesverbali relatohet se "Seanca e datës 17.12.2020, ora 12.30 min e çështjes civile nr. 579 Akti, nuk u zhvillua për shkak të mungesës së gjyqtarës me leje të Kryetarit të Gjykatës, e cila u zhvillua në prezencë të gjyqtarës A.K. Seanca e radhës do të zhvillohet në datë 08.02.2021".

21. **Seanca e datës 08.02.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar në sistemin elektronik , tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënim "Gjykata shtyn seancën për në datë 21.04.2021 ora 11.30, kalendari i gjykimit, do të zhvillohet seanca e ardhshme datë 28.04.2021 ora 10.00, datë 19.05.2021 ora 10.00. Të njoftohen S.LI dhe V. GJ", por nuk specifikohet shkaku i shtyrjes.
22. **Seanca e datës 21.04.2021.** Kjo seancë nuk u zhvillua për mungesë të gjyqtarës A.K për arsye shëndetësore (me raport mjekësor). Seanca e radhës është caktuar për në datë 28.04.2021.
23. **Seanca e datës 28.04.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 19.05.2021, me qëllim njoftimin e ekspertit për t'u paraqitur në gjykatë dhe për të marrë detyrat e caktuara nga gjykata.
24. **Seanca e datës 19.05.2021.** Referuar procesverbalit të seancës së gjeneruar nga sistemi elektronik , tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënim "Gjykata vendim: Gjykata ndodhur në këto kushte, me qëllim që të jetë prezent edhe gjyqtare A.K, vendos të shtyjë seancën për në datë 10.06.2021 ora 14.30 min dhe seanca tjetër më datë 28.06.2021, ora 12.00".
25. **Seanca e datës 10.06.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 28.06.2021, me qëllim që ekspertët të përgatisin aktet e ekspertimit.
26. **Seanca e datës 28.06.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës me qëllim për t'i dhënë mundësi palës së paditur kundërpaditëse që të paraqesë qëndrimin e saj në lidhje me kërkesën për shtimin e objektit të padisë dhe ndërgjyqësisë si dhe për t'i dhënë mundësi ekspertëve për të përgatitur aktin e ekspertimit. Seanca është caktuar për në datë 24.09.2021.
27. **Seanca e datës 24.09.2021.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të mosformimit të trupit gjykues dhe konkretisht për mungesë të gjyqtarës A.K, për arsye shëndetësore dhe me leje të kryetarit të gjykatës. Ndër të tjerash, në procesverbal relatohet se në prezencë të anëtarit të trupit gjykues E.P, ekspertët kanë dorëzuar aktin e ekspertimit në mënyrë që palët ndërgjyqëse të njihen paraprakisht me të. Seanca e radhës është caktuar për në datë 10.11.2021.
28. **Seanca e datës 10.11.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën", konstatohet shënim "Vendos: 1. Rrëzimin e kërkesës. 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankam së bashku me vendimin përfundimtar. Vendim: Gjykata me qëllim dhënien kohë ekspertëve të përgatisin pyetjet shuesë, vendos të shtyjë seancën për në datë 07.03.2022, ora 12.00".
29. **Seanca e datës 07.03.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik rezulton se kjo seancë është shtyrë por pa specifikuar shkaku specifik të shtyrjes. Përkatësisht në rubrikën "shënim për seancën" të këtij procesverbali është bërë shënim "Vendim: Gjykata me qëllim kryerjen e veprimeve të mësipërme procedural vendos të shtyjë seancën për në datë 17.05.2022 ora 14:15 min".
30. **Seanca e datës 17.05.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur që bazuar në nenet 125, 183, 207 dhe 209 të Kodit të Procedurës Civile të mos e pranojë kërkesën e palës së paditur kundërpaditëse V.GJ, për heqje të masës së sigurimit të padisë. Ndër të tjerash, gjykata ka vendosur që të shtyjë seancën për në datë 05.07.2022, me qëllim dhënien

kohë palës së paditur kundërpaditëse që të paraqesë prova në dobi të gjykimit dhe ekspertit që të përgatisë aktin e ekspertimit.

31. **Seanca e datës 05.07.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 07.11.2022, për mungesë të palëve ndërgjyqëse, për shkak të vendimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë për bojkotimin e seancave gjyqësore.
32. **Seanca e datës 07.11.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 14.02.2023, për t'u dhënë kohë ekspertëve që t'u përgjigjen pyetjeve shtesë të paraqitura nga pala e paditur.
33. **Seanca e datës 14.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 23.02.2023 me qëllim dhënien kohë palëve ndërgjyqëse për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim.
34. **Seanca e datës 23.02.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se gjykata bazuar në nenin 125, 308 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, për në datë 15.03.2023.
35. **Seanca e datës 15.03.2023**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të mosformimit të trupit gjykues, pasi gjyqtare A.K është me raport mjekësor. Seanca e radhës u caktua për në datë 29.03.2023.
36. **Seanca e datës 29.03.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance.
37. **Seanca e datës 12.04.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 24.04.2023, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar.
38. **Seanca e datës 24.04.2023**, në të cilën gjykata rezulton të ketë shtyrë sërish seancën për shpalljen e vendimit përfundimtar më datë 04.05.2023.
39. **Seanca e datës 04.05.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e pjesëshëm të padisë së paditësve të kundërpaditur E.T. dhe S.L.L etj.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 39 (tridhjetë e nëntë) seanca nga të cilat 10 (dhjetë) nuk rezultojnë të jenë zhvilluar dhe për 2 (dy) seanca nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të tyre. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të pasjella nga kërkesat e ndryshme të palëve, veprimet procedurale që lidhen me ekspertë ose akt ekspertimin si dhe mosformim trupi gjykues. Gjithashtu evidentohet fakti se 3 seanca (seancat e datës 23.02.2023; 12.04.2023; 24.04.2023) janë shtyrë për shkakun e "shpalljes së vendimit përfundimtar". Kjo çështje rezulton të ketë pasur disa ndryshime në përbërjen e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 7 ditë (seanca 06.02.2018 – 13.02.2018) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 2 ditë (seanca 05.07.2022 – 07.11.2022).

- **Dy çështje me objekt “ pavlefshmëri titulli ekzekutiv”:**

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 18.07.2022, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 18.07.2022, dhe nuk ka të dhëna për datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 13.12.2022**, në të cilën gjykata bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit në datë 16.02.2023.
2. **Seanca gjyqësore e datës 16.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 23.02.2023, për t'i dhënë mundësi palëve ndërgjyqëse të paraqesin pretendimet përfundimtare me shkrim.
3. **Seanca e datës 23.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 10.03.2023 me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar, të arsyetuar.
4. **Seanca e datës 10.03.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 4 (katër) seanca. Nga përmbajtja e seancave rezulton se seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër është kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhënia kohë palëve ndërgjyqëse për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare etj. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 8 ditë (seanca 16.02.2023 – 23.02.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 2 muaj e 3 ditë (seanca 13.12.2022 – 16.02.2023).

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 18.09.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 18.09.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 28.09.2020**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika “vendimi i seancës” është bërë shënimi “*palës paditëse i lihet afat për të metat*” ndërsa tek rubrika “shënim për seancën” konstatohet shënimi “*1.Rrëzimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv kontratën e kredisë bankare datë 19.11.2009*”

lëshuar me vendimin nr.4239 datë 30.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe për pezullimin e veprimeve përmbareme në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit për titullin ekzekutiv kontratën e kredisë bankare datë 19.11.2009 lëshuar me vendimin nr. 4239 datë 20.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 2.Kundër vendimit lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Pala paditëse deri më 05.10.2020 të sjellë më shkrim cilat janë kërkimet në kuptim të nenit 609 dhe në kuptim të nenit 610 si dhe të paguajë taksën gjyqësore."

2. **Seanca e datës 05.10.2020** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik , tek rubrika "vendimi i seancës" është bërë shënimi " vijohet me veprimet paraprake" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Pala paditëse deri më 05.10.2020 të sjellë më shkrim cilat janë kërkimet në kuptim të nenit 609 dhe në kuptim të nenit 610 si dhe të paguajë taksën gjyqësore. Pas sjelljes së kërkesës nga ana e palës paditëse, gjykata urdhëroi vijimin e veprimeve paraprake duke i lënë afat palëve të paditura për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes*
3. **Seanca e datës 12.02.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Shënim i sekretarisë i mbajtur prej sekretares gjyqësore M.A. sot më datë 12.02.2021 ora 10:00 lidhur me çështjen nr.6326 akti me palë paditëse D.Z dhe të paditur "C" sh.p.k., Seanca e sotme nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja është me raport mjekësor". (procesverbali referon një numër çështje tjetër gjë që mund të jetë lapsus, por që gjithsesi i kemi qëndruar strikt përmbajtjes).*
4. **Seanca përgatitore e datës 21.04.2021,** në të cilën gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën për pakësim objekti të parashtruar nga pala paditëse duke disponuar me vendim për pranimin e saj dhe pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin objekt kërkesë për pakësim. Ndër të tjerash, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes në lidhje me palën e paditur shoqërinë përmbareme "C." sh.p.k dhe thirrjen e saj si person të tretë. Me qëllim njoftimin e shoqërisë përmbareme "C.", për cilësinë e re procedurale në këtë gjykim si dhe lënien e detyrave ekspertës, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës përgatitore për në datë 14.06.2021.
5. **Seanca përgatitore e datës 14.06.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi " lënie afat për tu përgatitur akti i ekspertimit" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*Gjykata palët pasi të marrin aktin e ekspertimit në seancën e radhës do i drejtojnë pyetje ekspertës nëse kanë dhe do diskutojnë rreth aktit. Seanca përgatitore e radhës do të zhvillohet më datë 26.07.2021 ora 09:30".*
6. **Seanca përgatitore e datës 26.07.2021,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 15.10.2021, me qëllim dhënien sërish kohë ekspertës që të dorëzojë aktin e ekspertimit deri më datë 07.09.2021.
7. **Seanca e 15.10.2021.** Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*shtyhet seanca*" ndërsa tek rubrika "shënim për seancën" është bërë shënimi "*Gjykata*

caktohet seanca në datë 26.10.2021 ora 15.30. Të njoftohet personi i tretë dhe ekspertja. Seanca deklarohet e mbyllur". (nuk evidentohet shkaku i shtyrjes).

8. **Seanca e datës 26.10.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 22.12.2021, me qëllim dhënien kohë ekspertës që të përgatisë dhe depozitojë akt ekspertimin deri në datë 01.12.2021 dhe dhënien kohë palëve që të njihen me akt -ekspertimin.
9. **Seanca përgatitore e datës 22.12.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Gjykata do të komunikojë me ekspertin të sjellë aktin dhe do t'jua vëmë në dispozicion përpara seancës, do të bëjë një seancë tjetër përgatitore e cila do të jetë në datë 09.02.2022."*
10. **Seanca e datës 09.02.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Gjykata seanca e radhës do të jetë në datë 25.03.2022 ora 09.00. Palët prezent morën dijeni. Të njoftohet ekspertja A.O, të ciles do i bëhet me dije që në qoftë se e kryen aktin e ekspertimit, ta depozitojë para seancës"*.
11. **Seanca përgatitore e datës 25.03.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Shënim i sekretarisë i mbajtur prej sekretares gjyqësore L.M, sot më datë 25.03.2022 ora 09:00, lidhur me çështjen me nr.2774 akti, me palë paditëse Hasan Zeka. Seanca e sotme përgatitore nuk u zhvillua pasi gjyqtarja është me leje. Seanca e ardhshme do të zhvillohet më datë 22.04.2022"*.
12. **Seanca përgatitore e datës 22.04.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Të shtyj seancën për shkak të mosparaqitjes së njëres palë paditëse dhe avokatit të palëve paditëse. Palët të njihen me aktin e ekspertimit dhe të mbajnë qëndrim rreth saj, nëse kanë pyetje për ekspertin do diskutohen në seancën e ardhshme. Seanca e ardhshme përgatitore caktohet më datë 18.05.2022 ora 13:00. Paditësi J. dhe avokati i paditësve të njoftohen nga paditësit që janë prezent"*.
13. **Seanca përgatitore e datës 18.05.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Gjykata pala e paditur të depozitojë këtë provë në kopje për palët dhe do i jepet ekspertës . Pala paditëse të sjellë kërkesën për saktësim objekti të padisë dhe çështja do të kalojë në seancë gjyqësore. Seanca gjyqësore do të zhvillohet në datë 21.09.2022 ora 13:30. Ekspertja do të depozitojë shtesën e aktit përpara seancës së ardhshme"*.
14. **Seanca gjyqësore e datës 21.09.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 27.10.2022 me qëllim dhënien kohë ekspertës që të depozitojë shtesë akt-ekspertimin.
15. **Seanca përgatitore e datës 27.10.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi *"Gjykata vendos të shtyjë seancën përgatitore në datë 18.11.2022 ora 13.30. Të njoftohet ekspertja A.O. Seanca deklarohet e mbyllur"*.

16. **Seanca gjyqësore¹¹⁴ e datës 18.11.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 24.01.2023, për t'i dhënë mundësi palëve që të njihen me akt-ekspertimin.
17. **Seanca gjyqësore e datës 24.01.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 13.02.2023, me qëllim komunikimin, personit të tretë, të vendimit të gjykatës për pranimin e kërkesës për saktësim të objektit të padisë.
18. **Seanca e datës 13.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 06.03.2023, me qëllim shpalljen e arsytuar të vendimit.
19. **Seanca e datës 06.03.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 17¹¹⁵ (shtatëmbëdhjetë) seanca nga të cilat 2 (dy) nuk rezultojnë të jenë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për efekt të veprimeve procedurale që lidhen me ekspertë dhe/ose akt ekspertimin. Për sa i përket distancës kohore¹¹⁶ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 11 ditë (seanca 15.10.2021 – 26.10.2021) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 3 ditë (seanca 18.05.2022 – 21.09.2022).

- Dy çështje me objekt “civile të tjera dhe ekstra”:

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesa është paraqitur në gjykatë në datë 23.03.2023, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 23.03.2023 dhe është shortuar në datë 24.03.2023 (referuar tabelës me të dhënat statistikore). Kërkesa ka për objekt gjykimi: *“Marrjen e masës së sigurimit të padisë për pezullimin e të gjitha procedurave përmbartimore, të Përmbartuesit Gjyqësor Privat F.A., për sa i përket urdhrit për “vënien e sekuestros konservative” me Nr., datë 11.04.2022”*.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 28.03.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimet e kësaj seance. Ndërkaq, referuar vendimit të shpallur për këtë çështje, i gjeneruar nga sistemi elektronik rezulton se gjykata e ka marrë në shqyrtim këtë

¹¹⁴ Referuar procesverbalit të kësaj seance, kjo e fundit cilësohet si gjyqësore.

¹¹⁵ Në këtë numër nuk përfshihen dy seancat e para përkatësisht e datës 28.09.2020 dhe 05.10.2020.

¹¹⁶ Në përlogaritjen e distancës kohore me të shkurtër apo më të largët janë përjashtuar dy seancat e para përkatësisht e datës 28.09.2020 dhe 05.10.2020.

kërkesë civile në datë 28.03.2023, në përfundim të shqyrtimit të së cilës ka shpallur vendimin për rrëzimin e kërkesës për pezullimin e veprimeve përmbare.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 22.04.2022, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 22.04.2022 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatesisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 13.05.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "shtyhet për plotësimin e të metave", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "Gjykata në bazë të nenit 154/a/3 dhe 176 të K.pr Civile, i të kohë palës paditëse për të paraqitur ekstraktin e QKB-së për palën e paditur dhe për këtë shkak cakton seancën përgatitore në datën 19.05.2022 ora 10.30. Palët morën dijeni".
2. **Seanca e datës 19.05.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "shtyhet për deklaratën e mbrojtjes", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "Vendim: Gjykata në bazë të nenit 202 e vijues të K.Pr.Civile vendosi të rrëzojë kërkesën e palës paditëse për sigurim padie, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata pyet palën e paditur nëse e ka Deklaratën e Mbrojtjes për këtë seancë? Përfaqësuesi i palës së paditur tha: Jo nuk e kemi kërkojmë kohë që ta depozitojmë sipas ligjit. Vendim: Gjykata bazuar në nenin 158 të K.Pr.Civile vendosi ti lërë kohë palës së paditur 20 ditë për Deklaratën e Mbrojtjes deri në datë 09.06.2022. Palët morën dijeni". (
3. **Seanca e datës 02.06.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "veprim paraprak", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "1.Njoftimin e deklaratës së mbrojtjes dhe provave bashkëlidhur, të paraqitur nga nga pala e paditur, palës paditëse. 2.Palës paditëse t'i lihet 20 ditë kohë nga dita e nesërme e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes (prapësimeve) dhe akteve bashkëlidhur për të kundërshtuar qëndrimin e palës së paditur. 3.Urdhërohet sekretaria gjyqësore për njoftimet sipas këtij vendimi".
4. **Seanca e datës 01.07.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "kalon në seancë përgatitore", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "1.Caktimin e datës 28.09.2022, ora 10.00, për zhvillimin e seancës përgatitore. 2.Urdhërohet sekretaria gjyqësore për njoftimin e palëve sipas këtij vendimi.3.Një kopje e prapësimeve të palës paditëse t'i dërgohet palës së paditur".

5. **Seanca e datës 28.09.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 154 /a të K.Pr.Civile, i lë afat palës paditëse për plotësimin e të metave të konstatuara, lidhur me pagesën e tarifës gjyqësore në lidhje me pikën 4 të objektivit të kërimit dhe cakton seancën përgatitore në datën 06.10.2022 ora 13.00. Palët morën dijeni*".
6. **Seanca e datës 06.10.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 154 /a të K.Pr.Civile, i lë afat palës paditëse për plotësimin e të metave të konstatuara, lidhur me pagesën e tarifës gjyqësore në lidhje me pikën 4 të objektivit të kërimit deri më datë 07.10.2022. Pala paditëse prezent mori dijeni. Të njoftohet pala e paditur*".
7. **Seanca e datës 28.10.2022,** në të cilën gjykata, bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore duke e caktuar këtë të fundit në datë 13.12.2022.
8. **Seanca gjyqësore e datës 13.12.2022,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore me qëllim dhënien mundësi palëve për të paraqitur provat në formën e kërkuar nga ligji.
9. **Seanca gjyqësore e datës 15.02.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datë 20.02.2023, për t'i dhënë mundësi palëve ndërgjyqëse, që të paraqesin pretendimet përfundimtare me shkrim.
10. **Seanca e datës 20.02.2023,** në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 08.03.2023, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar të arsyetuar.
11. **Seanca e datës 08.03.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 9¹¹⁷ (nëntë) seanca. Nga përmbajtja e seancave rezulton se këto të fundit janë shtyrë për shkaqe procedurale të ndryshme sikundër është kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhënie mundësi palëve ndërgjyqëse për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim, shpallja e vendimit përfundimtar të arsyetuar etj. Për sa i përket distancës kohore¹¹⁸ ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 5 ditë (seanca 15.02.2023 – 20.02.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 2 muaj e 27 ditë (seanca 01.07.2022 – 28.09.2022).

¹¹⁷ Në këtë numër nuk përfshihen tre seancat e para përkatësisht e datës 13.05.2022, 19.05.2022 dhe 02.06.2022.

¹¹⁸ Në përllogaritjen e distancës kohore me të shkurtër apo më të largët janë përjashtuar tre seancat e para përkatësisht e datës 13.05.2022, 19.05.2022 dhe 02.06.2022.

- **Dy çështje me objekt "lëshim urdhër mbrojtje":**

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Kërkesë padia është regjistruar në gjykatë në datë 30.04.2023.

Me vendimin datë 30.04.2023 "Për caktimin e seancës gjyqësore", gjykata ka vendosur caktimin e seancës gjyqësore për në datë 01.05.2023.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara nga dosja fizike rezulton:

1. **Seanca gjyqësore e datës 01.05.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur gjykimin e çështjes në mungesë të palëve për sa kohë që këto të fundit kanë dijeni për datën e kësaj seance dhe nuk kanë paraqitur arsye për mungesën e tyre. Gjykata administroi provat e paraqitura nga komisarati i policisë nr.1 dhe mbylli shqyrtimin gjyqësor duke shpallur vendimin për refuzimin e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes për paditësen.

Për këtë çështje konstatohet se është caktuar një seancë përkatësisht ajo gjyqësore. Nga përmbajtja e kësaj seance rezulton që të jetë përfunduar shqyrtimi gjyqësor i çështjes duke shpallur gjykata po në këtë seancë vendimin e sipërcituar.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 24.04.2023, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 24.04.2023 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 09.05.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 31.05.2023, me qëllim njoftimin e palës paditëse me shpallje publike.
2. **Seanca e datës 31.05.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimet e kësaj seance. *(Ndërkaq, referuar vendimit të shpallur për këtë çështje, i gjeneruar nga sistemi elektronik rezulton se gjykata në këtë seancë ka shpallur vendimin për pranimin e gjyqimit të çështjes).*

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 2 seanca. Nga përmbajtja e këtyre seancave (por edhe vendimit të shpallur për këtë çështje i disponuar nga sistemi elektronik), rezulton se ka patur vetëm një rast shtyrje seance për shkak të

mosmarrjes dijeni të palës paditëse dhe njoftimit të kësaj të fundit me shpallje publike. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave evidentohet fakti se seancat janë zhvilluar në një distancë kohore prej 22 ditë.

- Dy çështje me objekt: "Lëshim urdhër i menjëhershëm mbrojtje":

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Kërkesë padia është regjistruar në gjykatë në datë 12.04.2023.

- Me urdhrin datë 12.04.2023 "Për caktimin e seancës", gjykata relacionon faktin se dosja gjyqësore i është dorëzuar sekretares së këtij trupi gjykues në datë 13.04.2023. Referuar nenit 18/1 të ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar, gjykata ka caktuar datën 13.04.2023, për zhvillimin e seancës gjyqësore.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara nga dosja fizike rezulton:

1. **Seanca gjyqësore e datës 12.04.2023**, në të cilën gjykata ka verifikuar prezencën e palëve dhe ka vendosur gjykimin e çështjes në mungesë të palës së paditur. Ndër të tjerash, gjykata administroi provat e paraqitura nga komisariati i policisë nr.1 dhe mbylli shqyrtimin gjyqësor duke shpallur vendimin për rrëzimin e kërkesëpadisë.
Për këtë çështje konstatohet se është caktuar një seancë përkatësisht ajo gjyqësore. Nga përmbajtja e kësaj seance rezulton që të jetë përfunduar shqyrtimi gjyqësor i çështjes duke shpallur gjykata po në këtë seancë vendimin e sipërcituar.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesë padia është paraqitur në gjykatë në datë 15.03.2022, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 15.03.2022 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 16.03.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi: "*Vendim: Gjykata ndërpret seancën për ti dhënë mundësi palës së paditur të paraqesë kërkesën për përjashtim*", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendim: Gjykata ndërpret seancën për ti dhënë mundësi palës së paditur të paraqesë kërkesën për përjashtim të trupit gjykues*".
Shënim: Gjykata ka disponuar me vendimin datë 25.03.2022 për rrëzimin e kërkesës datë regj.18.03.2022 për përjashtim të gjyqtarit.

2. **Seanca e datës 01.04.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi: "*Vendim: Gjykata ndërpret seancën për ti dhënë mundësi palës së paditur të paraqesë kërkesën për përjashtim*", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendim: Gjykata ndërpret seancën për ti dhënë mundësi palës së paditur të paraqesë kërkesën për përjashtim të trupit gjykues*".
Shënim: Gjykata ka disponuar me vendimin datë 20.04.2022 për rrëzimin e kërkesës datë regj. 05.04.2022 për përjashtim të gjyqtarit.
3. **Seanca e datës 22.04.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*Vendim: Gjykata vendosi të ndërpresë shqyrtimin e gjykimit për ti dhënë mundësi shqyrtimit të kërkesës*", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendim: Gjykata vendosi të ndërpresë shqyrtimin e gjykimit për ti dhënë mundësi shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues*".
Shënim: Gjykata ka disponuar me vendimin datë 10.05.2022 për rrëzimin e kërkesës datë regj. 22.04.2022 për përjashtim të gjyqtarit si dhe ka gjobitur kërkuesin në masën 40.000 lekë.
4. **Seanca e datës 12.05.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*Vendim: Gjykata ndërpret seancën për të paraqitur pala e paditur kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit*", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendim: Gjykata ndërpret seancën për të paraqitur pala e paditur kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit konform ligjit*".
Shënim: Gjykata ka disponuar me vendimin datë 30.06.2022 për shpalljen e papranueshme të kërkesës datë regj. 17.05.2022 për përjashtim të gjyqtarit si dhe ka gjobitur kërkuesin në masën 40.000 lekë.
5. **Seanca e datës 08.07.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*Vendim: Gjykata nuk mund të vazhdojë gjykimin pasi i takon një tjetër trup gjykues nëse është konform*", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendim: Gjykata nuk mund të vazhdojë gjykimin pasi i takon një tjetër trup gjykues nëse është konform ligjit kërkesa e palës së paditur*".
Shënim: Gjykata ka disponuar me vendimin datë 21.07.2022 për rrëzimin e kërkesës datë regj. 08.07.2022 për përjashtim të gjyqtarit si dhe ka gjobitur kërkuesin në masën 40.000 lekë.
6. **Seanca gjyqësore e datës 25.07.2022.** Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të mungesës së gjyqtarës për arsye familjare (vdekjes së babait të saj). Në procesverbal relatohet gjithashtu se seanca e ardhshme do të zhvillohet më datë 04.08.2022.
7. **Seanca e datës 04.08.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika "Vendimi i seancës" konstatohet shënimi "*Vendim: Gjykata e ndërpret seancën përsëri në kushtet kur i padituri kërkon të mosgjykohej*", ndërsa tek rubrika "Shënim për seancën" është bërë shënimi "*Vendim: gjykata e ndërpret seancën përsëri në kushtet kur i padituri kërkon të mosgjykohej nga*

ky trup gjykues dhe shtyhet seanca gjyqësore në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa e palës së paditur për përjashtim”.

Shënim: Gjykata ka disponuar me vendimin datë 17.11.2022 për mospranimin e kërkesës datë regj. 09.08.2022 për përjashtim të gjyqtarit si dhe ka gjobitur kërkuuesin në masën 50.000 lekë.

8. **Seanca e datës 23.11.2022.** Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik tek rubrika “Shënim për seancën” është bërë shënim: “Gjykata është në pamundësi për të vijuar më tej në kushtet kur bazuar në nenin 73 të K.Pr.Civile do të shqyrtohet nga një trup tjetër gjykues”.

Shënim: Gjykata ka disponuar me vendimin datë 20.03.2023 për rrëzimin e kërkesës datë regj. 23.11.2022 për përjashtim të gjyqtarit.

9. **Seanca e datës 04.04.2023,** në të cilën gjykata ka shpallur vendimin për pushimin e gjykimit të çështjes, si një padi që nuk mund të vazhdojë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 9 (nëntë) seanca nga të cilat 1 (një) seancë rezulton të mos jetë zhvilluar. Gjithashtu rezulton se e njëjta palë ka paraqitur 7 kërkesa për përjashtim. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët sikundër është mosparaqitja e kërkesës së palës së paditur për përjashtim të trupit gjykues si dhe shqyrtimi i kërkesës për përjashtim nga gjykata. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 10 ditë (seanca 25.07.2022 – 04.08.2022) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 12 ditë (seanca 23.11.2022 – 04.04.2023).

Nga çështjet me objekt “familjare të tjera” rezulton:

- Dy çështje me objekt: “Padi për kundërshtimin e atësisë”

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Kërkesë padia është regjistruar në gjykatë në datë 27.09.2022.

- Me vendimin datë 10.10.2023 “Për veprimet paraprake”, gjykata ka çmuar se kërkesëpadia e paraqitur është pa të meta, sipas neneve 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim, gjykata bazuar në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur njoftimin e kërkesë padisë dhe të një kopje të provave të paraqitura nga pala paditëse, palës së paditur, caktimin palës së paditur e një afati 20 ditor për të mbajtur qëndrimin me shkrim ndaj kërkesë padisë dhe paraqitjen e provave nga ana e saj (nëse ka) si dhe caktimin e datës 27.12.2023, për zhvillimin e seancës së veprimeve paraprake për marrjen në shqyrtim të kërkesë padisë.
- Me vendimin datë 20.02.2023 “Për kalimin e çështjes civile në seancë gjyqësore”, gjykata ka konstatuar se çështja hyn në juridiksionin dhe kompetencën e kësaj gjykate,

dhe se dokumentacioni i saj është i plotë. Në këto kushte, gjykata bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur kalimin e çështjes civile në seancë gjyqësore duke caktuar datën 27.03.2023 për zhvillimin e saj.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave të disponuara nga dosja fizike rezulton:

1. **Seanca e veprimeve paraprahe e datës 27.12.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës në datë 02.02.2023, me qëllim dhënien kohë përfaqësueses së palës paditëse për të sjellë vendimin e zgjidhjes së martesës me formë të prerë dhe njoftimin e të paditurit në adresën e tij në Rumani.
2. **Seanca përgatitore e datës 02.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 20.02.2023 me qëllim njoftimin e të paditurit në email dhe në adresën e tij, për shkak të mosmarrjes dijeni të këtij të fundit.
3. **Seanca përgatitore e datës 20.02.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur gjykimin në mungesë të palës së paditur të cilët rezulton të kenë dijeni për këtë seancë. Gjykata vijoi gjykimin me thirrjen e ekspertit të cilit iu caktua detyra e përgatitjes së akt-ekspertimit të ADN-së, për përgatitjen e të cilit eksperti kërkoi 10 ditë kohë. Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e ekspertit dhe caktoi seancën gjyqësore për në datë 27.03.2023.
4. **Seanca gjyqësore e datës 27.03.2023**, në të cilën gjykata relacionon faktin se akt-ekspertimi është depozituar dhe i është njoftuar palëve ndërgjyqëse. Pas konstatimit se aktet e përkthyer për të paditurin nuk janë në formën e kërkuar nga ligji, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 31.03.2023 me qëllim dhënien mundësi palës paditëse që të paraqesë aktet e përkthyer në formën e kërkuar nga ligji.
5. **Seanca gjyqësore e datës 31.03.2023**. Referuar shënimit të disponuar në dosjen fizike, i mbajtur nga sekretare gjyqësore E.H, kjo seancë nuk u zhvillua, për shkak se gjyqtarja ndodhet në Konferencën e Gjyqtarëve. Sipas këtij shënimi seanca tjetër do të zhvillohet më datë 05.04.2023.
6. **Seanca gjyqësore e datës 05.04.2023**, në të cilën gjykata ka administruar provat shkresore, i ka dhënë fund hetimit gjyqësor të çështjes duke shpallur në përfundim vendimin për pranimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 6 (gjashtë) seanca nga të cilat 1 (një) seancë nuk rezulton të jetë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët si mos marrja dijeni e palës së paditur për dy nga seancat e caktuara, dhënien kohë palës paditëse që të paraqesë provat. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 4 ditë (seanca 27.03.2023 – 31.03.2023) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 1 muaj e 6 ditë (seanca 20.02.2023 – 27.03.2023).

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 17.07.2019, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 17.07.2019 dhe është shortuar në datë 19.10.2021 (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca përgatitore e datës 15.07.2020**, në të cilën gjykata ka konstatuar faktin e mosmarrjes dijeni të palës së paditur për zhvillimin e kësaj seance. Për këtë shkak, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 17.12.2019, me qëllim njoftimin e palës së paditur.
2. **Seanca përgatitore e datës 17.12.2019**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi " *Vendim: Gjykata vendosi të shtyjë seancën përgatitore për ti dhënë kohë palëve prezent si detyrë e lënë në seancën e kaluar nga gjykata si certifikatën familjare të të paditurit dhe personale e tij. Seanca e ardhshme përgatitore do të zhvillohet më datë 18.02.2020.* ".
3. **Seanca përgatitore e datës 18.02.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 14.04.2020, me qëllim njoftimin e personit të tretë E.M i cili rezulton të mos ketë dijeni për zhvillimin e kësaj seance si dhe për të thirrur ekspertin gjenetist.
4. **Seanca përgatitore e datës 14.04.2020**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore, me vendimin nr.127 datë 10.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë", i bazuar në aktin normativ nr.9, datë 25.03.2020 "Per marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19". Seanca e ardhshme është caktuar në datë 21.07.2020.
5. **Seanca përgatitore e datës 21.07.2020**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës përgatitore për në datë 05.11.2020, pasi pala paditëse dhe personi i tretë E.M, rezultojnë të mos kenë dijeni për zhvillimin e kësaj seance.
6. **Seanca përgatitore e datës 05.11.2020**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "... Seanca përgatitore për verifikimin e marrëveshjes e datës 05.11.2020 ora 13.00 nuk u zhvillua për shkak të " marrjes së masave në lidhje me COVID-19 " për pezullimin e gjyqësorisë nga data 05.11.2020;06.11.2020; 09.11.2020 sipas vendimit të KLGJ nr.47/09 datë 04.11.2020 për pezullimin e gjyqësorisë." .
7. **Seanca përgatitore e datës 17.03.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "... Seanca përgatitore e datës 17.03.2021 ora 11.00 nuk u zhvillua se

- gjyqtarja mungon për arsye shëndetësore (me leje nga leja vjetore për shkak të COVID-19)..... Seanca e ardhshme do të zhvillohet më datë 16.07.2021...".
8. **Seanca përgatitore e datës 16.07.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 10.11.2021, për shkak të mos marrjes dijeni të palës së paditur dhe personit të tretë mbi zhvillimin e kësaj seance.
 9. **Seanca e datës 10.11.2021**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, rezulton se ky procesverbal nuk përmban asnjë informacion mbi zhvillimin e kësaj seance. *(gjyqtarja K.A është shkarkuar më datë 10.09.2021 me vendimin nr. 437 të KPK dhe procesverbalet e seancave vijuese pasqyrojnë faktin se gjykimi ka vijuar nga gjyqtarja F.B).*
 10. **Seanca e datës 04.04.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "shtyhet seanca më datë 26 maj 2022 ora 12 e 30 për ti dhënë mundësi ardhjes së ekspertit seanca deklarohet e mbyllur palët prezent morën dijeni. Të njoftohen palët e tjera dhe ti bëhet shkresë IPSHF".
 11. **Seanca e datës 26.05.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Vendim: gjykata shtyn seancën e veprimeve përgatitore për të njoftuar qendrën "F.C.A" për më datë 20.09.2022 ora 14:00. Palët prezent morën dijeni. Të njoftohet pala e paditur.."
 12. **Seanca përgatitore e datës 20.09.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Vendim: gjykata vendosi të kalojë çështjen në seancë gjyqësore për më datë 31.01.2023 ora 11:30 në mënyrë që të relatohet akti psikologjik".
 13. **Seanca gjyqësore e datës 31.01.2023**. Referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "shënim për seancën" konstatohet shënimi "Vendim: Gjykata shtyn seancën gjyqësore në mënyrë që të përsëriten njoftimet për më datë 25 maj 2023 ora 10:30.
 14. **Seanca e datës 25.05.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 14 (katërmbedhjetë) seanca nga të cilat 3 (tre) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar dhe për 1 (një) seancë nuk rezulton të kemi informacion mbi zhvillimin ose jo të saj. Gjithashtu kjo çështje rezulton që të jetë marrë në shqyrtim në fillim nga gjyqtare K.A (e cila evidentohet si gjyqtare e kësaj çështje deri më datë 16.07.2021, kur u zhvillua seanca e caktuar në këtë datë). Më tej evidentohet fakti se seanca e datës 04.04.2022 si dhe ato të caktuara në vijim, të jenë zhvilluar nga gjyqtare F.B, e cila rezulton të ketë shpallur dhe vendimin përkatës për këtë çështje. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët (si mos marrja dijeni e tyre për seancat respektive), veprimet procedurale që lidhen me ekspertë dhe/ose akt ekspertimin si dhe gjendja e pandemisë së COVID-19, e cila solli për pasojë pezullimin e veprimtarisë gjyqësore. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga

seanca në seancë është prej 1 muaj e 22 ditë (seanca 04.04.2022 – 26.05.2022) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 26 ditë (seanca 10.11.2021 – 04.04.2022). Kjo e fundit përkon me fazën procedurale kur është ndryshuar trupa gjyqesore.

- *Dy çështje me objekt: "Ushtrim i përgjegjësisë prindërore":*

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 20.10.2022, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 20.10.2022 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 21.03.2023**, në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit për në datë 24.04.2023.
2. **Seanca gjyqësore e datës 24.04.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesë padisë së paditësit.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 2 (dy) seanca. Nga përmbajtja e seancave rezulton vetëm një rast shtyrje seance kjo, për shkaqe procedurale sikundër është kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjithashtu rezulton që shqyrtimi gjyqësor i çështjes të ketë përfunduar po në seancë gjyqësore duke shpallur gjykata vendimin e sipërcituar. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se seancat janë zhvilluar në një distancë kohore prej 1 muaj e 3 ditë.

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë në datë 19.10.2020, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 19.10.2020 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore).

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e datës 11.03.2021**. Kjo seancë nuk u zhvillua për arsye shëndetësore (COVID-19) të gjyqtare.

2. **Seanca e veprimeve paraprake¹¹⁹ e datës 20.05.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 22.09.2021, për t'i dhënë kohë të paditurit të përfaqësohet me avokat dhe të sjellë provat shkresore.
3. **Seanca përgatitore e datës 22.09.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 22.09.2021, për t'i dhënë mundësi palës së paditur që të paraqesë provat shkresore.
4. **Seanca e datës 19.11.2021**, në të cilën gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën e përfaqësueses së palës së paditur për shtyrje seance, duke vendosur pranimin e kësaj të fundit dhe shtyrjen e seancës për në datë 18.02.2022.
5. **Seanca e datës 18.02.2022**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja M.D., për arsye shëndetësore (me raport për paafësi të përkohshme në punë) nuk u paraqit në punë.
6. **Seanca përgatitore e datës 23.06.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 24.11.2022 për t'i dhënë kohë përfaqësueses së palës paditëse për t'u njohur me provat e paraqitura në këtë seancë nga pala e paditur.
7. **Seanca përgatitore e datës 24.11.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit për në datë 18.04.2023. (procesverbali i kësaj seance referon datën 18.04.2022 por duke patur parasysh se seanca në vijim sipas sistemit elektronik rezulton të jetë ajo e datës 18.04.2023, konstatohet të jetë një lapsus).
8. **Seanca e datës 18.04.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për pranimin e kërkesëpadisë.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 8¹²⁰ (tetë) seanca nga të cilat 2 (dy) seanca nuk rezultojnë të jenë zhvilluar. Nga përmbajtja e seancave rezulton se pjesa më e madhe e këtyre seancave janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët dhe/ose kërkesat e përfaqësuesve të tyre për shtyrje seance. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 1 muaj e 28 ditë (seanca 22.09.2021 – 19.11.2021) ndërsa distanca më e largët është ajo prej 4 muaj e 1 ditë (seanca 23.06.2022 – 24.11.2022).

- *Dy çështje me objekt: "Zgjidhje martesë me marrëveshje":*

I. Çështja nr. 1

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga fashikulli gjyqësor fizik. Kërkesa është regjistruar në gjykatë në datë 20.03.2023. Objekti i kërkesës "Miratimi i projekt marrëveshjes për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok sipas "projekt-

¹¹⁹ Cilësohet si e tillë referuar procesverbalit të kësaj seance, i gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës.

¹²⁰ Këtu përfshihet edhe një seancë ajo e datës 20.05.2021, sipas procesverbalit të së cilës seanca cilësohet si seancë e veprimeve paraprake.

marrëveshjes për zgjidhjen me pëlqim reciprok të martesës dhe pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e saj....”.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara në dosjen fizike rezulton:

1. **Seanca e pajtimit e datës 11.04.2023**, në të cilën gjykata ka vlerësuar se çështja nuk do të zgjidhet me pajtim mes palëve dhe ka nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Gjykata ka vijuar seancën gjyqësore po në këtë datë, në përfundim të së cilës ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 02.05.2023, me qëllim dhënien kohë palëve për të paraqitur prova të tjera shkresore si dhe njoftimin e psikologes.
2. **Seanca gjyqësore e datës 02.05.2023**, në të cilën gjykata ka verifikuar prezencën e palëve ndërgjyqëse, ka vijuar me caktimin e detyrave psikologes bazuar në nenin 227 të Kodit të Procedurës Civile. Psikologia ka kërkuar kohë për përgatitjen e akt-ekspertimit, kërkesë kjo e cila u pranua nga gjykata duke vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore në datë 11.05.2023. Në procesverbal raportohet fakti se akti i ekspertimit do të paraqitet përpara datës së seancës gjyqësore të caktuar më 11.05.2023.
3. **Seanca gjyqësore e datës 11.05.2023**, në të cilën gjykata pasi ka lejuar dhe administruar në cilësinë e provës akt-ekspertimin e paraqitur nga psikologia i ka dhënë fund hetimit gjyqësor duke ftuar palët për pretendimet përfundimtare. Në përfundim gjykata ka shpallur vendimin për pranimin pjesërisht të kërkesës.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 3 (tre) seanca. Nga përmbajtja e përgjithshme e seancave rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë për shkaqe procedurale të pasjella nga palët si dhënia kohë këtyre të fundit për të paraqitur provat të tjera shkresore, apo edhe shkaqe të tjera që lidhen me ekspertin dhe/ose akt -ekspertimin. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është brenda ditës (seanca e datës 11.04.2023 në të cilën është zhvilluar si seanca e pajtimit ashtu edhe ajo gjyqësore) ndërsa distanca më e largët është rreth 21 ditë (seanca 11.04.2023 - 02.05.2023).

II. Çështja nr. 2

Të dhënat në lidhje me këtë çështje janë marrë nga procesverbalet e seancave të gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës. Kërkesa është paraqitur në gjykatë në datë 18.01.2021, është regjistruar në këtë të fundit po në datë 18.01.2021 dhe nuk ka të dhëna mbi datën e shortimit (referuar tabelës me të dhënat statistikore). Kërkesa ka për objekt gjykimin “Zgjidhje martese me pëlqim reciprok. Miratimi i marrëveshjes për zgjidhje martese me mirëkuptim datë 05.01.2021, lidhur para ndërmjetës G.S”.

Përkatësisht nga përmbajtja e procesverbaleve të këtyre seancave të disponuara nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton:

1. **Seanca e pajtimit e datës 17.09.2021**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës së pajtimit për në datë 18.11.2021, me qëllim njoftimin e palës kërkuese.
2. **Seanca e datës 18.11.2021**, në të cilën gjykata, bazuar në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e caktuar këtë të fundit për në datën 25.03.2022.
3. **Seanca gjyqësore e datës 25.03.2022**. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se gjyqtarja është me leje vjetore. Seanca u shty për në datë 26.05.2022.
4. **Seanca gjyqësore e datës 26.05.2022**. Referuar procesverbalit të kësaj seance i gjeneruar nga sistemi elektronik, tek rubrika "Shënim për seancën" konstatohet shënimi "*Seanca gjyqësore e datës 26.05.2022, nuk do të zhvillohet për shkak të lëshimit të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes me palë L.J dhe M.J ndër të cilat pala e paditur është shtetas i huaj i cili kërkon edhe domosdoshmërinë e një përkthyesi..... Seanca do të shtyhet për në datën 09.11.2022*".
5. **Seanca e datës 09.11.2022**, në të cilën gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për në datë 05.05.2023, për ti dhënë mundësi palëve të zgjidhin mënyrën e përfaqësimit në çështjen civile familjare me objekt "zgjidhje martese".
6. **Seanca e datës 05.05.2023**, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin për pranimin e kërkesës së kërkuësve.

Për këtë çështje konstatohet se janë caktuar gjithsej 6 (gjashtë) seanca. Nga përmbajtja e përgjithshme e seancave rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë për shkaqe procedurale të passjella nga palët apo edhe kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore etj. Për sa i përket distancës kohore ndërmjet seancave, evidentohet fakti se distanca më e shkurtër kohore nga seanca në seancë është prej 2 muaj e 1 ditë (seanca e datës 17.09.2021 – seanca e datës 18.11.2021) ndërsa distanca më e largët është rreth 5 muaj e 26 ditë (seanca 09.11.2022-05.05.2023).

5.5. Fakte të konstatuara në lidhje me çështjet me objekt: "Kundërshtimi i veprimeve përmbartimore" dhe "Lëshimi i urdhrit të mbrojtjes".

Referuar afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile në lidhje me gjykimin e mosmarrëveshjeve civile, më poshtë kemi vlerësuar të pasqyrojnë si raste studimore çështjet me objekt "Kundërshtimi i veprimeve përmbartimore" si dhe çështjet me objekt "Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes".

5.5.1. Çështjet me objekt "Kundërshtimi i veprimeve përmbartimore"

Referuar nenit 610 të K.Proc.Civile parashikohet se: "Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbartuesit gjyqësor shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh te nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbartuesin gjyqësor".

Referuar të dhënave të ardhura në mënyrë elektronike nga Gjykata rezulton se gjatë periudhës tremujore objekt ekspertimi janë përfunduar gjithsej 25 çështje civile me objekt "Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore".

Referuar procesverbaleve të seancave printuar nga sistemi elektronik rezulton sa më poshtë:

1. Lidhur me çështjen nr. 6420 akti, datë 04.04.2022, rezulton se nuk ka patur seanca të shtyra, por është zhvilluar vetëm seanca e datës 27.04.2023, ku gjykata ka marrë vendimin nr. 1862, datë 27.04.2023, "Për kthimin e akteve".

2. Lidhur me çështjen nr.12475 akti, datë 19.04.2023, rezulton se nuk ka patur seanca të shtyra, por është zhvilluar vetëm seanca e datës 03.05.2023, ku gjykata ka marrë vendimin nr. 1971, datë 03.05.2023, "Për shpallje të moskompetencës lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkesë...".

3. Lidhur me çështjen nr. 9572 akti, datë 16.11.2022, rezulton se nuk ka patur seanca të shtyra, por është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë përkatësisht ajo e datës 17.03.2023, ku gjykata ka marrë vendimin nr. 1190, për "Pushimin e gjykimit të çështjes nr. 9572 akti, datë 16.11.2022".

4. Çështja nr.12195 akti, datë 05.04.2023, rezulton se nuk ka seanca të shtyra, por është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë përkatësisht ajo e datës 26.04.2023 ku gjykata ka marrë vendimin nr.1828, për "Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr.12195 akti".

5. Çështja nr. 11647 akti, datë 08.03.2023, rezulton se nuk ka seanca të shtyra, por është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë përkatësisht ajo e datës 30.03.2023 ku gjykata ka marrë vendimin nr. 1384, për "Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr. 11647 Akti".

6. Çështja nr.11210 akti, datë 15.02.2023, nuk rezulton të ketë procesverbale seancash nga sistemi elektronik. Nga të dhënat e dërguara në mënyrë elektronike nga Gjykata e Tiranës për vendimet civile objekt inspektimi tematik, rezulton se ka një vendim të gjykatës me nr.908 datë 01.03.2023 për kthim aktesh.

7. Çështja nr.10718 akti, datë 30.01.2023, nuk rezulton të ketë procesverbale. Referuar të dhënave të disponuara nga numërori i vendimeve civile të vënë në dispozicion nga Gjykata e Tiranës rezulton se ka një vendim të gjykatës respektivisht me nr. 1014 datë 07.03.2023 për kthim aktesh.

8. Çështja nr. 8039 akti, datë 29.07.2022, rezulton të ketë 6 (gjashtë) seanca të shtyra dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 2184, datë 15.05.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "rrëzimin e ankimit". Sistemi elektronik në rubrikën "seanca" pasqyron seancat e zhvilluara për këtë çështje me një përmbledhje të procesverbaleve të mbajtura për secilën seancë. Ndër të tjerash, pasqyrohet 1 (një) seancë e datës 27.04.2023 për këtë çështje, por që nuk përmban informacion për atë se çfarë është zhvilluar gjatë kësaj

seance. Gjithashtu sistemi elektronik nuk pasqyron seancën e datës 15.05.2023, në të cilën gjykata ka shpallur vendimin.

Gjetje: Nga këqyrja e të dhënave të pasqyruara në sistemin elektronik rezulton se ky i fundit përmban informacion për pjesën me të madhe të seancave të zhvilluara por mungon informacioni për seancën e datës 27.04.2023 dhe nuk pasqyron asnjë të dhënë mbi seancën e datës 15.05.2023.

9. Çështja me nr.8384 akti, datë 08.09.2022, rezulton të ketë 3 (tre) seanca të shtyra, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr.1500, datë 06.04.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "mospranimin e ankimit".

10. Çështja nr. 11824 akti, datë 17.03.2023, rezulton të ketë 1 (një) seancë të shtyrë dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr.2025 datë 05.05.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "Pushimin e gjykimit të çështjes civile.....". Në sistemin elektronik rubrika "seanca" pasqyrohet ndër të tjerash, 1 (një) seancë e datës 05.05.2023 për këtë çështje por që nuk përmban informacion për atë se çfarë është zhvilluar gjatë kësaj seance. Informacioni mbi seancën e kësaj date, evidentohet vetëm nga vendimi i shpallur po në këtë datë, 05.05.2023.

11. Çështja nr. 4721 akti, datë 11.11.2021, rezulton të ketë 4 seanca të shtyra, dhe 1 seancë për shpalljen e vendimit nr. 2228, datë 16.05.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "Pushimin e gjykimit të çështjes civile". Në sistemin elektronik rubrika "seanca" pasqyrohet ndër të tjerash, 1 (një) seance e datës 10.04.2023 por që nuk përmban informacion për atë se çfarë është zhvilluar gjatë kësaj seance. Gjithashtu sa i përket seancës së zhvilluar më 02.02.2022, rezulton se në përmbledhjen e hedhur në rubrikën "seanca" pasqyrohet data e kësaj seance si 02.02.2021.

Gjetje: Nga këqyrja e të dhënave të hedhura në sistemin elektronik rezulton mungesë të dhënash për një seancë të zhvilluar më datë 10.04.2023 dhe pasaktësi të dhënash për seancën e zhvilluar më datë 02.02.2022.

12. Çështja nr. 8547 akti, datë 20.09.2022, rezulton të ketë 1 (një) seancë të shtyrë dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 1787, datë 24.04.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "Pushimin e gjykimit të çështjes civile...".

13. Çështja nr. 10613 akti, datë 27.01.2023, rezulton të ketë 1(një) seancë të shtyrë dhe 1(një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 1810, datë 25.04.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "Anulimin e vendimit nr.115 prot., datë 09.01.2023.....". Në sistemin elektronik rubrika "seanca" pasqyrohet ndër të tjerash 1 (një) seancë e datës 24.04.2023 por që nuk përmban informacion për atë se çfarë është zhvilluar gjatë kësaj seance. Gjithashtu sa i përket seancës së zhvilluar më datë 13.03.2023, rezulton se në përmbledhjen e hedhur në rubrikën "seanca" nuk pasqyrohet data e kësaj seance.

Gjetje: Nga këqyrja e të dhënave të hedhura në sistemin elektronik rezulton mungesë të dhënash për një seancë të zhvilluar më datë 24.04.2023 si dhe për seancën e zhvilluar më datë 13.03.2023.

14. Çështja nr. 7737 akti, datë 12.07.2022, rezulton të ketë 7 (shtatë) seanca të shtyra dhe 1 seancë për shpalljen e vendimit nr. 1118, datë 13.03.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "Pushimin e gjykimit me nr.7737 akti.....". Në sistemin elektronik, në rubrikën "seanca" pasqyrohen ndër të tjera 2 (dy) seanca të datës 23.11.2022 dhe 16.12.2022 por që nuk përmbajnë informacion për atë se çfarë është zhvilluar gjatë këtyre seancave. Gjithashtu në pjesën më të madhe të seancave të zhvilluara për këtë gjykim rezulton se në përmbledhjen e hedhur në sistemin elektronik për secilën prej tyre nuk pasqyrohet data e zhvillimit të tyre.

Gjetje: Nga këqyrja e të dhënave të hedhura në sistemin elektronik rezulton mungesë të dhënash për dy seanca të datës 23.11.2022 dhe 16.12.2022.

15. Çështja nr. 10012 akti, datë 14.12.2022, rezulton të ketë 1(një) seancë të shtyrë, dhe 1 seancë për shpalljen e vendimit nr. 1915, datë 28.04.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "rrezimin e ankimit".

16. Çështja nr. 1681 akti, datë 06.07.2020, rezulton të ketë 29 (njëzet e nëntë) seanca të shtyra, dhe 1 seancë për shpalljen e vendimit nr.1738, datë 20.04.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "pranimin e padisë së paditësit.....". Në pjesën më të madhe të seancave të zhvilluara për këtë gjykim rezulton se në përmbledhjen e hedhur në sistemin elektronik rubrika "seanca" për secilën prej tyre nuk pasqyrohet data e zhvillimit të tyre.

17. Çështja nr. 8147 akti, datë 10.08.2022, rezulton të ketë 1 (një) seancë të shtyrë, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr.2401, datë 23.05.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "pushimin e gjykimit të çështjes....". Në sistemin elektronik rubrika "seanca" pasqyrohet ndër të tjerash 1 (një) seancë e veprimeve paraprake, datë 06.09.2022 e cila përmban informacion mbi veprimet paraprake të kryera nga gjyqtari i çështjes. Gjithashtu sa i përket seancës së zhvilluar më datë 05.04.2023, rezulton se në përmbledhjen e hedhur në sistemin elektronik për këtë seancë nuk pasqyrohet data e kësaj të fundit.

18. Çështja nr. 5828 akti, datë 18.02.2022, rezulton të ketë 1(një) seancë të shtyrë dhe 1 seancë për shpalljen e vendimit nr.1916, datë 28.04.2023, ku gjykata marrë vendimin për "shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës....". Lidhur me seancën e zhvilluar më datë 25.04.2023, rezulton se në përmbledhjen e hedhur në sistemin elektronik për këtë seancë nuk pasqyrohet data e kësaj të fundit.

19. Çështja nr. 10621 akti, datë 27.01.2023 rezulton të ketë 1 (një) seancë të shtyrë, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 1689, datë 19.04.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "Pushimin e gjykimit të çështjes civile".

20. Çështja nr. 11716 akti, datë 10.03.2023, rezulton të ketë 2 (dy) seanca të shtyra, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 1322, datë 28.03.2023, ku gjykata ka marrë vendimin "Për shpalljen e moskompetencës lëndore"

21. Çështja nr. 10407 akti, datë 25.01.2023, rezulton të ketë 4 (katër) seanca të shtyra, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 930, datë 03.03.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "Pushimin e gjykimit të çështjes.....".

22. Çështja nr. 9412 akti, datë 04.11.2022, rezulton të ketë 5 (pesë) seanca të shtyra, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 1938, datë 02.05.2023 ku gjykata ka marrë vendimin për "Pranimin e padisë (ankimit).Anulimin e veprimeve përmbartimore.....". Në sistemin elektronik rubrika "seanca" pasqyrohet ndër të tjerash 1 (një) seancë e datës 23.11.2022 e cila përmban informacion mbi veprimet paraprake të kryera nga gjyqtari i çështjes. Gjithashtu pasqyrohet ndër të tjerash 1 (një) seancë e datës 02.05.2023 për këtë çështje por që nuk përmban informacion për atë se çfarë është zhvilluar gjatë kësaj seance. Informacioni mbi seancën e kësaj date, evidentohet vetëm nga vendimi i shpallur po në këtë datë ,02.05.2023. Lidhur me seancën e zhvilluar më datë 14.04.2023, rezulton se në përmbledhjen e hedhur në sistemin elektronik për këtë seancë nuk pasqyrohet data e kësaj të fundit (për ta konfirmuar inspektorja nëse duhet konstatuar edhe ky element).

23. Çështja nr. 3827 akti, datë 02.08.2021, rezulton të ketë 6 (gjashtë) seanca të shtyra, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr.1345, datë 29.03.2023. Në sistemin elektronik pasqyrohet ndër të tjerash 1 (një) seancë e datës 29.07.2022 për këtë çështje por që nuk përmban informacion për atë se çfarë është zhvilluar gjatë kësaj seance. Nga këqyrja e të dhënave të pasqyruara në sistemin elektronik për secilën seancë, rezulton se gjyqtari z. A.A e ka gjykuar këtë çështje deri në seancën e datës 31.05.2022. Më pas nga seanca e datës 02.12.2022 e deri në shpalljen e vendimit, kjo çështje është gjykuar nga gjyqtar z. D.C.

24. Çështja nr. 2089 akti, datë 27.10.2020, rezulton të ketë 10 (dhjetë) seanca të shtyra, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 2015, datë 05.05.2023, ku gjykata ka marrë vendimin për "pranimin pjesërisht të kërkesës. Anulimin e veprimeve përmbartimore....". Në sistemin elektronik pasqyrohet ndër të tjerash 1 (një) seancë e datës 02.11.2022 për këtë çështje por që nuk përmban informacion për atë se çfarë është zhvilluar gjatë kësaj seance. Nga këqyrja e të dhënave të pasqyruara në sistemin elektronik për secilën seancë, rezulton se kjo çështje ka pasur 3 gjyqtarë përkatësisht në fillim gjyqtaren znj. A. H. e cila rezulton të ketë gjykuar deri në seancën e datës 20.01.2021, më tej gjyqtaren znj. A. G. deri në seancën e datës 15.07.2022, dhe së fundmi gjyqtaren znj.M Xh. deri në seancën e shpalljes së vendimit më datë 05.05.2023. (Lidhur me seancën e zhvilluar më datë 27.04.2023, rezulton se në përmbledhjen e hedhur në sistemin elektronik për këtë seancë nuk pasqyrohet data e kësaj të fundit)

25. Çështja nr. 4024 akti, datë 03.09.2021, rezulton të ketë 6 (gjashtë) seanca të shtyra, dhe 1 (një) seancë për shpalljen e vendimit nr. 2533, datë 29.05.2023, ku gjykata ka marrë

vendimin për “Pranimin e pjesshëm të padisë.....”. Në pjesën më të madhe të seancave të zhvilluara për këtë gjykim rezultoi se në përmbledhjen e hedhur në sistemin elektronik rubrika “seanca” për secilën prej tyre nuk pasqyrohet data e zhvillimit të tyre por edhe emri i gjyqtarit të çështjes.


Analiza e të dhënave:

Nga analiza të tërësi e të dhënave të mbledhura në lidhje me çështjet gjyqësore me objekt: “Padi për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore”, konstatohet se gjatë periudhës tremujore objekt inspektimi janë përfunduar gjithsej 25 çështje të cilat kanë pasur për objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.

Kohëzgjatja e këtyre proceseve gjyqësore varion nga afati më i shkurtër 14 ditë deri në afatin më të gjatë që është 1018 ditë. Referuar procesverbaleve të seancave të printuara nga sistemi elektronik rezultoi sa më poshtë:

- Për 5 çështje, procesi është zhvilluar brenda një seance dhe nuk rezultoi të ketë seanca të shtyra.
- Për dy çështje nuk rezultoi të ketë procesverbale në sistem.
- Ndërsa në lidhje me 18 çështjet e tjera procesi gjyqësor është zhvilluar me më shumë se një seance.
- Afati mesatar i kohëzgjatjes së këtyre proceseve është “265” ditë.

Shkaqet e shtyrjes së seancave në tërësi për këtë lloj objekt padie janë paraqitur në grafikun si vijon:



5.5.2. Faktet e konstatuara në lidhje me çështjet me objekt "Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes"

Ligji nr. 9969 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare " në nenin 16, përcakton se "Gjykata vendos për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës".

Referuar të dhënave të ardhura në mënyrë elektronike nga Gjykata rezulton se gjatë periudhës tremujore objekt ekspertimi janë përfunduar gjithsej 41 çështje civile me objekt "Padi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes".

Më poshtë janë paraqitur dy raste studimore në lidhje me një çështje që ka zgjatur më pak dhe në lidhje me një çështje që ka zgjatur më shumë për të cilat gjyqtari është shprehur me vendim përfundimtar për zgjidhjen në themel të çështjes.

- Rasti I – çështja me nr.12674 regj.30.04.2023:

- Kërkesë padia për urdhrin e mbrojtjes është paraqitur në gjykatë në datë 30.04.2023
- Çështja është regjistruar dhe është caktuar gjyqtari në datë 30.04.2023
- Vendim datë 30.04.2023 i gjyqtarit "Për caktimin e seancës gjyqësore" e cila është planifikuar të zhvillohet në datë 01.05.2023.
- Procesverbali i seancës datë 01 maj 2023 në të cilin ndër të tjera është pasqyruar se: "*u thirr dhe nuk u paraqit pala paditëse dhe i padituri, rezulton se kane dijeni nga ftuesi i gjykatës nëpërmjet numrit të telefonit të vendosur në padi. ..gjykata ka vijuar gjykimin në mungesë të palëve ndërgjyqëse, çelët shqyrtimi gjyqësor, gjykata lejon marrjen e provave të ardhura nga Komisariati, citohen dhe administrohen duke i bërë pjesë përbërë të dosjes gjyqësore, mbyll shqyrtimin gjyqësor, tërhiqet për vendim, ndërpritet seanca, reçellet seanca, gjykata shpall vendimin)*
- Vendim 01.05.2023 "Për refuzimin e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes".

- Rasti II- çështja me nr.13274 regj. Datë 17.05.2023

- Kërkesë padia për urdhrin e mbrojtjes është paraqitur në gjykatë në datë 17.05.2023
- Çështja është regjistruar dhe është caktuar gjyqtari në datë 17.05.2023.
- Në sistemin elektronik ndodhen dy procesverbale të dy seancave gjyqësore datë 31.05.2023 nga të cilat rezulton se seanca e zhvilluar në ora 11:30-12:03 është shtyrë për t'u zhvilluar po në datën 31.05.2023 ora 15:00 për ti dhënë mundësi përfaqësuesit të paditësve të sjellin provat shtesore.
- Vendim datë 31.05.2023 i gjyqtarit "Për pranimin e urdhrit të mbrojtjes".

Analiza e të dhënave:

Referuar të dhënave të ardhura në mënyrë elektronike nga Gjykata rezulton se gjatë periudhës tremujore objekt ekspertimi janë përfunduar gjithsej 41 çështje civile me objekt "Padi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes".

Afatet e shqyrtimit variojnë nga afati më i shkurtër 1 ditë deri në afatin 14 ditë. Vetëm një çështje ka zgjatur 37 ditë për të cilën është vendosur “pushimi”.

Përsa i përket çështjes që ka zgjatur më pak në gjykim për të cilën gjyqtari është shprehur me vendim për zgjidhjen në themel të çështjes, rezulton se në aspektin administrativ kërkesë padia është paraqitur tek gjyqtari brenda ditës dhe gjyqtari brenda ditës së marrjes dijeni ka planifikuar seancën gjyqësore duke urdhëruar sekretarin për njoftimin e vendimit të caktimit të seancës. Gjyqtari brenda 1 ditë ka proceduar me gjykimin dhe vendimmarrjen përfundimtare dhe parë nga këndvështrimi i respektimit të afatit të përcaktuar në nenin 14 të Ligjit, ky afat është respektuar.

Përsa i përket çështjes që ka zgjatur më shumë në gjykim për të cilën gjyqtari është shprehur me vendim për zgjidhjen në themel të çështjes, rezulton se fashikulli i kësaj dosje nuk është bërë e mundur të administrohet pasi dosja është ndodhur në apel. Si rrjedhim faktet e konstatuara janë referuar të dhënave në numërorin e vendimeve civile si dhe në sistemin elektronik. Në aspektin administrativ kërkesë padia është paraqitur tek gjyqtari brenda ditës dhe gjyqtari ka planifikuar seancën gjyqësore në datë 31.05.2023. Gjyqtari brenda afatit 15 ditor ka proceduar me gjykimin dhe vendimmarrjen përfundimtare dhe parë nga këndvështrimi i respektimit të afatit të përcaktuar në nenin 14 të Ligjit, ky afat është respektuar.

Mesatarja e kohëzgjatjes së proceseve me objekt “kërkesë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes” është 6 ditë.

6. Gjetjet e inspektimit në lidhje me proceset gjyqësore që janë zgjatur përtej afatit dy vjeçar/ Kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit.

6.1. Faktet e konstatuara në lidhje me numrin e përgjithshëm të proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtarë të cilat janë zgjatur përtej afatit 2 vjeçar.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar çështjeve, kohëzgjatja e të cilave mund të çojnë në konstatimin e shkeljes së të drejtës së individit për një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme.

Sikurse kemi cituar edhe më lart, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile për periudhën 01.03.2023-31.05.2023 ka shpallur 1748 vendime. Koha mesatare e gjykimit për këto 1748 çështje është 398 ditë.

Referuar informacionit të gjykatës të administruar në mënyrë elektronike nëpërmjet emailit datë 13.06.2024 rezulton se në këtë informacion pasqyrohet fakti se janë 265

çështje të cilat kanë një kohëzgjatje gjyqimi mbi dy vjet. Nga verifikimi i të dhënave nga ana e ILD-së vihet re se një çështje është e raportuar dy herë në këtë tabelë¹²¹

Si rrjedhim rezulton se numri total i çështjeve të cilat kanë zgjatur më shumë se dy vjet¹²² është 264 çështje.

Koha mesatare e gjyqimit të 264 çështjeve të cilat kanë zgjatur më shumë se dy vjet është 1065 ditë.

Të dhëna më të detajuara në lidhje me numrin e çështjeve si dhe me kohën mesatare të gjyqimit për secilin gjyqtar për çështjet mbi dy vjet, janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Vendimet për periudhën 01.03.2023-31.05.2023				
Nr.	Gjyqtari	Numri i vendimeve në total	Numri i vendimeve për çështjet mbi dy vite	Koha mesatare në ditë për çështjet mbi dy vite
1	A. Gj ¹²³	60	-	-
2	A. B	219	5	882
3	A. Zh	90	26	1066
4	A. Kod	64	14	1109
5	A. Sh	78	8	1092
6	A. G	45	7	1169
7	A. Ka	40	15	1088
8	A. P	52	10	1017
9	A Kos ¹²⁴	10	1	1168
10	A. Kë	1	-	-
11	B. M	56	12	1145
12	B. K	36	2	909
13	D. G ¹²⁵	2	-	-
14	D. C	66	16	1389
15	E. L ¹²⁶	12	-	-
16	E. Gj ¹²⁷	2	-	-

¹²¹ Çështja me nr. 2568 regj. 10.02.2021

¹²² Mbi 730 ditë

¹²³ Ardhur në mars 2023

¹²⁴ Larguar në 15 mars 2023

¹²⁵ Ardhur në prill 2023

¹²⁶ Ardhur në mars 2023

¹²⁷ Ardhur në maj 2023

17	E. V	66	18	1018
18	E. P	101	21	996
19	E. Xh ¹²⁸	28	3	1135
20	F. S	177	20	890
21	F. D	38	16	1199
22	F. K	31	11	903
23	J. H	58	17	1070
24	M. D	182	16	983
25	M. Xh	73	16	1036
26	N. R	33	3	1326
27	V. Z	128	7	1001
		Totali 1748	Totali 264	Mes. për gjykatën. 1065

Referuar analizës së shkaqeve të shtyrjes së seancave të pasqyruara në procesverbalet e seancave gjyqësore të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve për 256 çështjet të cilat kanë pasur një kohëzgjatje gjyqimi më shumë se dy vjet, është përfshuar grafiku si vijon:



6.2. Fakte të konstatuara në lidhje me numrin e çështjeve për të cilat nëpërmjet vendimit gjyqësor është konstatuar shkelja e afatit të arsyeshëm.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se në referim të nenit 46 të Konventës shteti duhet të vendosë një zgjidhje të brendshme, në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedurave. Në përmbushje të rekomandimeve të Gjykatës

¹²⁸ Ardhur në mars 2023

duke ju referuar edhe vendimit të kësaj gjykate në çështjen "Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë", në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr.38/2017 u shtua "Kreu X" dhe përkatësisht nenet 399/1-399/12 të K.Pr.C.

Neni 399/2 i K.Pr.C parashikon se afati i arsyeshme i kohëzgjatjes së një gjykimi civil në shkallë të parë është dy vjet.

Konkretisht neni 399/2 pika 1,2,3 parashikon ndër të tjera se:

"1. Afate të arsyeshme të përfundimit hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen: ...; b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve,...

2. Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tej zgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6 pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektivin e mosmarrëveshjes, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë për zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit.

3. Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim".

Neni 399/5 parashikon se: *"Kërkesa depozitohet në sekretarinë e gjykatës që është në vonesë, ose gjykatës kompetente për ekzekutimin. ..."*

Neni 399/7 parashikon ndër të tjera se: *"Gjykimi i kërkesë padis sipas nenit 399/6 pika 1¹²⁹, bëhet në dhomë këshillimi dhe gjykata që shqyrton çështjen merr vendim brenda 45 ditëve, nga paraqitja e kërkesës. Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kësaj kërkesë, organi që pretendohet se ka kryer shkeljen, i dërgon kopje të dosjes dhe mendimin me shkrim, gjykatës që shqyrton shkeljen.*

Neni 399/8, pika 2: *"Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë".*

Neni 399/12 parashikon gjithashtu se *"Vendimi i formës së prerë i gjykatës kompetente, sipas nenit 399/6 i përcillet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar nëse vonesat e shkaktuara nga gjyqtarët, sipas këtij kreu, përbëjnë shkelje disiplinore".*

Përsa më sipër, me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017 (të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 05.11.2017), tashmë çdo individ i janë ofruar mjete të reja ligjore për t'u mbrojtur efektivisht nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Konkretisht, K.Pr.C. përcakton se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), me çfarë mjetesh mbrohesh nga cenimi: kërkesa për përshpejtim të gjykimit (neni 399/4) dhe kërkesa për dëmshpërblim, dhe çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin

¹²⁹ Neni 399/6 pika 1, shkronja a) : Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile, administrative si më poshtë:
a) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatën e shkallës së parë, kërkesa shqyrtohet nga Gjykata e Apelit, në juridiksionin e të cilës ndodhet gjykata e shkallës së parë;

e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), marrja e vendimit (neni 399/8), etj. Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore nëpërmjet të cilave individëve u garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si dhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (shih vendimin nr.3 datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

Një vëmendje e veçantë gjatë inspektimit i është kushtuar çështjeve në të cilat kohëzgjatja ka qenë e tillë që mund të çojë në konstatimin e shkeljes së të drejtës së individit për një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Në kuadër të identifikimit të çështjeve për të cilat është depozituar kërkesë me objekt "Konstatim shkeljesh dhe përshpejtim procedurash" kemi kërkuar informacion pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si dhe pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në lidhje me kërkesën tonë për informacion "Për marrjen e të dhënave në lidhje me kërkesat me objekt "Konstatim shkelje dhe përshpejtim procedurash" (në referim të nenit 399/6 pika 1 i K.Pr.C) të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023 – 31.05.2023, na ka informuar se ka patur vetëm një kërkesë me objekt "Konstatim shkelje dhe përshpejtim procedurash" të paraqitur në gjykatë, Referuar vendimit gjyqësor bashkëngjitur kësaj kërkesë konstatohet se kërkesa ka pasur për objekt "Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e detyrimit që rrjedh nga vendimi gjyqësor" dhe në këto kushte kërkesa është shqyrtuar nga vetë gjykata¹³⁰ ku është paraqitur kërkesa e cila ka disponuar me vendimin "Për pushimin e gjykimit".

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në lidhje me kërkesën e ILD-së se sa çështje kanë përfunduar gjatë periudhës objekt inspektimi me objekt "Konstatim shkeljesh dhe përshpejtim procedurash", ka informuar se referuar sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS dhe në regjistrin themeltar civil, janë dhënë dy vendime gjatë periudhës (tre mujore) objekt inspektimi. Këto dy raste janë relatuar si më poshtë:

• Rasti I

Çështja civile nr. 4996 regj. është regjistruar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datë 23.05.2022 me objekt "Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të përfundimit të gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhoma civile)".

Rrethanat e çështjes:

Kërkesa me objekt "Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave" ka të bëjë me çështjen për të cilën ishte depozituar kërkesë padia përkatëse

¹³⁰ Neni 399/c, pika 1, shkronja ç e K.Pr.C.

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në datë 09.10.2019; regjistruar në gjykatë në datë 10.10.2019; shortuar në datë 14.10.2019, dorëzuar gjyqtarit në datë 15.10.2019; në datë 16.10.2019 gjyqtari i çështjes ka vendosur kryerjen e veprimeve paraprake në kuadër të të cilave është realizuar njoftimi i padisë për palën e paditur dhe është ftuar ajo për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes dhe kërkesat për provat. Deklarata e mbrojtjes i është njoftuar më pas palës paditëse me dëftesën e komunikimit datë 25.11.2019, ndërkohë që për një nga personat e tretë është proceduar me shpallje publike.

Pas kryerjes së veprimeve paraprake të çështjes, bazuar në nenin 158/b të K.Pr.C, me vendimin e datës 21.02.2020 gjyqtari ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë përgatitore në datë 27.04.2020 me arsyetimin se pala paditëse ka kërkuar në padi marrjen si provë të ekspertimit topografik. Seanca përgatitore e datës 27.04.2020 nuk është zhvilluar për shkak të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e R. Sh si rezultat i pandemisë së Covid-19. Pas rifillimit të veprimtarisë gjyqtari ka planifikuar shqyrtimin e çështjes në seancë përgatitore në datë 31.07.2020 por kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak se ka koençiduar me ditë pushimi zyrtar. Seanca e ardhshme është programuar të zhvillohet në datë 07.08.2020. Më datë 07.08.2020 ka filluar shqyrtimi i çështjes në seancë përgatitore në të cilin është thirrur edhe eksperti i caktuar. Eksperti i caktuar nuk është paraqitur dhe nuk ka njoftuar gjykatën për shkakun e mosparaqitjes. Në këto kushte gjykata ka vendosur caktimin e një eksperti tjetër dhe me qëllim njoftimin e tij seanca është shtyrë për në datë 14.10.2020. Gjatë seancës së datës 14.10.2020 ekspertit i është caktuar detyra. Seanca e ardhshme është lënë në datë 27.11.2020 në të cilën eksperti do të depozitonte aktin e ekspertimit. Në datë 27.11.2020 nuk është zhvilluar seanca për shkak të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore me vendimin nr.47/10 datë 11.11.2020 të Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për këtë shkak pas rifillimit të veprimtarisë gjyqësore, seanca përgatitore është caktuar për tu zhvilluar në datë 09.02.2021. Seanca e datës 09.02.2021 nuk është zhvilluar për shkak të gjyqtarit të çështjes i cili ka rezultuar i sëmur me Covid 19. Pas rikthimit në detyrë, seanca përgatitore është caktuar të zhvillohet në datë 27.04.2021. Gjatë seancës përgatitore datë 27.04.2021 eksperti ka depozituar aktin. Seanca është shtyrë për në datë 20.05.2021 me qëllim që palët të njihen me aktin e ekspertimit dhe për t'iu dhënë mundësi palëve të parashetrojnë pretendime, kundërshtime apo pyetje shtesë për ekspertin. Gjatë seancës përgatitore datë 20.05.2021 palët kanë debatuar rreth aktit, si dhe kanë ngritur pyetje për ekspertin. Pala e paditur ka ngritur pretendime mbi ekzistencën e shkaqeve që nuk lejojnë vijimin e gjykimit të çështjes, duke kërkuar pushimin e saj. Gjykata pasi ka dëgjuar pretendimet e palëve, duke e konsideruar çështjen komplekse ka vendosur të shprehet lidhur me vijimin e gjykimit në dhomë këshillimi në datë 15.06.2021.

Seanca në dhomë këshillimi nuk është zhvilluar duke u shtyrë për në datë 17.06.2021 për shkak se gjyqtari ka qenë i angazhuar në Kolegjin Zgjedhor. Në seancën në dhomë këshillimi të datës 17.06.2021 gjyqtari ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore në referim të nenit 158/c të K.Pr.C. Duke pasur parasysh se për shkak të vlerës së padisë gjykimi do të zhvillohej me trup gjykues, duke pasur parasysh edhe kalendarin e dy gjyqtarëve të tjerë, seanca gjyqësore është caktuar për tu zhvilluar në datë 17.09.2021.

Seanca gjyqësore e datës 17.09.2021 është zhvilluar, palët kanë parashtruar pretendimet e tyre, ndërsa ka filluar dhe marrja e provave; palët kanë debatuar rreth aktit të ekspertimit duke parashtruar pyetje shtesë. Seanca gjyqësore është shtyrë në datë 19.11.2021 me qëllim për ti lënë kohë ekspertit për të përgatitur përgjigjen e pyetjeve shtesë. Në seancën gjyqësore të datës 19.11.2021, eksperti ka parashtruar pamundësinë e dhënies së përgjigjeve bazuar në provat e administruara në gjykim deri në atë moment. Pala e paditur ka parashtruar se i ka disponon ajo aktet e nevojshme. Me qëllim që pala e paditur të paraqiste si prova aktet shkresore të kërkuara, seanca gjyqësore është shtyrë për në datë 17.12.2021. Seanca gjyqësore e datës 17.12.2021 nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes për arsye shëndetësore të një prej anëtarëve të trupit gjykues. Në këtë rast pala e paditur ke depozituar aktet shkresore të kërkuara si prova, të cilat i janë vënë në dispozicion ekspertit për të përfunduar aktin e ekspertimit. Seanca gjyqësore është caktuar për në datë 08.03.2022. Seanca e datës 08.03.2022 nuk është zhvilluar për shkak shëndetësorë të familjarëve të ekspertit (gjendje shëndetësore e rënduar e nënës së tij e cila referohet të ketë ndërruar jetë disa ditë më pas). Për shkak të mosparaqitjes së ekspertit seanca është shtyrë për në ditë 16.05.2022. Në seancën gjyqësore të datës 16.05.2022 eksperti ka parashtruar përsëri pamundësinë e dhënies së përgjigjeve me arsyetimin se aktet e paraqitura nga pala e paditur nuk ishin të plota. Pasi ka dëgjuar palët gjykata ka vendosur të marrë kryesisht provat e nevojshme për përfundimin e ekspertimit, duke e shtyrë seancën për në datë 09.06.2022.

Në datë 18.05.2022 pala e paditur ka dorëzuar në sekretarin gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë një kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes duke parashtruar ndër të tjera se:

- Gjykimi i çështjes vijonte që prej datës 10.10.2019;
- Kishte kaluar afati i arsyeshëm 2 vjeçar, deri në momentin e kërkesës kishin kaluar 2 vite e 8 muaj;
- Reforma nuk kishte ndikuar në kuptimin që çështja nuk kishte gjyqtarë të ndryshuar pjesë e trupit gjykues;
- Zhvillimi i procesit është pamundësuar vetëm për një periudhë dymujore (mars-maj 2020) për shkak të pandemisë.

Kërkuesi ka kërkuar përshpejtimin e procesit nëpërmjet:

- Caktimit të seancave gjyqësore jo më larg se afati 15 ditor;
- Moslejimin e kërkesave të paditësit me qëllim zvarritjen e procesit;
- Mospranimin e kërkesave të reja të paditësit me datë më të hershme dhe që nuk janë depozituar në kohën e kërkesë padisë;
- Mospërsëritjen e debateve në disa seanca gjyqësore pas asnjë qëllim.

Gjykata pasi ka marrë kryesisht provat, i ka vënë në dispozicion të ekspertit dhe palëve para datës 09.06.2022. Në seancën gjyqësore të datës 09.06.2022 eksperti ka depozituar aktin e ekspertimit shtesë, i cili është vënë në dispozicion të palës së paditur. Në këtë seancë nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, i cili ka kërkuar shtyrjen e saj për shkak të angazhimit të tij atë ditë në një proces tjetër gjyqësor. Kjo kërkesë nuk është

vlerësuar abuzive, duke u pranuar prej saj me arsyetimin se ishte hera e parë që përfaqësuesi i palës paditëse nuk paraqitej në gjykim, ndërsa kishte parashtruar edhe shkakun e pamundësisë. Nga ana tjetër gjykata ka urdhëruar njoftimin e aktit të ekspertimit shtesë palës paditëse duke shtyrë seancën gjyqësore për më datë 13.06.2022. Në seancën gjyqësore të datës 13.06.2022 eksperti ka relatuar aktin e ekspertimit shtesë ndërkohë që pala paditëse e ka kundërshtuar atë dhe ka kërkuar përjashtimin e ekspertit dhe caktimin e një eksperti tjetër. Kërkesa për përjashtimin e ekspertit është rrëzuar nga gjykata, por duke qenë se kundërshtimet kishin të bënin me pretendime të natyrës teknike, referuar në nenin 229 të K.Proc.Civile, gjykata i ka kërkuar ekspertit të japë sqarime në lidhje me to. Duke qenë se eksperti ka kërkuar kohë për të paraqitur me shkrim sqarimet e nevojshme, seanca gjyqësore është shtyrë për në datë 20.07.2022.

Referuar informacionit të përcjellë pranë Gjykatës së Apelit nga gjyqtari i çështjes parashtrohet ndër të tjera se: *"... Pretendimi se seancat janë larg nga njëra tjetra në kuadër të cenimit të afatit të arsyeshëm nuk qëndron. Kjo pasi shqyrtimi i çështjes kryhet nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë dhe seancat caktohen duke pasur parasysh kalendarin e gjyqeve të gjyqtarëve të cilat gjykojnë me një ngarkesë tepër të madhe për shkak të uljes së numrit të gjyqtarëve në gjykatës për shkak të procesit të veting-ut. Konkretisht gjyqtarja relatores ka në shqyrtim 965 çështje, anëtarët 1147 çështje dhe 636 çështje. Për pasojë nuk ka mundësi caktimi seancash gjyqësore më të afërta".*

Vlerësimi i gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në aspektin formal ka një kapërcim të afatit të arsyeshëm për përfundimin e gjykimit sikurse pala kërkuese pretendon, ndaj është rasti për të vënë në diskutim shkeljen e këtij afati në kuptimin substancial.

Lidhur me vlerësimin në aspektin substancial të shkeljes së afatit të arsyeshëm për përfundimin e çështjes civile në rastin konkret, gjykata e apelit ka çmuar se një vlerësim i tillë duhet të konsiderojë kompleksitetin e çështjes; sjelljen e palëve dhe personave të tjerë në gjykim; sjelljen e organit që po kryen procedurat dhe pamundësinë objektive për procedim.

Gjykata e apelit ka vlerësuar ndër të tjera se çështja ka qenë komplekse, kompleksitet që ka lidhje me faktet që duhen përcaktuar dhe natyrën e tyre, çka në rastin konkret ka kërkuar verifikimin e të dhënave të një sërë dokumenteve, ndërsa ka implikim dhe procedura e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Gjykata e apelit ka vlerësuar gjithashtu se palët me sjelljen e tyre si dhe personat e tjerë nuk duket se kenë shkaktuar vonesa të procesit gjyqësor. Paditësi ka parashtruar kërkesa për prova në vijim të atyre të paraqitura fillimisht, kjo për shkak të provave të paraqitura nga i padituri dhe në veçanti për shkak të problematikave të evidentuara nga ekspertimi ndërkohë që kjo e fundit është një provë shumë e rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes gjyqësore në shqyrtim. Në lidhje me kohën që është dashur për të marrë

si provë ekspertimin, gjykata e apelit parashtroi se ka ndikuar mosparaqitja në gjykim e ekspertit të parë, mosparaqitja për shkaqe të arsyeshme e ekspertit të dytë, si dhe mungesa e dokumentacionit të plotë të nevojshëm për realizimin e ekspertimit marrja e të cilit është bërë kryesisht nga gjykata dhe ky proces ka marrë një kohë të përcaktuar. Gjukata nuk mund të mbahet përgjegjëse për sjelljen e personave të tjerë të lidhur me çështjen në rastin konkret.

Gjukata e Apelit në lidhje me sjelljen e gjykatës dhe pamundësinë objektive për të proceduar ka vlerësuar se në rastin konkret kanë ekzistuar rrethana konkrete që kanë pamundësuar vijimin e procesit për periudha të caktuara kohore. Në vijim përmendet periudha e pandemisë mars-maj 2020 si dhe periudha disa javore më shumë se pesë muaj gjykata ka qenë në pamundësi për të vijuar procesin (rrethana shëndetësore që lidhen me gjyqtarët). Gjithashtu Gjukata e Apelit vlerëson se sjellja e gjykatës për drejtimin dhe menaxhimin e procesit gjyqësor sa i përket vazhdimit të gjykimit, lejitimin e marrjes së provave apo të debatit gjyqësor, në vlerësimin e Gjukatës së Apelit nuk mund të interpretohet se ka shkaktuar vonesa të paarsyeshme të procesit gjyqësor. Po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk mund të mbahet përgjegjëse për kohëzgjatjen e gjykimit mbi shkakun se ka lejuar marrjen e provave që ka vlerësuar të rëndësishme për procesin gjyqësor. Gjithashtu sjellja e gjykatës për drejtimin dhe menaxhimin e procesit gjyqësor sa i përket distancave kohore nëpërmjet seancave nuk mund të konsiderohet se ka shkaktuar vonesa të paarsyeshme të procesit, ndërsa rezultoi se gjykata të ketë qenë në kushtet e pamundësisë efektive për caktimin e seancave brenda një afatit të shkurtër kohor. Gjukata ka konkluduar në këtë mënyrë pasi është ndalur në tre momente. Së pari caktimi i seancave lidhet me kalendarin e gjykrimeve të tre gjyqtarëve, së dyti në lidhje me faktin se çështja në fjalë nuk futet në kategorinë e atyre çështjeve për gjykimin e të cilave ligji ka parashikuar afate kohore të shkurtra dhe së treti kryesuesja dhe anëtarët e trupit gjykues evidentohen të kenë një ngarkesë shumë të lartë çështjesh, dyfishin ose më tepër nga ajo në një situatë të zakonshme, kjo për shkak të reduktimit të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë gati në gjysmën e tyre, si pasojë e efekteve të shkaktuara nga procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

Gjukata e Apelit në prg.43 ka arsyetuar ndër të tjera se : *"Gjukata e Apelit vlerëson se nuk mund t'i kërkohet gjykatës së shkallës së parë marrja e masave për përshpejtim të procedurave, caktimin e seancave gjyqësore në distanca të shkurtra kohore (deri në 15 ditë), sa kohë ajo është duke ushtruar funksionet e saj sipas ligjit dhe duke ndjekur kritere transparente dhe objektive në caktimin e tyre brenda mundësive efektive të saj. Një interpretim i kundërt, i cili nuk do të merrte në konsideratë volumin shumë të madh të çështjeve dhe do të detyronte gjykatën të përshpejtonte procedurat pa u mbështetur në kritere objektive, do të shkaktonte pabarazi në trajtimin e çështjeve prej saj".*

Vendimi i Gjukatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, datë 04.07.2022:

Gjukata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është përfundimtar edhe i formës së prerë.

• Rasti II.

Çështja civile nr. 6243 është regjistruar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datë 15.05.2023 me objekt "Konstatimi i tej zgjatjes së procedurave sipas nenit 399/6 pika 1 duke pasur parasysh sjelljen e organit që po kryen procedurat si dhe çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, për zvarritje të ekzekutimit të vendimit duke mos i dhënë vendimit nr.1 datë 31.01.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë formë të prerë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Gjykata konstaton se në rastin konkret nuk jemi para një kërkesë për konstatimin e tejkallimit të afatit të arsyeshëm të procesit gjyqësor apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret kërkuesi ka paraqitur kërkesë për "Konstatimin e tej zgjatjes së procedurave, ... për zvarritje të ekzekutimit të vendimit duke mos i dhënë vendimit nr.1 datë 31.01.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë formë të prerë" duke pretenduar se sekretaria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nuk i jep vendimit nr 1 datë 31.01.2023 formë të prerë.

Gjykata në arsyetimin e saj parashtrohet ndër të tjera se:

"Konkretisht rezultoi e provuar nga aktet se arsyeja për të cilën nuk është vënë shënimi për marrjen formë të prerë në vendimin gjyqësor nga kryesekretaria lidhet me faktin se është paraqitur ankim kundër vendimit nr. 1 datë 31.01.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane për disponimin e ankimit. Aktet për shqyrtimin e këtij ankimi i janë përcjellë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Sa më sipër, Gjykata e Apelit konstaton se kërkuesi në thelb kërkon konstatimin e tejkallimit të afatit të arsyeshëm të procedurës administrative të vënies së shënimit formë të prerë nga ana e kryesekretarisë gjyqësore. Pra kërkuesi nuk kërkon konstatimin e tejkallimit të afatit të arsyeshëm të procesit gjyqësor (gjykimin) apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë sikurse parashikon neni 399 e vijues i K.Proc.Civile. Po ashtu nuk rezultoi të jetë kërkuar konstatimi i shkëlqes së afatit të arsyeshëm të procesit gjyqësor në apel, e cila gjithsesi do të ishte në kompetencën e gjykatës më të lartë për shqyrtim.

Për rrjedhim, Gjykata e Apelit vlerëson se jemi para rastit kur kërkesa/padia nuk mund të ngrihet për arsye se një kërkim i tillë si konstatimi i tejkallimit të afatit të arsyeshëm të procedurës administrative të vënies së shënimit formë të prerë nga ana e sekretarisë gjyqësore nuk parashikohet si mjet për t'ju drejtuar gjykatës në procedurën civile".

Vendimi i gjykatës së Apelit datë 17.10.2023:

Gjykata e Apelit arrin në përfundimin se duke pasur parasysh përmbajtjen e kërimit dhe shpjegimet e palës kërkuese në kërkesë, kërkesa nuk mund të ngrihet e duhet te vendoset pushimi i saj.

6.3 Kërkesat për shpërblimin e dëmit

Nga inspektimi i zhvilluar u konstatua se sistemi i menaxhimit të çështjeve në gjykatë nuk bën një nënndarje të natyrave të ndryshme përsa i takon kërkesave me objekt "shpërblim dëmi" duke e bërë të pamundur identifikimin e kërkesave të shpërblimit të dëmit që lidhen me shkeljen e afatit të arsyeshëm në kuptim të nenit 399/6 pika 2 dhe 3 të K.Pr.C.

7. KONKLUZIONE

Inspektimi u zhvillua në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile dhe arriti qëllimin e tij për tu njohur me veprimtarinë administrative dhe gjyqësore të kësaj gjykate në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023-31.05.2023.

Duke pasur si burim të dhënat e pasqyruara në regjistrat manual, në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore si dhe të dhënat statistikore, inspektimi fillimisht u orientua drejt verifikimit të llojit të të dhënave dhe saktësisë së tyre. Saktësia e të dhënave statistikore në rastin konkret paraqet një rëndësi të veçantë, jo vetëm për matjen e performancës dhe efikasitetit të gjykatës por gjithashtu edhe për sigurimin e transparencës, forcimin e llogaridhënies, evidentimin e problematikave si dhe identifikimin e nevojave për përmirësim të vazhdueshëm të veprimtarisë administrative dhe gjyqësore. Statistikat jo të plota apo me gabime shtrembërojnë panoramën reale të gjendjes së gjyqësorit duke sjellë si pasojë vlerësime jo të sakta dhe hartimin e strategjive jo efektive të cilat nuk përmbushin qëllimin për rritjen e cilësisë, efektivitetit dhe efikasitetit të gjykatës.

Nga analiza e të dhënave që përmban regjistri fizik i shënuar "Numërori i vendimeve civile" (duke ju referuar vetëm të dhënave që pasqyrojnë kohëzgjatjen e proceseve nga momenti i paraqitjes së kërkesë padive në gjykatë deri në shpalljen e vendimeve për periudhën 01.03.2023-31.05.2023), konstatohet se ka mungesë të të dhënave në lidhje me vendimet që duhet të përmbajë numërori; të dhënat e pasqyruara jo gjithmonë përputhen me të dhënat statistikore si dhe në hedhjen e të dhënave ka gabime të konsiderueshme.

Nga analiza e të dhënave statistikore të cilat janë përdorur si burim për kryerjen e inspektimit, konstatohet se në këto të dhëna nuk pasqyrohen rrethana të rëndësishme të cilat mund të karakterizojnë një çështje. Konkretisht nuk evidentohen rishortimet e çështjeve; nuk përcaktohet koha kur gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjen; nuk identifikohen 2 anëtarët e tjerë të trupit gjykues si dhe mungon informacioni mbi faktin nëse çështja ka qenë ose jo e pezulluar.

Referuar "shënimeve" të procesverbaleve të seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore konstatohet se ka raste kur nuk identifikohet lloji i

seancës nëse është përgatitore apo gjyqësore. Gjithashtu ka raste kur referuar shënimeve të procesverbalit nuk kuptohet shkaku i shtyrjes së seancës.

Gjatë periudhës së inspektimit ka hyrë në fuqi vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.148 datë 29.03.2023 "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisve të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë me zyrë shërbimi". Në nenin 15 të këtij vendimi parashikohet ndër të tjera se: "*Këshilli i gjykatës pritëse, brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, miraton strukturën, organikën, si dhe përshkrimet e hollësishme të punës, duke i përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës*".

Funksionimi dhe organizimi i brendshëm i gjykatës edhe gjatë vitit 2023 ka vijuar të normohet nga rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor miratuar me urdhrin e Kryetarit të Gjykatës nr.209 datë 27.10.2017. Gjithashtu në analizën vjetore 2023 të gjykatës (në fq.4 dhe 27) është parashtruar se Këshilli i Gjykatës ka miratuar vendimin nr.107 datë 04.04.2023 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe përshkrimet e punës të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë". Kjo gjykatë ka vënë në dispozicion të ILD-së vetëm rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e gjykatës të miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës nr. 209 datë 27.10.2017 e cila ndodhet e publikuar edhe në faqen zyrtare të gjykatës.

Sipas të dhënave të raporteve vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor konstatohet se organika e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhoma penale dhe civile) për vitin 2022 rezulton e plotësuar në masën 52% sa i takon trupës gjyqësore dhe 98 % sa i takon administratës gjyqësore. Ndërsa për vitin 2023 organika rezulton e plotësuar në masën 54% sa i takon trupës gjyqësore, dhe 93 % sa i takon administratës gjyqësore.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton të jetë gjykata me numrin më të lartë të çështjeve të mbartura për vitin 2023 me një numër total 19275 çështje që përbën 48% të stokut total për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Po ashtu kjo gjykatë rezulton të ketë regjistruar edhe numrin më të lartë të çështjeve të reja gjatë vitit 2023 konkretisht 31833 çështje, që përbëjnë 38% të totalit të çështjeve të regjistruara në nivel kombëtar për këtë grup gjykatash.

Për vitin 2022 ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm ka qenë 776 çështje për gjyqtar, ndërkohë që pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë një gjyqtar ka pasur në ngarkim mesatarisht 1361 çështje.

Për vitin 2023 ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar pranë gjykatave të të njëjtit nivel gjyqësor ka qenë 841.7 çështje për gjyqtar, ndërkohë që pranë Gjykatës së Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë një gjyqtar ka pasur në ngarkim mesatarisht 1176 çështje.

Në vitin 2022 rendimenti mesatar i punës për gjyqtar pranë gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, ka qenë 563 çështje të gjykuara për gjyqtar, ndërkohë që 1 gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka gjykuar mesatarisht 872 çështje.

Në vitin 2023 rendimenti mesatar i punës për gjyqtar pranë gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm është 547 çështje për gjyqtar, ndërkohë që 1 gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka gjykuar mesatarisht 718 çështje. Ky tregues përbën nivelin më të lartë të çështjeve të gjykuara për gjyqtar në raport me rendimentin mesatar të gjyqtarëve të të njëjtit grup gjykatash.

Gjithashtu referuar të dhënave të raportit vjetor të KLGJ-së për vitin 2023 rezulton se koha mesatare për likuidimin e një çështje civile për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm është 272 ditë, ndërsa koha mesatare për gjykimin e një çështje civile nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është 332 ditë.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e ushtron veprimtarinë në dy dhoma përkatësisht dhoma Penale dhe dhoma Civile. **Për vitin 2023 numri i gjyqtarëve në organikën e miratuar të kësaj gjykate është 80 gjyqtarë ndërkohë që efektivisht kanë ushtruar detyrën gjatë vitit 2023 vetëm 43.5 gjyqtarë.**

Dhoma Civile është e organizuar në dy seksione, në seksionin civil-tregtar dhe seksionin familjar. Sipas analizës vjetore të vitit 2023 të vet gjykatës, numri i gjyqtarëve që kanë ushtruar funksionin në dhomën civile gjatë vitit 2023 ka qenë 31 gjyqtarë përkatësisht 25 gjyqtar në seksionin civil-tregtar dhe 6 gjyqtarë në seksionin familjar.

Përkatësisht gjatë periudhës objekt inspektimi 01 mars 2023 - 31 maj 2023, në dhomën civile kanë ushtruar funksionin 26 gjyqtarë¹³¹.

Në këtë gjykatë, në dhomën civile ka 19 salla gjykimi me sistem audio dhe se për shkak të mungesës së numrit të sallave të gjykimit në raport me numrin e gjyqtarëve, seancat gjyqësore zhvillohen nga gjyqtarët në sallat e gjykimit në bazë të një kalendari të miratuar paraprakisht nga Këshilli i Gjykatës. Referuar raportimit të vet gjykatës për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio vërehet se një numër i konsiderueshëm i proceseve gjyqësore janë zhvilluar pa regjistrim audio.

¹³¹ Referuar informacionit të marrë me procesverbalin datë 04.11.2024. Me emailin e datës 11.11.2025 gjykata na ka informuar se referuar tabelës statistikore numri i gjyqtarëve që kanë dhënë vendime është: "27", për shkakun se gjyqtarja A.K (e cila ushtronte detyrën në dhomën penale për periudhën në fjalë) ka shpallur vetëm një vendim për një çështje të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe si pasojë është mbartur nga gjykata pas bashkimit të dy gjykatave në një.

Për vitin 2023 dhoma civile ka mbartur 16577 çështje nga viti 2022 prej të cilave 9532 janë çështje themeli me palë kundërshtare¹³².

Gjatë vitit 2023 në dhomën civile janë regjistruar gjithsej 34.500 çështje të reja ku përfshihen çështje civile themeli, kërkesa civile, urdhra ekzekutimi dhe çështjet OJF. Gjatë vitit 2023 kanë përfunduar gjithsej 18225 çështje të kësaj kategorie.

Referuar të dhënave statistikore, gjatë periudhës 3 mujore objekt inspektimi, përkatësisht nga data 01.03.2023 - 31.05.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhoma civile) ka shpallur 1748 vendime.

Këto 1748 vendime janë shpallur nga 27 gjyqtarë duke pasur parasysh këtu faktin se 5 prej këtyre të fundit i janë bashkuar kësaj gjykate përkatësisht gjatë muajit mars, prill ose maj të vitit 2023, ndërsa 1 gjyqtar ka shpallur vetëm një vendim.

Koha mesatare e gjykimit për 1748 çështjet civile me palë kundërshtare të përfunduara për periudhën 01.03.2023-31.05.2023 konstatohet se është 398 ditë.

Nga analiza e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore sipas llojit të objektit të padisë konstatohet se koha mesatare më e shkurtër i referohet gjykimit të çështjeve me objekt padie "Lëshim urdhër mbrojtje", të cilat kanë një kohëzgjatje mesatare prej 10 ditësh. Pas këtyre çështjeve, kohëzgjatja më e shkurtër e gjykimit u vërejt tek çështjet me objekt "Kundërshtimin e veprimeve përbarimore".

Në vijim, në rend kronologjik sipas kohës së gjykimit, u konstatua se çështjet me objekt¹³³ "Padë pronësie" kanë një kohëzgjatje mesatare prej 369 ditë; paditë kontraktuale/paditë për mbrojtjen e pronës intelektuale/paditë posedimore/paditë pjesëtim sendi/vërtetim fakti/paditë të tjera civile/paditë civile me masë sigurimi, kanë një kohëzgjatje mesatare prej 387 ditë; paditë me objekt "zgjidhje martesë" kanë një kohëzgjatje prej 411 ditë; paditë "Për përmbushjen e një detyrimi civil" kanë një kohëzgjatje prej 432 ditësh; paditë në lidhje me "Përmbushjen e një detyrimi tregtar" kanë një kohëzgjatje prej 510 ditë; paditë në lidhje me "kontratat e huas" kanë një kohëzgjatje prej 571 ditë; paditë në lidhje me "Marrëdhëniet e punës" dhe "Kontrata e qeras" kanë një kohëzgjatje mesatare të barabartë prej 610 ditësh; paditë me objekt "kontratë sipërmarrje"; "Shkaktim dëmi" dhe "Kontratë shitje" kanë një kohëzgjatje mesatare përkatësisht 640 ditë, 667 ditë, 692 ditë.

Çështjet e tjera të cilat janë gjykuar për një kohë mesatare më të gjatë në raport me paditë e sipërcituara janë "Paditë tjera kontraktuale" si dhe "Paditë pagim shume civile" të cilat kanë zgjatur përkatësisht 900 ditë.

¹³² Referuar analizës vjetore të gjykatës.

¹³³ Referuar kategorizimit të çështjeve sipas tabelës me të dhënat statistikore të vëna në dispozicion nga gjykata.

Koha mesatare më e gjatë e gjykimit përkatësisht 1145 ditë ka të bëjë me gjykimin e çështjeve me objekt "Padi të tjera çështje tregtare".

Gjatë periudhës objekt inspektimi pranë gjykatës është depozituar vetëm një kërkesë me objekt "Konstatim shkelje dhe përshpejtim procedurash". Kjo kërkesë ka për objekt "Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e detyrimit që rrjedh nga vendimi gjyqësor" dhe në këto kushte kërkesa është shqyrtuar nga vetë gjykata¹³⁴ ku është paraqitur kërkesa e cila ka vendosur pushimin e gjykimit.

Ndërsa Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar dy kërkesa me objekt "Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhoma civile)". Në lidhje me këto kërkesa kjo gjykatë ka disponuar me dy vendime gjyqësore përkatësisht me një vendim për "Rrëzim kërkesë" dhe një vendim për "Pushimin e gjykimit".

Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore nuk ofron një nënndarje të natyrave të ndryshme të kërkesave me objekt "shpërblim dëmi" duke e bërë të pamundur identifikimin e kërkesave të shpërblimit të dëmit që lidhen me shkeljen e afatit të arsyeshëm në kuptim të nenit 399/3 dhe 396 pika 2 i K.Pr.C., identifikim që mund të kryhet vetëm duke parë dosjet fizikisht.

Nga studimi i shkaqeve të shtyrjes së seancave konstatohet se arsyet më të zakonshme lidhen me disa kategori:

- **Shkaqe që lidhen me vetë gjykatën.** Ku përfshihen rastet e shtyrjeve të seancave për shkak të kalimit të çështjes në seancë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtare; për t'i dhënë mundësi anëtarit të trupit gjykues të njihet me çështjen; mungesa e gjyqtarit të çështjes për shkaqe shëndetësore apo shkaqe të tjera; për mos formim të trupit gjykues; për shkak të largimit të gjyqtarit me dorëheqje ose pezullimit/shkarkimit të gjyqtarëve si rrjedhojë e procesit të vetingut si dhe për shpalljen e vendimit.
- **Shkaqe që lidhen me mos marrjen dijeni të të paditurit për seancën e parë** - Gjykata shtyn seancën me qëllim njoftimin e të paditurve duke përsëritur njoftimin.
- **Shkaqe që lidhen me mungesën e tagrave të përfaqësimit ose konstatimin e të metave të aktit të përfaqësimit** - Gjykata shtyn seancën për t'i dhënë mundësi përfaqësuesit të palës të paraqes prokurën e posaçme.
- **Shkaqe që lidhen me njoftimin e personit të tretë** - Gjykata pranon kërkesën e palës paditëse dhe shtyn seancën me qëllim njoftimin e personave të tretë.
- **Shkaqe që lidhen me njohjen e personave të tretë me kërkesë padinë dhe provat** si dhe me dhënien mundësi të personave të tretë të paraqesin provat e pretenduara prej tyre. Është konstatuar se ka raste kur gjykata ka shtyrë 4 seanca përgatitore rresht për këtë shkak.

¹³⁴ Neni 399/6, pika 1, shkronja "ç" e K.Pr.C.

- **Shkaqe që kanë lidhje me caktimin e ekspertit dhe aktin e ekspertimit.** Konstatohet se në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore një ndikim të konsiderueshëm ka edhe mënyra se si gjyqtari procedon në lidhje me caktimin, afatet, njohjen me aktin si dhe procedurën në tërësi të ekspertimit. Gjithashtu është konstatuar se në mënyrë të përsëritur ekspertët nuk dorëzojnë aktin në afatin e dakortësuar më parë. Gjithashtu është konstatuar se në datën kur pritej të dorëzohej akti i ekspertimit, gjykata ka vendosur t'ë pajisë ekspertin me autorizim.

- **Shkaqe që kanë lidhje me pezullimin e veprimtarisë gjyqësore** – për shkak të marrjes së masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

- **Shkaqe që kanë lidhje me kalimin procedural.**

Nga analiza e shkaqeve të shtyrjes së seancave vihet re se një pjesë e konsiderueshme e këtyre shtyrjeve lidhet me rastet kur pala ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit në fillim të procesit ose në vijim të tij.

Ajo çfarë vihet re është fakti se palët paraqesin kërkesat në vijim të procesit kur nuk pajtohen me qëndrimin e gjykatës. Në këtë kontekst tërheqim vëmendjen se çdo magjistrat dhe aq më tepër kur magjistrati është duke ushtruar detyrën e gjyqtarit në seancë gjyqësore, gjatë gjykimit me dyer të hapura, në prezencë të palëve, duhet të manifestojë një sjellje të kujdesshme, me objektivitet, vetëpëmbajtje dhe maturi. Gjyqtari duhet të marrë masat për të ruajtur standardin e gjyqtarit të përgjegjshëm dhe profesionist. Paanësia duhet të jetë e dukshme gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore të gjyqtarit. Gjyqtari duhet të marrë masa për të shmangur çdo lloj situatë në të cilën individët mund të ndiejnë se po ndërmerret një qasje e njëanshme dhe t'i adresoj këto situata në një mënyrë që të rrisë besimin dhe respektimin e palëve dhe publikut në tërësi për gjykatën.

Në kohëzgjatjen e gjykimit ndër të tjera ka ndikuar edhe koha e shqyrtimit të kërkesave për përjashtim të gjyqtarit, për shqyrtimin e të cilave Kodi i Procedurës Civile në ndryshim nga Kodi i Procedurës Penale¹³⁵, nuk parashikon afat ligjor. Në këto raste gjykata duhet të mbaj parasysh se në referim të nenit 75 të K.Pr.C, kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk mund të shkaktoj pezullimin e procesit por vetëm faktin që gjyqtari për të cilin është kërkuar përjashtim nuk mund të jap ose të marr pjesë në dhënien e vendimit derisa gjykata të disponoj në lidhje me kërkesën për përjashtim. Referuar parashikimit ligjor se gjyqtari për të cilin kërkohet përjashtim nuk mund të përfshihet në vendimmarrje, shqyrtimi i kërkesës për përjashtim gjyqtari duhet të zhvillohet pa vonesë me qëllim shmangien e zvarritjes së gjykimit. Gjithashtu gjyqtari, i cili e shqyrton këtë kërkesë në dhomë këshillimi, në rast se vendos të papranueshme kërkesën, duhet të mbaj në vëmendje nenin 76 të K.Pr.C. i cili parashikon vendosjen e gjobës në ngarkim të palës që duke abuzuar ka parashtruar një kërkesë të padrejtë.

¹³⁵ Neni 22 pika 3 e Kodit të Procedurës Penale "Gjykata pasi merr të dhënat e nevojshme, vendos për kërkesën e përjashtimit brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës".

Nga analiza e shkaqeve të shtyrjeve të seancave konstatohet se një pjesë e shtyrjeve të tyre kanë ndodhur për shkak se gjyqtarët janë përfshirë në angazhime të tjera. Vlerësojmë se gjyqtarët duhet të mbajnë parasysh se ushtrimi i funksionit si gjyqtar ka përparësi mbi të gjitha aktivitetet e tjera dhe se gjyqtari duhet të kujdeset që angazhimi i tij në veprimtari jashtëgjyqësore të mos cenoj kryerjen me përkushtim të detyrave gjyqësore.

Në lidhje me distancën kohore nga seanca në seancë, konstatohet se gjatë vitit 2019 seancat janë caktuar 1 (një) ose 2 (dy) seanca brenda një muaji. Gjatë vitit 2020 e në vijim distancat kohore janë më të gjata edhe për shkak të "Marrjes së masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19) në bazë të aktit normativ nr.9 datë 25.03.2020 si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.127 datë 10.03.2020 "Për pezullimin e veprimtarisë gjyqësore në të gjithë gjykatat e Republikës së Shqipërisë".

Kur gjykata e ka shtyrë seancën përtej muajit gusht apo përtej muajit dhjetor, konstatohet se ka relatuar edhe faktin e caktimit të një afati më të gjatë kohor sikurse ka qenë periudha e lejes vjetore të gjyqtarëve ose periudha e mbartjes së dosjeve në vitin pasardhës. Pavarësisht se Kodi i Procedurës Civile nuk përcakton afat për distancën kohore midis seancave¹³⁶, gjykata duhet të organizoj punën dhe të përcaktoj afatet e nevojshme në kuadër të zhvillimit sa më të mirë të procesit gjyqësor brenda një kohëzgjatje të arsyeshme.

Kodi i Procedurës Civile me ndryshimet që ka pësuar me ligjin nr.38/2017 e në vijim, duke parashikuar rregullime procedurale që kanë të bëjnë me shmangien e shkaqeve që sjellin zvarritje të proceseve gjyqësore civile, supozohet të nxisë efencën dhe efektshmërinë e sistemit të drejtësisë¹³⁷. Në këtë kontekst, janë parashikuar në Kod rregulla procedurale që kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjes jo vetëm me pajtim por edhe me ndërmjetësim (nenet 25, 158/ç i K.Pr.C); me abuzimin me të drejtat në proces (neni 34 i K.Pr.C); bashkimi i padive (neni 57); rregulla më të detajuara në lidhje me "thirrjen në gjykatë"; "njoftimin shkresor të akteve"; "pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve" në lidhje me përcaktimin e personit të autorizuar për marrjen e njoftimeve (nenet 129,130,131,179,133); janë shtuar rregulla në lidhje me mënyrën e njoftimit me shpallje publike (neni 133/a), etj.

Gjithashtu janë parashikuar në formën e një liste veprimet e nevojshme për t'u kryer nga gjyqtari pa caktuar seancë përgatitore ndër të cilat përmenden këto veprime: gjyqtari përjashton paditësin nga tarifa gjyqësore sipas rastit; cakton provat që do të merren në shqyrtim në seancë gjyqësore; cakton ekspertin të cilin u'a njofton palëve; vendos për marrjen e provave dhe informacioneve tek të tretët sipas rastit; vendos për marrjen e

¹³⁶ Neni 171/a i K.Pr.C

¹³⁷ Shiko "Raport për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116 datë 29.03.1996 "Kodi i procedurës civile i R.SH", i ndryshuar.

masave për sigurimin e padisë, sigurimin e provës, pezullimin e gjykimit, sipas rastit në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

Nga analiza e çështjeve objekt inspektimi konstatohet se ka vend për përmirësim të veprimtarisë së gjyqtarëve në drejtim të përdorimit më të mirë të dispozitave ligjore të sipërcituara si dhe të burimeve të tjera të gjykatës me qëllim që proceset gjyqësore të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

Gjyqtari me marrjen dijeni se është caktuar si gjyqtar për çështjen konkrete duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe vendimet në kuadër të mirë administrimit të procesit gjyqësor për respektimin e afateve ligjore si dhe të afateve orientuese¹³⁸. Në vijim të këtij arsyetimi vlerësojmë se efektshmëria e procesit gjyqësor varet nga veprimtaria e gjyqtarit që në fazën fillestare të procesit¹³⁹ e cila konsiston në vlerësimin pa vonesë të kushteve të kërkesë padisë dhe studimit paraprak të akteve bashkëngjitur si dhe në ndërmarrjen e veprimeve paraprake të përcaktuara në nenin 158/a të K.Pr.C (sipas rastit), të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Kjo veprimtari paraqet rëndësi duke pasur parasysh edhe parashikimet ligjore se disa veprime të caktuara procedurale mund të kryhen vetëm derisa nuk është nxjerr urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

Gjithashtu konstatohet se ka vend për përmirësimin e veprimtarisë së gjykatës përsa i përket qëndrimit që duhet të mbaj ndaj veprimeve apo mosveprimeve, të palës ose përfaqësuesit të saj/ të dëshmitarit / të ekspertit/ të një personi të tretë që nuk është palë, që shkaktojnë zvarritjen e procesit.

Përsa më sipër, gjykata gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor duhet të jetë në gjendje të identifikoj sjelljen e palës apo përfaqësuesit të saj në rast se abuzojnë me të drejtat procedurale për të shmangur seancat joproductive. Në këtë kontekst gjykata duhet të jetë aktive me qëllim marrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin e kësaj sjellje si dhe ndëshkimin e palës përgjegjëse duke urdhëruar gjëbajtjen e saj në referim të nenit 34 të K.Pr.C.

Jo vetëm palët por edhe personat e tjerë që marrin pjesë apo asistojnë në gjykimin e një çështjeje janë të detyruar në bazë të ligjit të japin ndihmesën e tyre për zhvillimin normal të hetimit gjyqësor dhe në rast se ata nuk u binden urdhrave të gjykatës, gjykata është e detyruar të marri masat e nevojshme në respektim të nenit 165-168 të K.Pr.C.

Gjykata duhet të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose t'i njoftoj e t'i udhëzoj për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.

Në përfundim vlerësojmë se gjykata ka për detyrë të zhvilloj një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin. Ajo duhet të ushtroj të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile të

¹³⁸ Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.433 datë 22.07.2025 ka miratuar afatet standarde minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve gjyqësore.

¹³⁹ Neni 153 i K.Pr.C "Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesë padisë me shkrim".

nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor dhe duhet të përdor gjithë autoritetin e saj me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektshmërisë së procesit gjyqësor.

Gjyqtarët duhet të mbajnë në vëmendje se gjykimi brenda një afati të arsyeshëm është e drejtë kushtetuese e individit dhe pavarësisht nga situata ku ndodhet sistemi i drejtësisë, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që gjykimet të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

8. REKOMANDIME

1. Rekomandime për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhoma civile.

- Raporti i inspektimit t'i njoftohet të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile, në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese si dhe me qëllim që gjyqtarët, me marrjen në dorëzim të çështjeve për shqyrtim e në vijim, të mbajnë në konsideratë e t'i kushtojnë kujdesin e duhur:
 - Veprimtarisë gjyqësore të zhvilluar para nxjerrjes së "Urdhrit për caktimin e seancës gjyqësore" në drejtim të përcaktimit të masave dhe vendimmarrjeve të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor sipas një rendi kronologjik në respektim të rregullave procedurale të përcaktuara në nenin 153-158/b të K.Pr.C., që lidhen me vlerësimin e kushteve të kërkesë padisë dhe akteve bashkëngjitur, me veprimet paraprake dhe vendimet e gjyqtarit gjatë kësaj faze si dhe me seancën përgatitore (sipas rastit).
 - Veprimtarisë gjyqësore që lidhet me drejtimin/zhvillimin e seancave, përse i përket parandalimit dhe marrjes së masave të nevojshme ndaj abuzimit të palëve me të drejtat procedurale por edhe ndaj sjelljes së personave pjesëmarrës në proces apo që asistojnë procesin kur kjo sjellje mund të bëhet shkak për zvarritjen e procesit në referim të neneve 34,101/2,165-168 të K.Pr.C.
 - Evitimit të shtyrjes së seancave të shkaktuara nga vetë gjykata për shkak të mosnjoftimit të rregullt të palëve¹⁴⁰; mungesës së koordinimit midis anëtarëve të trupit gjykues; përfshirjes së gjyqtarëve në angazhime të tjera; moskryerjes së veprimeve procedurale paraprake të nevojshme; mos vlerësimi të duhur të kërkesave për shtyrje si dhe në mënyrë të veçantë keqadministrimit të procesit të marrjes së provës me ekspert.

¹⁴⁰ Neni 128 i K.Pr.C "Njoftimi i akteve bëhet sipas mënyrave të parashikuara në këtë kre. Gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga punonjësit e gjykatës të caktuar për realizimin e tij".

- Veprimtarisë gjyqësore që ka të bëjë me detyrën e gjykatës për të bërë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes përmes ndërmjetësimit në referim të nenit 25 dhe 158/ç të K.Pr.C.
- Veprimtarisë gjyqësore që ka të bëjë me shqyrtimin pa vonesë të kërkesës për përjashtim të gjyqtarit si dhe me zbatimin e sanksioneve të parashikuara nga neni 76 i K.Pr.C ndaj palës abuzuese, duke qenë se vonesa në shqyrtimin e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në ecurinë e procesit gjyqësor.

Ky rekomandim të zbatohet menjëherë.

- Këshilli i Gjykatës në referim, neni 38 të Ligjit nr.98/2016 të rishikoj rregulloren e brendshme të gjykatës duke e përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës, në bazë dhe për zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.148 datë 29.03.2023.

Këshilli i Gjykatës, të mbaj në vëmendje që në përshkrimet e punës të parashikuara në rregulloren e rekomanduar, të përcaktoj rregulla të hollësishme në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të gjykatës të ngarkuar me hedhjen e të dhënave në regjistrat fizikë, në sistemin e menaxhimit të çështjeve si dhe në procesverbalet e seancave, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe identifikimin e qartë të përgjegjësisë në lidhje me këtë proces.

Ky rekomandim të zbatohet brenda muajit dhjetor të vitit 2025.

- Kancelari i gjykatës të marri masa për mbikëqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin e saktë të të dhënave statistikore në referim, nenit 39, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 98/2016 si dhe vendimit nr.47 datë 11.02.2021 "Për miratimin e udhëzuesit për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave".

Ky rekomandim të zbatohet brenda muajit dhjetor të vitit 2025.

- Kryetari i Gjykatës të marri masa që në regjistrat fizikë civilë dhe në të dhënat statistikore, të pasqyrohen minimalisht tregues lidhur me: rishortimet (duke shënuar datën e rishortimit dhe gjyqtarët e ricaktuar) si dhe pezullimin e çështjes (nëse çështja ka qenë e pezulluar).
- Kryetari i gjykatës, në konsultim me Këshillin e Lartë Gjyqësor të vlerësoj mundësinë e lidhjes së marrëveshjes me shërbimin postar me qëllim rritjen e aftësisë së punonjësve të këtij shërbimi për të realizuar në mënyrë të rregullt dhe me efikasitet procedurën e njoftimeve gjyqësore.
- Kryetari i Gjykatës, në konsultim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, të vlerësoj mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve me Dhomën Kombëtare të Avokatisë për krijimin e mekanizmave të përshtatshëm që mundësojnë njoftimin e përfaqësuesve të

palëve ndërgjyqëse nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në referim të nenit 129 dhe 141 të K.Pr.C.

- Kryetari i gjykatës, përsa i përket transparencës së veprimtarisë së gjykatës, të marrë masa që në vijim publikimi i tabelave standarde të kryhet në mënyrë të rregullt brenda dy javëve, pas përfundimit të çdo periudhe raportuese, në zbatim të nenit 37, shkronja "gj" të ligjit nr. 98/2016 si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 47 datë 11.02.2021.

Këto rekomandime të zbatohen brenda muajit dhjetor 2025.

2. Rekomandime për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Rekomandime mbi legjislacionin:

- Duke pasur parasysh se Këshilli i Lartë Gjyqësor në referim të nenit 93 të ligjit 115/2016 është përgjegjës për të shprehur mendime dhe për të paraqitur propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin që ndikon në funksionimin e sistemit gjyqësor, të vlerësohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mundësia e paraqitjes së një propozimi për ndryshimin e Kodit të Procedurës Civile përsa i përket dispozitave ligjore mbi "Përfundimin e gjyqarit, kërkesës për përfundim"¹⁴¹, duke përcaktuar një afat ligjor brenda të cilit gjyqtari duhet të vendos mbi kërkesën për përfundim.

Rekomandime në lidhje me organikën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile

- Këshilli i Lartë Gjyqësor, si institucioni përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata¹⁴², duhet të marrë masa efektive dhe të menjëhershme për plotësimin e organikës së gjykatës duke pasur parasysh ndikimin që ka performanca e kësaj gjykate në perceptimin e publikut në sistemin e drejtësisë duke qenë gjykata me numrin më të lartë të çështjeve gjyqësore civile me palë kundërshtare në raport me gjykatat e tjera të të njëjtë lloj.

Ky rekomandim të zbatohet brenda vitit 2026

Rekomandime në lidhje me administrimin e infrastrukturës

- Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës dhe Këshillin e Gjykatës të vlerësoj marrjen e masave për mundësinë e shfrytëzimit të ambienteve të gjykatës në mënyrë që gjykimi i të gjitha çështjeve civile me palë kundërshtare të zhvillohet në salla gjykimi të pajisura me regjistrim audio.

Ky rekomandim të zbatohet brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026.

Rekomandime në lidhje me sistemin e teknologjisë së informacionit:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor të marri masa për t'i siguruar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë akses të plotë (jo të kufizuar) në sistemin e teknologjisë së informacionit

¹⁴¹ Neni 75 i K.Pr.C

¹⁴² Neni 90, pika 1, i ligjit nr. 115/2016

që administrohet nga gjykata, duke përfshirë regjistrimet audio të seancave si dhe qasjen e plotë në informacion përsa i përket çështjeve të përfunduara minimalisht nga viti 2020 e në vijim¹⁴³, në referim të nenit 92 të ligjit nr.115/2016 si dhe pikës 12 të VKM nr. 971 dt. 02.12.2020.

Ky rekomandim të zbatohet brenda tremujorit të parë të vitit 2026.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore të gjykatës, në referim të nenit 92, pika "e", "ë", "f" dhe "g" të ligjit nr.115/2016, duke e përshtatur atë në mënyrë që ILD-së t'i sigurohet akses i plotë për gjurmimin e informacionit që mundëson monitorimin e respektimit të rregullave procedurale nga gjyqtarët (dhoma civile) gjatë gjithë fazave të procesit gjyqësor, përfshirë: datën e marrjes në dorëzim të dosjes nga gjyqtari, veprimtarinë gjyqësore lidhur me veprimet paraprake si dhe numrin e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore për secilën çështje.

Ky rekomandim të zbatohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

Rekomandime në lidhje me rregullat standarde për eficientë dhe cilësinë e drejtësisë në referim të nenit 94 pikat 4 dhe 5 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"

- Këshilli i Lartë Gjyqësor në referim të nenit 94, pika 4, shkronja a) dhe b) si dhe pikës 5, shkronja a) dhe b) të ligjit nr.115 datë 2016, të monitorojë zbatimin në praktikë të afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore, të miratuara me vendimin e KLGJ Nr. 433 datë 22.07.2025 dhe të përcaktoj rregullat standarde që do të përdoren nga gjykata për përcaktimin e këtyre afateve në gjykimin e çështjeve gjyqësore civile me palë kundërshtare, përfshirë kur është e mundur edhe afatet për fazat kryesore të procedurës gjyqësore, duke u mbështetur ndër të tjera në parimet e barazisë, efektivitetit, transparencës dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor në referim të nenit 94, pika 4, shkronja f) të ligjit nr.115/2016, të vlerësojë mundësinë e miratimit të modeleve të vendimeve gjyqësore që mund të shërbejnë si modele standard për gjyqtarët e rinj, por edhe për gjyqtarët e tjerë me qëllim lehtësimin e punës së tyre dhe rritjen e eficientë.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor në referim të nenit 94, pika 4, shkronja ç) dhe ë) të ligjit nr.115/2016, të miratojë rregulla standarde për monitorimin e kohëzgjatjes së pezullimeve që vijnë si rezultat i mosveprimit nga palët ose gjykata si dhe udhëzues për monitorimin e shtyrjeve të seancave gjyqësore.

Këto rekomandime të zbatohen brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

¹⁴³ Neni 117 i ligjit nr.96/2016 "Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve"

Rekomandime në lidhje me të dhënat statistikore:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor në respektim të nenit 89, shkronja b)¹⁴⁴, nenit 94, pika 4, shkronja ç) dhe dh)¹⁴⁵ të ligjit nr.115 datë 2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të miratojë rregulla standarde me qëllim paraqitjen në të dhënat statistikore të treguesve që lidhen me: pezullimin e gjykimit të çështjes në referim të nenit 297 të K.Pr.C; rishortimin e çështjes si dhe veprimtarinë paraprake gjyqësore.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor të miratojë rregulla standarde që të dhënat që pasqyrohen në procesverbalet e seancave të printuara nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjykatës të përmbajnë gjithashtu identifikimin e llojit të seancës nëse ajo është përgatitore ose gjyqësore në referim të neneve 158/b, 158/c të Kodit të Procedurës Civile.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor të miratojë rregulla standarde me qëllim paraqitjen në të dhënat statistikore të treguesve që lidhen me: Kërkesat e paraqitura në gjykatë "Për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave" në referim të nenit 399/5 të K.Pr.C. si dhe ecurinë e vendimmarrjes së gjykatës më të lartë në lidhje me këto kërkesa.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor të miratojë rregulla standarde me qëllim paraqitjen në të dhënat statistikore të treguesve që lidhen me: "Kërkesë paditë për shpërblimin e dëmit" të paraqitura në referim të nenit 399/6 pika 2 i K.Pr.C."

Këto rekomandime të zbatohen brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026

3. Rekomandim për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë

- Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë të marrë masa në drejtim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave të nevojshme që Inspektori i Lartë i Drejtësisë të ketë akses të plotë (jo të kufizuar) në sistemin e të dhënave dhe të teknologjisë së informacionit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhoma civile) duke përfshirë edhe aksesin në regjistrimin e seancave, në zbatim të neni 92, pika 1, shkronja "b"¹⁴⁶ të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe pika 10, shkronja "e" e VKM-së nr.

¹⁴⁴ Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme: ... b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë; c) miraton rregullat e brendshme standarde të gjykatës".

¹⁴⁵ Rregullat standarde për efikasitetin në drejtësi përfshijnë parashikime për: ... ç) rregulla standarde për monitorimin e kohëzgjatjes së pezullimeve që vijnë si rezultat i mosveprimit nga palët ose gjykatat; dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore."

¹⁴⁶ Këshilli i Ministrave miraton rregulla për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, që ndër të tjera parashikojnë: b) sigurimin e aksesit të plotë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të dhënat që përmbajnë të gjithë sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me Këshillin e Lartë Gjyqësor, gjykatat, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe zyrat e prokurorisë.

972 datë 02.12.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë".

- Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë të marrë masa që sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhoma civile) të gjenerojë informacionin statistikor që nevojitet për punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹⁴⁷, në kuadër të përmirësimit të të dhënave statistikore sikurse i kemi përmendur në rekomandimet drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këto rekomandime të zbatohen brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026.

4. Rekomandim për Shkollën e Magjistraturës

- Shkolla e Magjistraturës të mbajë në vëmendje që pjesë e kurrikulës të trajnimit vazhdues të jetë edhe zhvillimi i aftësisë së gjyqtarit për të ushtruar veprimtari gjyqësore eficiente në drejtim të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë gjyqësore dhe miradministritimit në tërësi të proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare.

Propozime

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 194, pika 4, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, në cilësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

PROPOZOJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik me objekt "Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore, me palë kundërshtare, të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023 – 31.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile", miratuar me vendimin nr.18, datë 15.04.2024.
2. Ndjekjen e rekomandimeve sipas afateve të përcaktuara në raportin e inspektimit.
3. Njoftimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile, për përfundimin e inspektimit tematik, duke i dërguar edhe një kopje të raportit të inspektimit.

¹⁴⁷ Bordi drejtues ushtron kompetencat si vijojnë: .. gj) miraton masa që sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit të gjenerojnë informacionin statistikor që nevojitet për punën e të gjitha institucioneve në sistemin e drejtësisë, në konsultim të ngushtë me institucionet përkatëse.

4. Njoftimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës me raportin e inspektimit, duke i'u dërguar një kopje të këtij raporti.

INSPEKTORËT

Znj. Daniela Sulaj



Z. Eugen Nasufi

